Azam Dauti

# PROJEKTI “SHKUPI 2014” -E KALUARA KUNDREJT ARDHMËRISË

*Editor*
Krenar Dauti

*Redaktor gjuhësor*
Agim Avdiu

Recensentë
*Prof. Dr. Shefket Zekolli*
*Prof. Dr. Ylber Sela*

…rekomandimet e para për botimin e këtij libri janë nga dy mentorët e mi *(Para të cilëve e mbrojta temën e doktoraturës "Ndikimi i politikave kulturore në Maqedoninë e Veriut në periudhën 2007- 2017"),* nga:

*Проф. д-р София Илиева Василева-Вълчева*
*Проф. д-р Нано Ружин*

**Azam Dauti**

# PROJEKTI "SHKUPI 2014"
## -E KALUARA KUNDREJT ARDHMËRISË

(NDIKIMI I POLITIKAVE KULTURORE NË NGJARJET SHOQËRORE NË MAQEDONI, ME THEKS TË VEÇANTË PËR PERIUDHËN 2007 DERI 2017)

**Botues - Autori**
*Shkup, 2O21*

# ABSTRAKT

**T**ema për "ndikimin e politikës kulturore në ngjarjet shoqërore në Maqedoninë e Veriut" për periudhën e dhënë prej vitit 2007 deri në vitin 2017, është periudhë e "fillimit" të një orientimi kulturor autoritar, të angazhuar, të regjimit… populliste, e njëanshme, madje edhe etnocentrike, meorientim "diskutabil" identitar në planin nacional (antik kundër identifikimit sllav të maqedonasve), e cila në "fund" të vitit 2017 të fillojë me shpalosjen e kësaj politike "të keqe" kulturore e udhëhequr gati për një dekadë. Paralelisht me këtë, kemi afera për korrupsion të projekteve të realizuara kulturore dhe zhvillim jo të barabartë kulturor i nxitur nga kreu shtetëror në vend: në favor të kulturës maqedonase kundrejt asaj shqiptare dhe kulturave tjera në vend. Teprimi i ekskluzivitetit të kulturës antike të popullit maqedonas i shndërruar në kapital shtetëror dhe politik, si dhe paraqitja e historisë së përbashkët të maqedonasve me atë bullgare si ekskluzivitet i maqedonasve të Maqedonisë, solli deri te mospajtimet mes dy fqinjve të Maqedonisë. Kjo u reflektua edhe në politikën e jashtme të vendit dhe për këtë, Maqedonia për këto dhjetë vite, kishte një lloj të izolimit të butë por të ndjeshëm. Këto problem, që u shkaktuan me politikën e gabuar kulturore të Maqedonisë, në periudhën e shkuar, jo vetëm që zgjuan interesim në aspektin e përpunimit të kësaj teme, por mund të kontribuojë drejt gjetjes së orientimeve positive, në definimin e përcaktimeve të autoriteteve

shtetërore për ndërtimin e një shoqërie më efikase dhe më humane në Republikën e Maqedonisë. Ashtu siç potencuam se zhvillimi i politikës kulturore në periudhën prej vitit 2007 deri 2017 kishte ndikim në ngjarjet shoqërore në Maqedoni, jo vetëm në planin e brendshëm, por edhe në atë të jashtëm, gjegjësisht në aspektin ndërkombëtar, posaçërisht në vendet fqinje të Maqedonisë, fillimisht me Greqinë dhe Bullgarinë, ndërsa në mënyrë indirekte me Shqipërinë, Kosovën dhe Serbinë. Që të analizohet më thellë dhe të elaborohet një temë e këtillë komplekse, kuptohet se nevojiten që të shqyrtohen edhe disa çështje të tjera, fillimisht:

## *Konteksti shoqëror-historik i problemit të hulumtimit.*

Drejtimi, orientimi dhe zhvillimi i kësaj teme duhet të ketë identifikim shkencor me çështjet në vazhdim, duke filluar nga një çështje elementare profesionale e studimit:

- Mënyra e finansimit të kulturës, e zhvillimit kulturor a sjell deri te zhvillimi i barabartë kulturor ose te prapambetja e disa kulturave të caktuara?
- A ka favorizim të një zhvillimi të caktuar kulturor të një bashkësie në raport me të tjerët?!
- A ekziston mospërfillja e bashkësive të vogla (turke, rome, vllehe, serbe dhe boshnjake) në zhvillimin kulturor?
- A kontribuon projekti "Shkupi 2014" në multikulturalizëm apo i shton tensionet mes bashkësive?!

- Përvetësimi i veprimtarëve të përbashkët të popujve të Ballkanit nga e kaluara, a është më afër respektimit të ndërsjellë apo e kundërta?!
- Sa është e mençur që të kërkohen rrënjët në Maqedoninë Antike, kur nuk e respektojmë të tashmen si dhe çështje të ngjashme lidhur me temën.

**Fjalë kyçe:** *zhvillim kulturor, politikë kulturore, ndikim politik, Shkupi 2014, zhvillim institucional, Maqedonia Antike, financimi.*

**Fusha shkencore:** *Kultura, historike, politike, demografike, gjeorgafike.*

# HYRJE

**K**y hulumtim ka për qëllim që të zbulojë se si ka ndikuar politika kulturore në ngjarjet shoqërore në Maqedoni në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2017. Po ashtu, element shumë i rëndësishëm i temës është se cili ishte roli i ndërhyrjes së politikës fillimisht në kulturë si krijimtari dhe art, jo vetëm në krijimin e projekteve dhe programeve nga Ministria e Kulturës e cila u manifestua në Programet vjetore me interes kombëtar nga fusha e kulturës, por edhe mbi mediumet elektronike dhe ato të shtypit, institucionet arsimore, organizatat qytetare të cilat shërbyen si përkrahje logjistike të politikës në raport me kulturën.

Drejtimi i njëanshëm të cilin e praktikonte Qeveria e Maqedonisë me favorizimin vetëm të të afërmve në këto fusha, tregonte në atë se në të vërtetë në Maqedoni zhvillohej kulturë ideologjike e qeverisë, e jo vlera artistike të cilat duhej të ishin krijimtari individuale dhe arritje artistike të vetë krijuesve të kulturës.

Maqedonia si vend i shumë kulturave dhe i orientimeve kulturore, duhet të jetë motiv nxitës për garë të vërtetë kulturore, jo vetëm të drejtimeve të ndryshme kulturore në bazë të etnisë, por edhe në kuptimin individual të fjalës.

Në këtë temë, Ganka Cvetanova thotë: "Politikat kulturore në shoqëritë multikulturore, në esencën e tyre duhet të jenë më tolerante dhe më fleksibile."[1] Gjithashtu,

[1]Проф.Др. Ганка Цветанова, Културните разлики и општествената интеграција: Македонија пред и по Рамковниот договор, Институт за економски стратегии и меѓународни односи - ОХРИД, 2007, стр. 85.

pjesë me rëndësi i këtij hulumtimi është ndikimi negativ i politikës mbi zhvillimin kulturor në Maqedoni. Sipas Zhozef Rac, në "Shoqëritë ku ka më shumë bashkësi politike dhe më shumë bashkësi kulturore, secila por me theks të veçantë bashkësia më e madhe politike ka dëshirë që ta marrë hapësirën kulturore dhe kujdesin nga shteti, por kjo nuk është e mirë për zhvillimin kulturorë të vetë shtetit."[2] Ndikimet negative do të përpiqemi që t'i ndriçojmë me anë të shembujve, ashtu që vetë shteti gjatë gjithë kohës i inkurajonte projektet nga kultura të cilat ishin simptomatike për opinionin në Maqedoni. Kur themi simptomatike, para së gjithash mendojmë në gërmimet arkeologjike të Pasko Kuzmanit. Përmendore dhe ngjarje lidhur me shtetet dhe popujt tjerë, të cilat ndërtoheshin me ngulm në nivel shtetëror për heronjtë të cilët "i takojnë" vetëm popullit maqedonas. Për situatën në planin e brendshëm vlen të përmendet edhe mendimi i profesor Branisllav Sarkanjac i cili thotë: "Pa u zgjidhur çështjet e lartpërmendura kontestuese me interes vital për Maqedoninë, multikulturalizmi mbetet ide e cila vështirë realizohet."[3] Derisa në planin e jashtëm, me këto projektet e "Shkupi 2014", Maqedonia ishte në prag të përkeqësimit të marrëdhënieve ndërshtetërore me Greqinë dhe Bullgarinë gati gjatë gjithë periudhës së qeverisjes së Gruevskit.

[2] http://www.southeast-europe.org/pdf/04/DKE_04_A_E_Berkes-Lilla_Kantor-Judit.pdf (f. 5) JOSEPH RAZ: Multikulturalizmus – liberális szempontból In: FEISCHMIDT Margit: Multikulturalizmus. Budapest: Osiris Láthatatlan Kollégium 1997.

[3] Бранислав Саркањац, Мултрикутурализмот во Македонија, Институтот Отворено Општество – Македонија, Скопје, 2005, стр-24.

## PËRSHKRIMI I SHKURTËR I TEZËS

Teza në temën "Ndikimi i politikës kulturore në ngjarjet shoqërore në Maqedoninë e Veriut nga periudha prej vitit 2007 deri në vitin 2017" trajton situatën kur kohezioni i kulturës dhe i politikës luajtën rol negativ në zhvillimin kulturor dhe anasjelltas.Politika qeveritare e këtillë kulturore, skajshmërisht e angazhuar, luajti rol negativ në ngjarjet shoqërore në vend, e mbi të gjitha në politikën e jashtme të Maqedonisë, kryesisht me Bullgarinë dhe Greqinë.Ndikimi reciprok i politikës në kulturë i nxitur nga regjimi autoritar, padyshim se prodhon kulturë pa vlerë, afera korruptive me përmasa të mëdha si dhe ndikon në mënyrë direkte në orientimet, raportet ndëretnike dhe ideologjike të qytetarëve.

Ndoshta rezultat i këtij regjimi ishin edhe aferat e mëdha në të ashtuquajturat *bombat e Zaevit,* kur një funksionar i lartë i VMRO-së (Mijallkov) bisedon me kryeredaktorin e Televizionit Sitel (*Latas*), kur ky i dyti i thotë të parit: "Unë pranoj që të jem në dispozicion të politikës qeveritare, por duhet të paguhem për këtë." Kjo fjali i tregon të gjitha se si zhvillohej kultura në të gjitha sferat e jetës në Maqedoni në këto 10 vite.

Interesimi i politikës që të krijojë opinion publik të qytetarëve nëpërmjet aktiviteteve kulturore gjithmonë është prezente kudo në botë, por ndikimi brutal mbi gjithçka që të ndikohet në këto sfera të zhvillimit kulturor shoqëror e vërteton tezën se ndërhyrja e këtillë e ndërsjellë e përforcon dhe e trimëron udhëheqjen autokrate dhe diktatoriale që t'i vendos nën kontroll të gjitha instuticonet shtetërore dhe humane, por edhe burimet në një shoqëri, siç ishte rasti me Maqedoninë e Veriut në periudhën e përmendur këtu.

## PËRMBLEDHJE

Disertacioni ynë është bërë me hyrje dhe në 9 pjesë, me këtë rast në tri pjesët e para (1, 2 dhe 3) është përshkruar strategjia e hulumtimit. Kështu, në **hyrje** të disertacionit të doktoraturës përshkruhet formulimi i problemit të politikës kulturore dhe i zhvillimit si dhe ndikimi i saj në ngjarjet shoqërore. Në të vërtetë, përshkruhet strategjia e punës hulumtuese, pra se në cilën rrugë do të zhvillohet hulumtimi.

Në pjesën e dytë, gjegjësisht në pjesën 4, 5 dhe 6 të disertacionit tonë prezantohen definicionet hulumtuese dhe burimet e problemit të ndikimit politik mbi zhvillimin kulturor në Maqedoni, krahasimi me të kaluarën në kohën e RSFJ-së, pastaj propozimet për tejkalimet e problemeve të brendshme kulturore të nxitura nga politika si dhe paraqitja e projektit Shkupi 2014 i cili la gjurmë të këqija në situatat e brendshme interetnike dhe interkulturore në Maqedoni.

Në tri pjesët e fundit (7, 8 dhe 9) është rezymeja e burimeve, të dhënat, hulumtimet e të ngjashme. Pikërisht për pjesën më interesante, se si ndikimi politik i projektit "Shkupi 2014" i ka ndërlikuar jo vetëm marrëdhëniet interetnike (kryesisht shqiptare – maqedonase), por edhe marrëdhëniet e jashtme miqësore me vendet fqinje, kryesisht me Greqinë dhe me Bullgarinë.

## SUBJEKTI I HULUMTIMIT

Subjekt i hulumtimit tonë është politika kulturore dhe rëndësia e saj në zhvillimin shoqëror dhe në ngjarjet në Maqedoni në një periudhë të caktuar. Po ashtu, në trajtimin e ndikimit të kulturës në shoqëri detektohet dhe analizohet

edhe shkopi dirigjues i politikës mbi kulturën dhe përgjithësisht mbi shoqërinë në Maqedoni nga viti 2007 deri në vitin 2017. Problemi nuk është vetëm në udhëheqjen dirigjuese të politikës, por edhe në nënshtrimin e veprimtarive kulturore dhe të tjera shoqërore siç janë mediumet, institucionet arsimore, fetare, ekonomike etj. ndaj politikës. Një komunikim i këtillë i vendosur dhe i lidhjes mes politikës dhe kulturës gjithsesi se ndikon mbi zhvillimin shoqëror të një vendi, më saktënë Maqedoni në periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2017.

Këto fenomene kulturore, shoqërore dhe politike në Maqedoni janë subjekt i diskutimit dhe i analizës e cila kuptohet se do të jenë subjekt i hulumtimit në këtë disertacion të doktoraturës, por edhe më gjerë për shkak të ndikimit të madh të cilën e kishte politika në këto dhjetë vitet e fundit.

## Politika kulturore

Ekzistojnë shumë definicione rreth asaj se çka në të vërtetë është politika kulturore. Sipas Konventës për mbrojtjen dhe përparimin e llojllojshmërisë në manifestimet kulturore të UNESKO, thuhet: "Politikat kulturore dhe mjetet kanë të bëjnë me ato politika dhe mjete lidhur me kulturën, qoftë në aspektin lokal, kombëtar, rajonal ose në nivel ndërkombëtar dhe të gjitha janë të përqendruara mbi kulturën si të tillë ose parashihet që të kanë efekt të menjëhershëm mbi manifestimet kulturore, grupe ose shoqëri, duke përfshirë edhe krijimin, prodhimin, përhapjen, shpërndarjen por edhe qasjen deri te aktivitetet

kulturore, të mirat dhe shërbimet."[4] Në një studim tjetër të Sheshiq Dragiçeviq, Stojkoviq thuhet se: "Politika kulturore supozon rregullim të vetëdijshëm të interesave në fushën e kulturës dhe vendimi për të gjitha çështjet lidhur me zhvillimin kulturor të një shoqërie globale dhe e njëjta manifestohet në tri mënyra

1.Përmes cilësimeve teorike...;

2.Përmes definimit preciz të qëllimeve dhe detyrave të politikës kulturore;

3.Përmes sistemit të metodave dhe instrumenteve për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të politikës kulturore."[5]

Derisa për modelin e politikës kulturore e cila zhvillohet në një vend, kulturologu boshnjak Esat Delibashiq e shpreh definicionin më të drejtpërdrejtë: "Modeli i politikës kulturore që realizohet në një shtet varet më së shumti nga identiteti ideologjik i pushtetit momental politik, në të vërtetë nga kuptimi i tij i rolit kulturor dhe artistik në shoqëri."[6]

Subjekt i këtij studimi kuptohet se është zhvillimi kulturor në Maqedoni pas pavarësimit të saj e deri më sot; dallimet në zhvillimin kulturor; dallimet që ekzistojnë në zhvillimin kulturor dhe arsyet për ato dallime. Sipas Konventës Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtarë të KB mes tjerash thuhet: "Si proces nëpër të cilin kombinohen elementet e ndryshme në një bashkësi të caktuar, me këtë

[4]ЦВЕТАНОВА, Ганка 2007, Културните разлики и општествената интеграција : Македонија пред и по Рамковниот договор / Скопје, Институт за економски стратегии и меѓународни односи, стр.84-85.

[5]Шешиќ Драгичевиќ, Стојковиќ, Култура, Анимација, Менаџмент, Маркетинг, Темплум, Shkup, 2003, стр.33.

[6]http://www.anubih.ba/images/publikacije/dijalog/2014%20-%201-2/01%20-%20Esad%20Delibasic.pdf, Esad Delibašić (Originalni naučni rad),Etnonacionalni model kulturne politike, DOI: 10.5644/DIJALOG.2014.1-2.01, стр.7.

rast duke e mbajtur identitetin e tyre bazik"[7] zhvillimi i barabartë kulturor shënon një raport korrekt të institucioneve shtetërore ndaj kulturave të ndryshme në një vend.

**Ngjarjet shoqërore**

Me shprehjen ngjarjet shoqërore nënkuptohen ngjarjet dhe ndodhitë të cilat janë reflektim i zhvillimit të përgjithshëm në një shoqëri.

**Bartësit e politikës kulturore në Maqedoni**

Qeveria e RM, Ministria e Kulturës e RM, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qyteti i Shkupit, Ministria e Vetëqeverisjes lokale etj.

**Institucionet kulturore në RMV**

Mbi 100 institucione nacionale dhe 200 lokale: drejtori të trashëgimisë kulturore, Fondi i filmit, Teatro, Bibliotekat, Opera dhe filharmonia, muzetë etj.

## VLERA E HULUMTIMIT

Para së gjithash, vlerë e këtij hulumtimi është ndikimi i politikës kulturore mbi ngjarjet shoqërore në Maqedoni për periudhën prej vitit 2007 deri në vitin 2017, ndërsa kjo ka rëndësi të jashtëzakonshme që të jepet mësim se kohezioni i këtillë i politikës me kulturën mund t'i çojë mbrapa proceset integruese euroatlantike të një shoqërie të civilizuar në synimet globale të një shteti të vogël siç është Maqedonia.

[7]Студијата на ОН, *supra*, забелешката 82, ставови 373-7

Kjo tezë për rolin e këtillë të politikës kulturore në vendin tonë, është pamje reale e jetës së përgjithshme kulturore politike në Maqedoni për periudhën e dhënë, por assesi për synimet e përgjithshme të vendit dhe të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut.

Po ashtu, edhe heqja dorë nga rezistenca e aktivizmit të qytetarëve nga kjo politikë kulturore është subjekt i analizës për rezistencën kulturore dhe shoqërore e cila gjatë gjithë kohës e kundërshtonte politikën e këtillë kulturore. Nganjëherë më fuqishëm, nganjëherë më dobët, por ekzistonte dhe ende ekziston në shtet.

Këto fenomene shoqërore janë pjesë e këtij hulumtimi dhe ndoshta janë analizat më me vlerë të cilat bëhen në këtë tezë disertacioni të doktoraturës.

## QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i hulumtimit të tezës së doktoraturës është të dëshmohen dhe të analizohen këto aspekte:

Lidhshmëria e kulturës dhe politikës, kohezioni i tyre pozitiv dhe negativ.

Jehona e kohezionit të politikës dhe kulturës kuptohet se ka reperkusione mbi njërën ose fushën tjetër. Me këtë rast, me siguri si humbës është treguar se janë edhe politika edhe kultura.

Implikimet e brendshme dhe të jashtme nga realizimi i politikës kulturore në vend.

Përhapja e anomalive shoqërore, siç është kiçi në kulturë dhe korrupsioni në projektet megalomane të realizuara kulturore.

Fazat e zhvillimit kulturor në Maqedoni në raport me bashkësitë, në periudhën prej pavarësimit të saj e deri më sot.

Dallimet në zhvillimin institucional kulturor në raport me bashkësitë.

Planet strategjike dhe operacionalizimi i zhvillimit kulturor nga ajo periudhë dhe përfitimet e tyre korrekte ose dështimet për kulturën.

Raporti i këtij zhvillimi të kulturës me përdoruesin direkt ose indirekt të kësaj kulture të ofruar.

## METODAT SHKENCORE

Për përpunimin e temës për ndikimin e politikës kulturore në ngjarjet shoqërore, janë përdorur këto metoda shkencore të cilat i kishim në dispozicion:

1. Komparative,
2. Historike,
3. Statistike.

Në metodën **komparative** janë përcjellë disa periudha kohore karakteristike rreth asaj se si vijonte zhvillimi kulturor në Maqedoni për periudhën e dhënë, pastaj është bërë edhe një analizë e shkurtër dhe krahasimi se si gërshetohej politika kulturore duke krijuar censurë të paparë dhe se si në kohën e pluralizmit hiperliria e veprimit luante rol negativ, kur mbi kulturën bëhej presion ose më së paku politika sillej në mënyrë diskriminuese ndaj disa kulturave.

Me metodën **historike**, ne kemi bërë vetëm një pjesë të retrospektivës së zhvillimit kulturor në disa pjesë të kulturës si krijimtari e jo si nocion i gjerë i kulturës, sepse thjesht ky është material vëllimor i cili nuk mund të

realizohet në aspektin cilësor e as në domenin kuantitativ. Kjo periudhë historike përfshin një përshkrim të shkurtër të zhvillimit kulturor të krijimtarisë në Maqedoni nga periudha 1945 deri 1990 si dhe periudhën pas viteve '90-të, me theks të veçantë prej vitit 2007 deri në vitin 2017, si dhe periudhën e përzierjes më të madhe të politikës në zhvillimin kulturor në Maqedoninë e Veriut sot. Pjesa **statistikore** më shumë është punuar me burime alternative të të dhënave, por të cilat realisht dhe objektivisht janë shprehur në hulumtimet e tyre, siç janë ueb faqet: http://www.maccinema.com, http://respublica.edu.mk, https://fokus.mk, http://prizma.birn.eu.com, pastaj disa Buxhete Vjetore të RM në periudhën nga viti 2007 deri 2017, Programet Vjetore të Ministrisë së Kulturës etj.

## STRUKTURA E STUDIMIT

Disertacioni ynë është bërë me **Hyrje dhe 9 pjesë** dhe është përmbyllur me PËRFUNDIM. Te hyrja është përshkruar qëllimi ynë, për atë se kemi për qëllim që ta trajtojmë ndikimin e kulturës në politikë, gjegjësisht të politikës në kulturë. Me dallim të saktë të kulturës si definicion i përgjithshëm dhe të krijimtarisë kulturore dhe artit si bashkësi e veçantë e ndarë nga nocioni i gjerë i kulturës, kjo do të thotë se ne në këtë disertacion e kemi trajtuar kryesisht ndikimin e politikës kulturore në ngjarjet shoqërore në Maqedoni për periudhën nga v. 2007 deri në 2017 në aspektin e kulturës si art dhe krijimtari e jo si nocion i gjerë i kulturës si veprimtari dhe sjellje.

Në **pjesën e I-rë** filluam me detektimin e problemit të barazisë kulturore, gjegjësisht të margjinalizimit të kulturës shqiptare, pastaj në rëndësinë e udhëheqjes politike të

kulturës: popullizmit, etnocentrizmit dhe ekskluzivitetit të një orientimi kulturor të cilin e imponone pushteti për periudhën nga viti 2007.

Në **pjesën e II-**të përshkruhen qëllimet e politikës kulturore në zhvillimin institucional, në një zhvillim të pabarabartë kulturor, të procedurave, veprimeve dhe vështirësive në grumbullimin e të dhënave me karakter publik, pikërisht për shkak të ndikimit shkatërrues të politikës mbi kulturën dhe punëtorët e kulturës.

Në **pjesën e III-të,** theksi është vënë në kontekstin shoqëror historik të problemit të hulumtimit, edhe atë duke filluar nga v. 1945 deri në v. 1990 në R.S. të Maqedonisë. Si orientim kryesor i punimit kuptohet se është definicioni për politikën kulturore dhe operacionalizimin e temës në 9 pjesë, kjo do të thotë se ne kemi filluar me **definimin teorik të subjektit të hulumtimit** që është **POLITIKA KULTURORE?** Për modelin e politikës kulturore e cila zhvillohet në një shtet, kulturologu boshnjak Esat Delibashiq tregon një definicion direkt: "Modeli i politikës kulturore që realizohet në një shtet varet më së shumti nga identiteti ideologjik i pushtetit momental politik, gjegjësisht nga kuptimi i tij i rolit kulturor dhe artistik në shoqëri."[8] Zhvillimi i barabartë kulturor shënon një raport korrekt të institucioneve shtetërore ndaj kulturave të ndryshme në një vend, gjë e cila i mungon Maqedonisë, nganjëherë më pak e nganjëherë më shumë, por gjithmonë është nën ndikimin e politikës.

Në **pjesën e IV** bëhet krahasimi i të kaluarës dhe i të tanishmes, gjegjësisht bëhet një shqyrtim i përgjithshëm për

[8]http://www.anubih.ba/images/publikacije/dijalog/2014%20-%201-2/01%20-%20Esad%20Delibasic.pdf, Esad Delibašić (Originalni naučni rad),Etnonacionalni model kulturne politike, DOI: 10.5644/DIJALOG.2014.1-2.01, str.7.

zhvillimin kulturor në RSFJ-në e dikurshme dhe tranzicionin kulturor nga v. 1990 deri në vitin 2017. Krahasimi empirik i cenzurës së atëhershme me hiperlirinë e tanishme, në realitet është karakteristikë edhe e Maqedonisë, ndërsa në një formë tjetër edhe e vendeve të bllokut lindor.

Në **pjesën e V**, kemi fjalën përfundimtare për kontekst të brendshëm kulturor duke dhënë rekomandime se si kjo të tejkalohet, me propozim konkret për riorganizimin dhe sistematizimin e Ministrisë së kulturës si organ kyç për zhvillimin kulturor në vend.

Në **pjesën e VI** është bërë përshkrimi se si ka ndikuar projekti "Shkupi 2014" në planin e brendshëm të planit kulturor, arkitektonik, politik, identitar, religjioz, ndëretnik dhe ndërmaqedonas. (Mos)Respektimi i normave juridike dhe ligjore në realizimin e këtij projekti të madh dhe hulumtimi i dyshimeve për veprimtari korruptive në realizimin e këtij projekti.

Në **pjesën e VII** përshkruhen implikimet e projektit "Shkupi 2014" në planin e jashtëm, fillimisht me Greqinë dhe Bullgarinë. Edhe më shumë për shkak se nuk respektohen rekomandimet e vendeve evropiane, për mosvënien e emrave dhe përmendoreve të cilat mishërohen me historinë greke dhe bullgare. Në fund janë edhe Marrëveshjet për miqësi me Bullgarinë dhe Greqinë.

Në **pjesën e VIII** kemi dhënë fjalën përfundimtare për ndikimin e politikës kulturore në situatat shoqërore në kontestin e brendshëm dhe të jashtëm. Për të tre rastet kemi edhe rekomandimin se si t'i largohemi konfliktit të brendshëm e të jashtëm me shqiptarët në vend, me Bullgarinë dhe Greqinë në planin e jashtëm.

Në **pjesën e IX** me titull "rekomandimet për paqe në

shtëpi dhe në fqinjësi" gjendet edhe forma e **KONKLUZËS**, ndërsa pas kësaj edhe literatura e shfrytëzuar, të dhënat që janë përdorur në formë të literaturës, artikujve, revistave, mediumeve elektronike, ueb faqeve etj.

## PËRCAKTIMI I SHPREHJEVE KRYESORE

Si shprehje kryesore në përdorim në këtë disertacion janë: Politika dhe kultura, gjegjësisht lidhshmëria dhe ndarja e tyre. Si mund të jenë në dobi, kur politika e ndihmon kulturën në drejtim pozitiv, ndërsa në periudhën konkrete edhe si rast sipas neve, se si ajo luan rol negativ në kuptim negativ të drejtimeve dhe orientimeve kulturore e të cilat janë përcaktuar nga qëllimet politike.

## HIPOTEZAT E STUDIMIT

Gjendjet shoqërore, ndikimi i politikës kulturore mbi ngjarjet shoqërore, roli i politikës në zhvillimin e kulturës si krijimtari dhe si art si dhe zhvillimi i barabartë kulturor në shoqërinë multietnike mund të matet me këto hipoteza të vendosura:

- Shkalla e ndërtimit institucional të krijimtarisë kulturore.
- Mënyra dhe vëllimi i financimit për zhvillimin kulturor në nivel kombëtar dhe lokal në një periudhë të caktuar.
- Zhvillimi institucional kulturor dhe kujdesi i barabartë i të gjithë punonjësve të kulturës kontribuon në paqe ose në trazirat e vetë shoqërisë.

- Sa kontribuon ajo politikë kulturore në bashkëpunimin e jashtëm kulturor dhe politik.

Se sa ka rëndësi që të kesh politikë të mirë kulturore dhe zhvillim në vend, Ana Çupeska thotë se duhet të implementohet aneksi C i Marrëveshjes Kornizë nga viti 2001. Ajo thotë: "Aneksi C i Marrëveshjes Kornizë është në fakt, një plan operativ për zbatimin e masave për ndërtimin e besimit midis palëve. Për më tepër, nevojitet një plan afatmesëm me qëllime më të përgjithshme, por jo përfundimtare. Në këtë aspekt, çështjet e drejtësisë, marrëveshjet buxhetore, siguria, konfliktet do të jenë gjithmonë objekt i marrëveshjeve dhe negociatave, ndërsa thelbësore për mbrojtje nga bllokimi i procesit të negociatave" [9]

## Hipoteza e veçantë

Sa më e lartë që është shkalla e institucionalizimit të kulturës së një bashkësie, më shumë vjen në shprehje shkalla e zhvillimit të barabartë të kulturës së një bashkësie në shoqërinë multikulturore.

Nëse ekziston zhvillim adekuat i barabartë kulturor dhe politikë e shëndoshë kulturore, atëherë është më i vogël rreziku nga disa forma të caktuara të konfliktit.

Mënyra dhe vëllimi i financimit të bashkësive kulturore dhe i rajoneve ndikon mbi shkallën e zhvillimit kulturor dhe politikës kulturore e cila mund të ndikojë pozitivisht mbi situatat shoqërore në vend dhe në rajon.

[9]ЧУПЕСКА, Ана, Културните идентитети во политиката : аспекти на мултикултурализмот / Ана Чупеска. - Скопје : Фондација Конрад Аденауер, 2013, стр 135.

## Hipoteza individuale

Nëse ekzistojnë institucione të pavarura dhe të lira të kulturës, atëherë edhe shkalla e njohjes së zhvillimit kulturor të bashkësive është më e lartë. "Forma më radikale historike e konceptimit autoritar të politikës kulturore realizohet në politikën kulturore të nacionalsocializmit",[10] të cilën te ne e realizonte qeveria e VMRO-së e cila veten e konsideronte për parti djathtiste me orientim demokristian.[11]

Sa është shkalla e aftësisë ekonomike të shtetit, aq më i madh është vëllimi i ndarjes së mjeteve për zhvillim të barabartë kulturor të bashkësive. Zhvillimi rajonal kulturor varet nga aftësia ekonomike e rajonit (komunave).

Prof. Petar Atanasov lidhur me "kontekstin kulturor" thotë: "Sot Republika e Maqedonisë paraqet një kontekst në të cilin vështirë se mund të ndërtohet shoqëri stabile me marrëdhënie të mira ndëretnike dhe në të cilën shteti nuk arrin që t'i kënaq ose t'i mbrojë të drejtat e qytetarëve. Ndërsa qytetarët duke u gjendur mes çekanit dhe kudhrës, vazhdojnë ditë e më shumë të besojnë në Zot/Allah sesa në shtet."[12]

[10]Brenner, Hildegard: Kulturna politka nacionalsocijalizma, Zagreb: August Cesarec. 1992, f. 7

[11]https://vmro-dpmne.org.mk/files/vmro-dpmne-statut.pdf (Види: Член 7).

[12]ПОЛИТИЧКАТА култура и идентитетите / [уредници Емилија Симоска, Славица Инџевска]. – Скопје : Фондација отворено општество-Македонија, 2012, стр.70.

# KRITERET PËR SUKSES
# DHE EFIKASITETI HULUMTUES

## Politika kulturore në kornizën institucionale

Tema për politikën kulturore në kornizë institucionale, në kontekst të asaj se paraqet njëra prej shumë masave preventive për situata të konflikteve në vend, jo vetëm që ka zgjuar interesim në aspektin e përpunimit të temës së doktoraturës, por mundet shumë të kontribuojë në gjetjen e drejtimeve pozitive në definimin e përcaktimeve të autoriteteve shtetërore për ndërtimin e një shoqërie më efikase dhe më të qëndrueshme në Maqedoni. Për këtë situatë, kulturologu boshnjak Esad Delibashiq thotë: "Kuptimi i kulturës në një dimension etnik çon deri te ajo që të ngrihet në kulturë njëdimensionale e cila më vonë bëhet kulturë monolite e varur nga shteti. Vartësia shihet në atë se kultura gjithmonë do të presë se çka do të planifikojë shteti për zhvillimin e kulturës."[13] Është interesant edhe qëndrimi i autores gjermane Juta Limbah e cila thotë: "Një është e sigurtë: Ekzistojnë shoqëri paralele nëpër gjithë Evropën, posaçërisht në qytetet e mëdha dhe brenda shteteve ku jetojnë shumë imigrantë dhe pasardhësit e tyre, dallimi ndodh bashkë me përjashtimet etnike, racore dhe religjioze."[14] Për t'u hulumtuar dhe analizuar në mënyrë thelbësore përmbajtësore kjo temë, lidhur me

[13]http://www.anubih.ba/images/publikacije/dijalog/2014%20-%201-2/01%20-%20Esad%20Delibasic.pdf, Esad Delibašić (Originalni naučni rad), Etnonacionalni model kulturne politike, DOI: 10.5644/DIJALOG.2014.1-2.01, стр.15-16.

[14] http://www.southeast-europe.org/pdf/04/DKE_04_A_E_Berkes-Lilla_Kantor-Judit.pdf (стр 1) JUTTA LIMBACH: Die Probleme der Multikulturalität. Der Schutz von Minderheiten - eine Lehre aus der Geschichte. In: http://www.perlentaucher.de/artikel/2557.html October 27, 2010.

problematikën ishin të domosdoshme disa observime fillestare të gjendjes kulturore në vend, edhe atë:

- Hulumtimet për gjendjet e mëparshme,
- Hulumtimet për gjendjet në rrethanat e sotme,
- Hulumtimet për drejtimet e mundshme në të ardhmen (se si duhet të ndërtohen dhe zhvillohen në të ardhmen gjendjet në politikën kulturore në vend).

## NDIKIMI I POLITIKAVE KULTURORE

### Politika kulturore

Në fillim të punimit e kemi dhënë definicionin e UNESKO-s për politikën kulturore, në këtë hyrje do të fillojmë me Sajmon Mandi i cili në librin e tij "Politika kulturore" thotë se: "Detyrë kryesore e integrimit të shoqërive komplekse për fat të keq akoma mbetet fushëveprim vetëm i personave zyrtarë të cilët punojnë me mbrojtje sociale, punësim dhe strehim. Mirëpo, procesi i integrimit nuk duhet të injorohet e as që duhet të neglizhohet në sektorin e kulturës. Politika e mirë kulturore vetvetiu nuk do të sigurojë lidhshmëri dhe prosperitet të kombit. Mirëpo, pa politikë të mirë kulturore, shumë prej qëllimeve të mbetura politike të qeverisë do të arrihen më vështirë, nganjëherë as që mund të arrihen",[15] gjë e cila sipas nesh, ky qëllim as që shihej në Maqedoni, posaçërisht jo në periudhën 2007-2017 që është subjekt i këtij punimi. Një mendim tjetër i Xhordan dhe Vedon është shumë i qartë në atë se çka do të thotë dhe sa është e rëndësishme politika kulturore e një vendi: "Sot, politika kulturore është

[15]Sajmon Mandi, Kulturna poltika, VEGA media, Novi Sad, 2012, str. 67.

dimension i pranuar i politikës shtetërore. Legjitimimi i relacioneve shoqërore të pabarazisë dhe luftës për transformimin e tyre, janë temat qendrore të politikës kulturore. Aq më shumë, që ajo merret edhe me subjektivitetin dhe me identitetin, për shkak se kultura luan rol qendror në ndërtimin e ndjenjës tonë për vetveten."[16]

Tema për politikën kulturore, gjegjësisht për zhvillimin (jo) të barabartë institucional kulturor në vend, në kontekst të asaj se mund të paraqesë njërën prej shumë masave parandaluese për situata konfliktuoze në vend, jo vetëm që zgjon interesim në aspektin e përpunimit doktoratës, por mund të kontribuojë shumë drejt gjetjes së drejtimeve pozitive në definimin e përcaktimit të autoriteteve shtetërore për ndërtimin e një shoqërie më efikase dhe më humane në R. e Maqedonisë.Kuptohet se zhvillimi i politikës kulturore në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2017 kishte ndikim në ndodhitë shoqërore në Maqedoni, jo vetëm në planin e brendshëm, por edhe në atë të jashtëm, pra në aspektin ndërkombëtar, posaçërisht me vendet fqinje të Maqedonisë, fillimisht me Greqinë dhe Bullgarinë dhe në mënyrë dytësore me Shqipërinë, Kosovën dhe Serbinë.

Nëse filimet e vitit 2007 paraqesin fillim të "çmendurisë kulturore" të kreut të VMRO-DPMNE i cili ishte në pushtet, 2017-ta shënon "fillimin e fundit të kësaj çmendurie" me qasje të re të politikave kulturore nga ana e qeverisë së re të LSDM-së, e cila gjatë gjithë kohës e kishte përkrahjen e SHBA-ve dhe UE-së. Se si do të zhvillohet ky fillim i mirë i "kthjellimit kulturor" do të tregojë e ardhmja.

[16] Џордан Г. и Ведон К., Културна политика. Скопје: Темплум, 2000, стр. 14-15.

# I. HYRJE
## 1.1. POLITIKA KULTURORE DHE BARAZIA KULTURORE

**T**ema për politikën kulturore, gjegjësisht për zhvillimin (jo) të barabartë institucional kulturor në vend, në kontekst të asaj se mund të paraqesë njërën prej shumë masave preventive për situata konfliktuoze në vend, jo vetëm që ka zgjuar interesim në aspektin e punimit të doktoraturës, por shumë mund të kontribuojë në gjetjen e drejtimeve pozitive në definimin e përcaktimeve të autoriteteve shtetërore për ngritjen e një shoqërie më efikase dhe më humane në R. e Maqedonisë.

"Kultura është e qartë dhe publike, sepse kuptimi i kulturës është i këtillë. Me të nuk mund të bëni parodi..."[17] thotë antropologu Kliford Gric në librin e tij "The Interpretation Of Cultures." Këtë definicion, pushteti i Gruevskit me siguri nuk e kishte parasysh dhe për këtë, duke i parë gjendjet (tenderët e kurdisur, rezultatet e konkurseve për projektet kombëtare kulturore e të ngjashme) në kohën e tij dhe në kohën e tashme, me të vërtetë në Maqedoni kemi pasur më shumë "parodi" sesa kulturë.Kuptohet se zhvillimi i politikës kulturore në periudhën prej v. 2007 deri në 2017 kishte ndikim në ngjarjet shoqërore në Maqedoni, jo vetëm në planin e brendshëm, por edhe në planin e jashtëm, gjegjësisht në aspektin ndërkombëtar, posaçërisht me vendet fqinje të Maqedonisë, fillimisht me Greqinë dhe Bullgarinë dhe në aspektin dytësor me Shqipërinë, Kosovën dhe Serbinë.

[17] Clifford Geertz, THE INTERPRETATION OF CULTURES, Basic Books, Inc., Publishers NEW YORK, 1973, стр.12.

## 1.2. DEFINIMI I PROBLEMEVE TË HULUMTIMIT

### 1.2.1. KULTURA SHQIPTARE NË MAQEDONI

Për t'u analizuar më thellësisht dhe që të elaborohet një temë e këtillë komplekse, kuptohet se është e domosdoshme që të shqyrtohen disa çështje, edhe atë:

- Konteksti shoqëror-historik i problemit të hulumtimit
- Problemi i zhvillimit të barabartë kulturor në real-socializëm
- Shqyrtimi i situatave në rrethanat e sotme në zhvillimin e barabartë ose jo të barabartë në lëmin e kulturës që nga pavarësimi i Maqedonisë e deri më sot, edhe atë në formë të përgjithshme që nga 1990-2007
- Analiza esenciale dhe e thellë e drejtimit kulturor dhe ndikimi në planin e brendshëm dhe të jashtëm nga 2007 deri 2017.

Këto analiza janë të domosdoshme, për shkak se siç thonë tre kulturologët Sharif, Norenzajan dhe Henrih, duke i krahasuar gjendjet kulturore nga këndvështrimi i ndryshëm, në të vërtetë përparohet zhvillimi kulturor për secilin individualisht, ashtu që "...në skenën kulturore të cilën po e theksojmë, zgjedhja e grupeve kulturore i favorizonte ato vlera kulturore në norma të ndryshme sociale të cilat më së miri e promovojnë bashkëpunimin kulturor në kuadër të grupit, ndërsa suksesi është në konkurrencë me grupet tjera kulturore."[18] Kultura

[18]EVOLUTION, CULTURE, AND THE HUMAN MIND; AZIM F. SHARIFF, ARA NORENZAYAN, and JOSEPH HENRICH, "How the Cultural Evolution ofSupernatural Policing Influenced the Emergence ofComplex, Cooperative Human

shqiptare në Maqedoni përballë asaj maqedonase nuk është zhvilluar në kushte dhe mundësi të njëjta që të bëhet konkurruese dhe e respektuar as në periudhat tjera, posaçërisht është interesante periudha 2007-2017.

## 1.3. ÇËSHTJET THEMELORE HULUMTUESE

### 1.3.1. IDENTITETI I PROJEKTIT "SHKUPI 2014"

Çështjet themelore të problemit ose të temës të cilën duam që ta trajtojmë në këtë tezë janë:

- A i ka paraprirë projektit "Shkupi 2014" politika e keqe kulturore e cila në mënyrë jo të barabartë, jo të duhur dhe jo të njëjtë është zhvilluar te bashkësitë kulturore etnike dhe ky zhvillim a ka çuar deri në disa forma të caktuara të konfliktit?!
- Në cilin drejtim është zhvilluar edhe politika e keqe kulturore në periudhën nga 2007 deri 2017, me çka projekti nacional "Shkupi 2014" goditi mbi identitetin kombëtar të maqedonasve sllavë dhe në identitetin e qytetit liridashës -Shkupi?! Pikërisht për shkak të kësaj dhe orientimit arkitektonik, arkitekti prof. dr. Mirosllav Grçev e mban qëndrimin se "...ky projekt duhet të rrënohet dhe të largohet nga Shkupi si bërllok ndërtimi."[19] Madje, disa analistë konsiderojnë se largimi i këtij projekti është humanitar. Mendim të njëjtë ka edhe prof. dr. Maja Stojanova: "Nevojitet revidimi i "Shkupi 2014" nga shumë aspekte: ndërtimor, arkitektonik, juridik, politik dhe

---

Societies,Paving the Way for Civilization, Psyhology Press, New Ypork – London, 2013, стр.131.

[19]http://respublica.edu.mk/blog/2014 , Ана Василевска, "Зошто треба да се ревидира „Скопје 2014"?"Вторник, 28 Ноември 2017.

historik. Nëse vërtetohet se në aspektin ndërtimor nuk mban ose se janë shkelur ligjet të cilat e rregullojnë ndërtimin e tyre, ndërsa në aspektin politik se qëllimi parësor nuk ka qenë përmirësimi i infrastrukturës në qytet, por ridefinimi i historisë nacionale, atëherë qeveria duhet të fillojë seriozisht të mendojë për ndryshimet në projekt – nga zhvendosja e përmendoreve dhe skulpturave, rekonstruksioni i fasadave e deri në rrënimin e projektit."[20]

- Cilat ishin ndikimet pozitive dhe negative në planin e brendshëm dhe të jashtëm në këtë projekt sa kulturor, aq edhe politik në matricën e një partie politike në pushtet?!

Për këtë kohezion jonatyror të kulturës dhe politikës, kulturologu Roxher Grifin në shkrimin "Ideologjia dhe kultura" thotë: "Në vend që të ndiqet linja e hetimeve e cila fundja i vinte në pikëpyetje vlerat kulturore në të cilat disa intelektualë dinë që të shkruajnë artikuj interesant për kulturën, ndoshta është më së miri që të kthehemi dhe të fokusohemi në ideologjinë dhe kulturën si koncepte divergjente e jo konvergjente."[21] Liberalët klasikë e përkrahin meritokratinë strikte edhe në sferën ekonomike edhe në atë morale. "Për shembull, ata të cilët punojnë shumë, ata e kanë arritur pasurinë e tyre dhe meritojnë të jenë të prosperuar për dallim nga ata që janë përtacë. Një rrymë e këtillë filloi me Xhon Lokun në shek. 17, ndërsa shihet me neoliberalizmin që është nën ndikimin e Robert Nozikut. Në anën tjetër, liberalët modernë e trajtojnë drejtësinë shoqërore në aspektin e besimit se mund të

[20]http://respublica.edu.mk/blog/2014, Ана Василевска, "Зошто треба да се ревидира „Скопје 2014"?"Вторник, 28 Ноември 2017.
[21]ROGER GRIFFIN, "Ideology and culture",Journal of Political Ideologies, Oxford Brookes University, February 2006,11, стр.86.

matet barazia shoqërore. Për shembull, Xhon Rols Џон Ролс konsideron se parabarazitë ekonomike janë të arsyeshme vetëm nëse ato janë në favor të benefiteve për më të rrezikuarit, pra për më të varfërit në shoqëri. Kështu, liberalët socialë siç është Rolsi përfundojnë se shoqëria e vërtetë është ajo ku pasuria shpërndahet nëpërmjet formave të caktuara të sistemit të mirëqenies."[22] Barazia, realiteti dhe identifikimi i projektit "Shkupi 2014" aspak nuk përputhen me pamjen reale të qytetit të Shkupit si i hapur dhe i lojllojshëm në të gjitha aspektet.

## 1.4. DETYRAT E HULUMTIMIT

### 1.4.1. POPULLIZMI, ETNOCENTRIZMI DHE EKSKLUZIVITETI

Ky hulumtim ka për qëllim zbulimin në Maqedoni pas pavarësimit të saj e deri më sot se a ekziston zhvillim i barabartë kulturor në aspektin e bashkësive, të definuara në Kushtetutë dhe t'i zbulojë shkaktarët të cilat çojnë deri te zhvillimi i barabartë dhe jo i barabartë kulturor.

Kontributi i veçantë në këtë hulumtim duhet të jetë ajo a e ka zhvilluar projekti pretencioz dhe i tejdozuar "Shkupi 2014" kulturën në Maqedoni në drejtim pozitiv apo e ka bërë të kundërtën?

Sa ka ndikuar ky projekt në ngjarjet shoqërore politike brenda në vend dhe jashtë vendit?! Mbijetesa e këtij kiç projekti popullist, siç thonë shumë arkitektë (Grçev e të

[22] Gray, John, "Two Faces of Liberalism", The New Press, New York, 2000; Rawls, John, "A Theory of Justice", Oxford University Press, London, 1971.

tjerë) është vetëm teorik dhe praktik derisa ishte në pushtet Gruevski. Ngjashëm me këtë, Hana Andreht shkruan për fuqinë e Hitlerit e cila u venit pas vdekjes së tij. "Të besohet se sukseset e Hitlerit ishin të bazuara në 'fuqinë e tij që të mahnit' është krejtësisht e gabuar; vetëm me ato cilësi, ai kurrë nuk do të përparonte jashtë kabinetit të tij. Disfata dhe vdekja e tij tregojnë se ai sot është harruar në themel... madje edhe në mesin e grupeve neofashiste dhe neonaziste në Gjermaninë e pasluftës. Kjo mosvazhdimësi pa dyshim se ka ndonjë lidhje me dëgjueshmërinë dhe nënshtrimin e bashkëpunëtorëve të tij dhe masës së njerëzve të cilët kanë besuar në fuqinë e tij... lëvizjet totalitare mund të qëndrojnë në pushtet vetëm derisa ata vazhdojnë që të lëvizin dhe t'i vendosin të gjitha rreth tyre... liderët e vdekur ishin interesant derisa kanë arritur që t'i ndotin subjektet e tyre me virusin konkret totalitar; sepse pa atë virus, nuk do të ekzistonin as personalitetet totalitare."[23] Krahasimi i Gruevskit me Hitlerin kuptohet se nuk është në rrafsh të njëjtë, por mund të thuhet se dëshira e Gruevskit se si ta udhëheq shtetin, me theks të veçantë politikën kulturore me anë të identitetit të ri të maqedonasve dhe identitetit të ri të shtetit, është i ngjashëm me të Hitlerit, por Hitleri kishte interesa globale ndërsa Gruevski lokale. Për etnocentrizmin shkruan edhe sociologu Uilijam Graham Samner i cili thotë: "Etnocentrizmi është emër teknik për atë pikëpamje të gjërave, në të cilën grupi individual është qendër i të gjithave, ndërsa të gjithë të tjerët janë të nënshtruarit dhe të ranguar sipas saj. Secili grup e kultivon krenarinë dhe unin e vet, lavdërohet se është superior, lartëson dhe krijon hyjni të veta dhe i shikon me urrejtje ata

[23]Hannah Arendt (March 21, 1973) "The Origins of Totalitarianism" Harcourt, f. 324-325.

që janë jashtë tyre. Secili grup mendon se traditat e tyre janë unike, janë të drejta dhe nëse vëren se grupi tjetër ka tradita tjera, ata krijojnë urrejtje... etnocentrizmi i çon njerëzit drejt rritjes dhe intensifikimit të gjithë asaj që është e veçantë në traditat e tyre dhe që i ndan nga të tjerët."[24]

Është interesant qëndrimi i Esat Alibashiq për "ekskluzivitetin" në kuptimin kulturor, i cili thotë: "Ringjallja e nacionalizmit, keqpërdorimi politik dhe ideologjik i kulturës si dhe themelimi i politikës së definuar njënacionale kulturore tregojnë në përforcimin e koncepteve autoritare të politikës kulturore."[25] Në të vërtetë, Maqedonia këtë e kishte gjatë gjithë kohës derisa VMRO-DPMNE ishte në pushtet, nga viti 2006 deri në vitin 2016.

[24] On Liberty, Society, and Politics: The Essential Essays of William Graham Sumner. Indianapolis, Ind.: Liberty Fund, 1992, f. 178.
[25]http://www.anubih.ba/images/publikacije/dijalog/2014%20-%201-2/01%20-%20Esad%20Delibasic.pdf, Esad Delibašić (Originalni naučni rad), Etnonacionalni model kulturne politike, DOI: 10.5644/DIJALOG.2014.1-2.01, 7.

# II. MËNYRA E HULUMTIMIT

## 2. 1. POLITIKA KULTURORE DHE ZHVILLIMI INSTITUCIONAL

Tema për zhvillim të barabartë institucional kulturor në vend, në kontekst të asaj se është njëra prej shumë masave preventive për situata konfliktuoze në vend, jo vetëm që zgjon interesim në aspektin e përgatitjes së punimit të doktoraturës, por mundet shumë të kontribuojë drejt gjetjes së drejtimeve pozitive në definimin e përcaktimeve të autoriteteve shtetërore për ndërtimin e një shoqërie më efikase dhe më të qëndrueshme në Maqedoni.

Në argumentin e Shmitit rreth asaj se çka hyn në kulturë, ai thotë: "Në kulturë "hyn gjithçka" dhe kjo vështirë ndryshohet me zgjedhje individuale, kurse për disa grupe veçanërisht të hendikepuara (gra, fëmijë), kjo është e pamundur pa rrezik serioz për jetën.[26]

Kjo është e saktë, sepse buron nga fenomenologjia e brendshme e krijimit të identitetit dhe të sjelljes në grup, pra identiteti krijohet në bazë të potencimit të dallimit me indentitetet tjera dhe me potencimin e nocionit kufiri ndaj të tjerëve."[27]

Për t'u hulumtuar dhe analizuar thellësisht dhe thelbësisht kjo temë, në pajtim me problematikën ishin të

[26] Bikhu Parekh, "Rethinking Multiculturalizm", Harward University Press, Cambridge, 2000 и "Culture Pluralism and Limits of Diversity", Alternatives 20, 1995; C. H. Gray, "Postmodern War", Semiotex, New York, 1997.

[27] Abizabeh, Arash, "Does Collective Identity Presuppose an Other? On the Alleged Incoherence of Global Security"; American Poltical Review; vol.99 n.1. february 2005.

domosdoshme disa observime fillestare të gjendjes kulturore në vend, edhe atë:

- Hulumtime për gjendjet e mëparshme (në periudhën e komunizmit),
- Hulumtime për gjendjet në rrethanat e sotme,
- Hulumtime për drejtimet e mundshme në të ardhmen (se si duhet të ndërtohen dhe zhvillohen në të ardhmen gjendjet në politikën kulturore në vend).

### 2. 1.2. Qëllimet

Përgatitja e kësaj teme ka bazë shkencore dhe për këtë është shfrytëzuar metoda e hulumtimit me këta komponentë:

1. Teorike
2. Procedura ose mënyra e hulumtimit, dhe
3. Teknika ose teknikat e hulumtimit.

Në pjesën e quajtur si *Teorike,* janë cituar libra dhe artikuj lidhur me hulumtimin e situatave kulturore dhe politike si dhe lidhja e tyre me problemet shoqërore. Pa dyshim, me këtë rast duhet të theksohet fakti se përveç definimit të kulturës së një civilizimi, duhet të përmendet edhe rëndësia e kulturës në zhvillimin e civilizimit, situatat e mundshme me kriza në kulturë, paraqitja e tyre si element i çrregullimeve shoqërore (si kiç në kulturë), dhe kuptohet kohezioni i kulturës me situatën e përgjithshme shoqërore.

### 2.1.3. Kultura

Fjala *Kulturë* (lat: *colere,* "kultivon") – marrë në përgjithësi ka të bëjë me aktivitetin e njeriut; shpjegimet e ndryshme të shprehjes "kulturë" janë manifestim i teorive dhe kritereve të ndryshme të të kuptuarit dhe vlerësimit të aktivitetit të njeriut. Sipas profesorit kroat Edvard Kale, "...kultura është tërësi e cila e përfshin diturinë, fenë, artin, moralin, traditat, zakohet dhe të gjitha traditat tjera që janë përfituar në një shoqëri."[28] Kultura tradicionalisht merret si virtyt më i vjetër i njeriut, ajo që e ndan njeriun nga kafshët, edhe pse zbulimet më të reja na tregojnë se kjo vijë e ndarjes nuk është aq e mprehtë. Kultura e siguron ekzistencën e civilizimit. Ajo është paraqitur me krijimin e njeriut. Për shkrimtarin dhe kulturologun britanik Rejmond Uilijams, është e qartë vështirësia e definimit të shprehjes kulturë, para së gjithash si rezultat i llojeve të mëparshme të paraqitjes së interesave. Ai konsideron se mund të dallojmë dy lloje kryesore:

1. Theksimi i frymës së shprehjes i një mënyre të tërë të jetës e cila manifestohet nëpërmjet gjithë domenit të aktiviteteve shoqërore e që më e dukshme është në aktivitetet specifike kulturore – në gjuhë, në stilet artistike, në llojet e veprimtarisë intelektuale;
2. Theksimi i një rendi të përgjithshëm shoqëror në kuadër të së cilës, një kulturë e caktuar në stile artistike dhe në llojet e veprimtarisë intelektuale manifestohet si produkt direkt ose indirekt i një rendi, fillimisht i konstruktuar prej aktiviteteve tjera shoqërore (Vilijams, 1996: 7)

[28]Eduard Kale, Uvod o znanosti o kulturi, Školska knjiga, Zagreb, 1977, f. 17.

Kulturën e përbëjnë dy komponentë: normat tradicionale, besimet, vlerat dhe sjelljet në njërën anë, dhe individi në anën tjetër i cili në mënyrë aktive ndikon mbi ndryshimet e traditave kulturore dhe me interaksionin e tij bëhet lëvizës kryesor në ndryshimet e elementeve tradicionale të kulturës. Me këtë mund të përfundohet se kultura është përmbledhje e vlerave materiale dhe shpirtërore të cilat janë nën ndikimin e kornizave tradicionale dhe të ndryshimeve bashkëkohore të cilat e formojnë sjelljen e pranuar të anëtarëve të një shoqërie. Mënyra karakteristike e sjelljes së individit nuk paraqet vlerë kulturore nëse nuk është pjesë e traditave dhe e sjelljeve të grupit – normat shoqërore të sjelljes i përfaqësojnë rregullat e sjelljes në një kulturë.[29] Rëndësia e kësaj teorie për kulturën është ajo se zhvillimi i barabartë kulturor është i domosdoshëm me njeriun si individ, si krijues i asaj kulture, kurse krijimet individuale e formojnë kulturën kombëtare (nacionale). Në Maqedoni kemi kulturë nacionale në të cilën shfaqet papajtueshmëria e vlerave kolektive me vlerat individuale kulturore. Në të vërtetë, kultura maqedonase imponohet si kulturë dominuese mbi vlerat tjera kulturore.

[29] http://www.maccinema.com/hronologija_detali.asp?Year=2007.

## 2.2. PARASHTRIMI I HIPOTEZAVE

### 2.2.1. Zhvillimi kulturor

Në bazë të këtyre hulumtimeve, hipoteza kryesore, në të vërtetë supozimi se zhvillimi i barabartë kulturor kontribuon për preventivën e suksesshme të konflikteve në vend, është e bazuar dhe e argumentuar nga vetë ndarja buxhetore e mjeteve.

### 2.2.2. Identiteti kulturor

Zhvillimi kulturor është shprehje e identitetit kulturor të secilit komb dhe është një pjesë thelbësore e transmetimit të mendimit dhe sjelljes kolektive nga një brez në tjetrin. Për këtë shkak, rëndësi të madhe e të veçantë paraqet fakti se si dhe në cilën mënyrë zhvillohet identiteti kulturor dhe a paraqet ai/mund të llogaritet si kërcënim për paqen, nëse ai identitet kulturor zhvillohet tërësisht, pjesërisht ose shumë pak/apo aspak nuk zhvillohet. Materialet e shumta zyrtare, faktet dhe dokumentet te të cilat duhet të kemi qasje për përpunimin e kësaj teme, do ta ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme dhe një pamje adekuate për zhvillimin "e barabartë" të kulturës në R. të Maqedonisë. Dëshira për të pasur ekskluzivitet nuk është e re. Kështu, Xhon Grej mendon se "...teoria politike në Perëndim ka qenë e mbingarkuar me homogjenitet, para së gjithash për shkak të vlerave moniste në etikën iluministe",[30] ndërsa ky mendim e pasqyron realitetin e vendit tonë, kur politikanët ende

[30]Gray, John, "Two Faces of Liberalism", The New Press, 2000, стр. 76.

nuk janë të çliruar nga 'matrica e tyre homogjene e identitetit.'[31]

Në anën tjetër, zhvillimi i shpejtë i teknologjive bashkëkohore informatike na mundësojnë mbrojtje të shpejtë dhe adekuate të një pjese të trashëgimisë kulturore nëpërmjet procesit të digjitalizimit. Digjitalizimi për momentin është mënyra e vetme e shpejtë dhe e sigurt që të ruhen të mirat e arritura kulturore. Nëpërmjet procesit të digjitalizimit do të mundësohet jo vetëm mbrojtja e pasurisë kulturore, por do të ruhet dhe promovohet edhe për gjeneratat e ardhshme të cilat në këtë mënyrë do të mund të vendosin kontakt me kulturat e paraardhësve të tyre. Aleksandar Vendt mendon se: "...individët dhe kolektivet divergjojnë në relacionet e tyre shoqërore ndaj të tjerëve, duke përfshirë këtu edhe reagimet e ndryshme simbolike."[32] Kjo temë është nxitur edhe nga interesimi im ndaj ndikimit të kulturës në gjendjet e përgjithshme shoqërore në vend, ashtu që edhe përkundër ekzistimit për shumë dekada dhe zhvillimit kulturor në R. të Maqedonisë, deri më tani nuk janë bërë punime mjaft adekuate teorike të këtij lloji. Edhe përkundër numrit mbresëlënës të krijuesve nëpër fushat e ndryshme kulturore, deri më tani me disa përjashtime (monografi, numër i vogël i artikujve), asnjëri nuk ia ka parashtruar vetvetes për detyrë që t'i analizojë, hulumtojë ose të shkruajë për to, në një formë të këtillë të hulumtimit. E gjithë kjo ndikoi që t'i qasem dhe t'i përvjel mëngët drejt bërjes së një punimi të këtij lloji, në të cilin do ta analizojmë dhe shqyrtojmë llojllojshmërinë kulturore në vend, prezenca dhe ndikimi i së cilës është me rëndësi të

[31] Vërejtja jonë.
[32]Wendt, Alexander "Collecitve Identity Formation an the International State", American Political Science Review, n.88, 1994.

veçantë në formulimin përfundimtar të zhvillimit të mëtejshëm të barabartë institucional kulturor në R. të Maqedonisë. Prodhimi i gjerë i arritjeve kulturore deri më tani është një korpus i fortë empirik për kërkime dhe punime teorike me një hapësirë shumë më të madhe sesa ato të parashikuara si teza përfundimtare të studimeve të programeve të doktoratës. Për momentin ekzistojnë shumë pak hulumtime për situatat kulturore në vend në të cilat janë të përfshira kultura urbane dhe ajo rurale, por për fat të keq ato nuk ofrojnë përfundime për strukturën e përgjithshme dhe për identifikimin në këtë fushë. Shija dhe preferencat pas zgjedhjes së aktiviteteve kulturore janë gati plotësisht monoetnike, monokonfesionale dhe gati të shurdhër pdhe preferenca për gjendjet tjera kulturore te grupet tjera kulturore.

### 2.2.3. Përzierja e politikës në kulturë

Prej analizave të deritanishme në zhvillimin kulturor të vendit për përfaqësimin dhe njohjen e kulturës së tjetrit, erdha deri te njohuritë se në R. e Maqedonisë, dominimi i kulturës maqedonase kundrejt kulturave tjera është gati qind për qind, derisa në këto dhjetë vitet e fundit ajo po merr edhe drejtim tjetër të ndarjes. Në pikën 9 të definicionit të Umberto Ekos për fashizmin, shkruan: "Fashizmi bazohet në popullizmin selektiv, në një të ashtuquajtur popullizëm cilësor. Në demokraci, qytetarët kanë të drejta individuale, mirëpo në tërësi posedojnë ndikim politik vetëm në bazë të një këndvështrimi cilësor – respektohen vendimet e të mëdhenjve. Për individët, fashizmi nuk imponon asnjë të drejtë, derisa populli kuptohet si kualitet, si një entitet monolit i cili e shpreh

vullnetin e përbashkët. Por si kuantitet i madh, njerëzit nuk mund të kanë kurrnjë vullnet të përbashkët dhe për këtë lideri paraqitet si përkthyes i tij. Të privuar nga fuqia e deleguar, qytetarët nuk veprojnë, ata thirren vetëm kur duhet ta luajnë rolin e popullit. Sipas kësaj, populli nuk është asgjë tjetër përveçse një fiksion teatri. Në të ardhmen na pret një popullizëm interneti apo televiziv, ku reagimet emocionale të disa grupeve të zgjedhura të qytetarëve pranohen si zëri i popullit. Në bazë të popullizmit cilësor, fashizmi duhet të jetë kundër qeverisë parlamentare "të korruptuar". Njëra prej fjalive të para të cilat i tha Musolini në parlamentin italian ishte: "Këtë vend të shurdhër e të errët kam mundur ta shndërroj në kamp të sundimit tim." Në të vërtetë, ai menjëherë gjeti një vend më të mirë për ithtarët e tij, por më vonë ai e likuidoi tërë parlamentin. Nëse ndonjë politikan e sjell në pikëpyetje legjitimitetin e parlamentit, për shkak se parlamenti nuk e ndjek vullnetin e popullit, atëherë bëhet fjalë për fashizëm."[33] Kjo do të thotë se hendeku i përkrahjes institucionale ndaj kulturave tjera edhe më shumë thellohet nëpërmjet realizimit të projektit "Shkupi 2014". Ky projekt tashmë e tejkalon edhe karakterin monoetnik dhe monokonfesional, por po rritet në monopartiak dhe skajshëm në pjesë degjeneruese të kulturës maqedonase. Kjo temë do të trajtohet dhe analizohet thelbësisht në një kapitull të temës, me përfundime analitike se ky projekt është shkelje e rëndë e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Projekti thjesht i keqpërdor të gjitha ndjenjat nacionale dhe kulturore të popullit maqedonas (nëpërmjet një raporti shumë të padrejtë ndaj veprimtarëve të historisë

[33]http://www.idividi.com.mk/omnibus/panorama/899922/index.htm.

maqedonase), me imponimin e tezës se maqedonasit kanë prejardhje antike. Në këtë mënyrë, në të vërtetë ata e ndajnë popullin maqedonas në dy popuj, pra në maqedonas antik dhe në maqedonas sllavë. Pikërisht për shkak të këtij fakti krucial si dhe për shkak të papranueshmërisë dhe rezistencës së madhe të këtij projekti tendencioz nga ana e kulturave tjera kombëtare në vend, veçanërisht nga komuniteti shqiptar në Shkup, ky kapitull do të jetë një pjesë e rëndësishme e disertacionit tim të doktoratës.

Kjo pozitë e detyruar dhe e imponuar nga ana e një kulture të caktuar në nivel institucional në raport me kuantitetin dhe mënyrën e përpunimit të këtyre projekteve kulturore, krijoi bazë për hulumtimet e mia dhe për përgatitjen e tezës time të doktoratës.

Fillimet e zhvillimit kulturor në Republikën e Maqedonisë pas Luftës së Dytë Botërore nuk ishin aspak aq të pakujdesshme, me qëllim që ta përjashtojnë një kulturë nga të tjerat. Përkundrazi, proletariati i asaj kohe, pavarësisht nga ajo se vetë faktet e formimit të institucioneve shihet se nuk ishte gjithçka e drejtë, por thirrej vazhdimisht dhe mbrohej hapur për një zhvillim të ekuilibruar kulturor institucional të të gjitha grupeve kombëtare që jetonin në Maqedoni.

Derisa sot në R. e Maqedonisë, zhvillimi i kulturës vetëm në këto pesë vitet e fundit po i rrënon të gjitha principet e shpërndarjes fer, korrekte dhe institucionale të mjeteve buxhetore për kulturat jomaqedonase në vend, posaçërisht është irritues qasja e tyre në promovimin momental të renesancës kulturore të maqedonasve antik.

Tema se kjo tezë i shkel nevojat rajonale për bashkëpunim të mirë fqinjësor me shtetin fqinj Greqinë ka gjithashtu një rëndësi të madhe dhe sigurisht se do të jetë

pjesë e kësaj teze të doktoratës, por me më pak hapësirë sesa ajo për rrënimet e brendshme të kartës së identifikimit të R. së Maqedonisë në secilin kuptim të fjalës.

Gjithashtu, edhe bashkëpunimi me Bullgarinë fqinje me të cilën Maqedonia ka të kaluar të përbashkët, kurse në të vërtetë bëhet fjalë për historinë dhe rrënjët e përbashkëta, pas ndarjes nga formimi i ish federatës jugosllave, kjo ndarje është bërë shumë më e madhe. Këto mospajtime historike për të kaluarën e përbashkët nuk mund të largohen përnjëherë, sepse nevojitet kohë dhe guxim nga të dyja vendet.

Bullgaria dhe Maqedonia kah fundi i vitit 2017 nënshkruan Marrëveshje për miqësi, edhe atë parimisht e mirë dhe e pranueshme jo vetëm për të dy vendet, por edhe për rajonin e qetë të Ballkanit.

# III. ZHVILLIMI KULTUROR NË R. E MAQEDONISË SË VERIUT

## 3.1. KONTEKSTI SHOQËROR-HISTORIK I PROBLEMIT TË HULUMTIMIT

### 3.1.1. Historia e zhvillimit kulturor në R. e Maqedonisë së Veriut

Pas Luftës së Dytë Botërore, Maqedonia si republikë e barabartë e Republikës Populllore Socialiste e Jugosllavisë, për herë të parë filloi që të ekzistojë si republikë e kombeve dhe kombësive në Maqedoni.

Kështu, populli maqedonas u zyrtarizua si popull maqedonas, derisa kombësia shqiptare dhe ajo turke si kombësi.

Në atë periudhë (prej 1945 deri 1948) u zhvillua pushteti gjithëpopullor i cili në frymën dhe principet e komunizmit përpiqej të ndërtonte barazi në të gjitha fushat e shoqërisë, ashtu edhe në kulturë. Në vitin 1945 dolën dy gazeta në gjuhën maqedonase dhe shqipe ('Nova Makedonija' e cila dilte në gjuhën maqedonase dhe 'Flaka e Vëllazërimit' e cila dilte në gjuhën shqipe, ndërsa pas kësaj doli edhe 'Birlik' i cili dilte në gjuhën turke).[34]

Në të njëjtën kohë u formuan edhe shoqëritë kulturore maqedonase dhe shqiptare, 'Orce Nikollov' dhe 'Emin Duraku', më vonë u formua edhe 'Yeni Yol' i valleve dhe këngëve turke.

Me këtë tekst po shihet se fillimi ishte mjaft korrekt.

[34]http://mk.wikipedia.org/wiki Народна_Република_Македонија.

### 3.1.2. Politikat kulturore nga viti 1945 deri 1990

Duke i pasur parasysh këto fakte të cilat janë zyrtare në Republikën e atëhershme Socialiste të Maqedonisë, po vërtetohet teza jonë se kemi diskriminim edhe në strukturën mendore, edhe në përdorimin praktik të diskriminimit. Kjo periudhë karakterizohej edhe me atë se ekzistonte njëfarë censure ideologjike ndaj të gjitha veprimtarive, ndërsa për kulturën shqiptare dhe atë turke ekzistonin dy e më shumë censura përveç asaj ideologjike. Për shembull, 'Flaka e Vëllazërimit' nëse dëshironte që t'i publikojë 10 vepra për një vit, më së paku 3 deri 5 prej tyre duhet të ishin përkthime nga autorë maqedonas në gjuhën shqipe. Ose ta marrim si shembull Teatrin e Kombësive, dramën shqipe ose turke. Ata kishin rregull jo të shkruar që t'i kanë nga 5 shfaqje në vit, prej të cilave njëra duhet të ishte nga dramaturgjia maqedonase, njëra nga ajo jugosllave, njëra të ishte botërore, njëra shfaqje për fëmijë nga cilado dramaturgji dhe njëra duhet të ishte dramaturgji shqiptare ose turke.

Në produksionin muzikor, deri në ekstrem lexoheshin madje edhe presjet dhe pikat e teksteve të këngëve të cilat realizoheshin në Radio Televizionin e Shkupit të atëhershëm. Mbi të gjitha, kjo periudhë karakterizohej me mbikëqyrje të thellë të shërbimeve federale dhe republikane të inteligjencës të ish RSFJ dhe RSM.

Në fund duhet të theksohet se matricat e atëhershme shoqërore dhe ideologjike krijuan një zhvillim të angazhuar të kulturës me ç'rast përveç censurës së përgjithshme, ajo e kishte edhe censurën personale të artistëve të cilët përpiqeshin që t'ju ikin konflikteve me ideologjinë, pra me shtetin.

# IV. PJESA KRAHASIMTARE:

## 4.1. VEPRIMTARITË KULTURORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË nga viti 1990 deri 2017

### 4.1.1. Pasqyra e përgjithshme

Shqyrtimi i situatave në rrethanat e sotme të zhvillimit të barabartë ose jo të barabartë në fushën e kulturës që nga pavarësimi i Maqedonisë e deri më sot (1991-2017).

### 4.1.2. Censura

Shprehja censurë nënkupton "...shtypjen e fjalës ose të një lloji tjetër të komunikimit e cila mund të konsiderohet e pakëndshme, e dëmshme, e ndjeshme ose jo e përshtatshme për opinionin sipas rregullave të përcaktuara nga qeveria, nga mediat ose nga trupat tjerë të kontrollit."[35] Sipas Wikipedia në gjuhën maqedonase, ekzistojnë disa arsye dhe lloje të censurës: "Arsyet për censurë janë të ndryshme dhe në këtë aspekt, ekzistojnë disa lloje të censurës:

- **Censura morale** është heqja e materialeve të papërshtatshme ose në ndonjë mënyrë tjetër konsiderohen kontestuese në aspektin moral. Për shembull, pornografia shpesh është censuruar për këtë arsye, posaçërisht pornografia e fëmijëve e cila nuk është legale dhe është e censuruar me shumë kompetenca gjyqësore në botë.
- **Censura ushtarake** është proces i mbajtjes së inteligjencës ushtarake dhe i strategjive sekrete larg nga

[35]https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%0

armiku. Këtu përfshihet edhe spiunimi i cili është proces i grumbullimit të informacioneve ushtarake. Shumë shpesh ushtritë përpiqen të fshehin informacione të papërshtatshme politikisht edhe kur informacionet e tilla nuk kanë ndonjë vlerë reale inteligjente ose ndonjë vlerë strategjike luftarake.

- **Censura politike** ndodh kur qeveritë fshehin informacione nga qytetarët e tyre. Kjo shpesh bëhet për ta kontrolluar popullsinë dhe për ta parandaluar shprehjen e lirë e cila mund të nxisë rebelim. Një version tjetër i censurës është se ajo është një fenomen dezinformimi i cili e përdor "diverzionin" për të larguar njerëzit nga temat e diskutueshme.
- **Censura fetare.** Kjo më së shpeshti nënkupton se feja dominuese imponon kufizime te fetë më pak të përfaqësuara. Përndryshe, një fe mund të jetë në krah të një tjetre kur beson se përmbajtja e caktuar nuk është e përshtatshme për besimin e tyre.
- **Censura e korporatave** është një proces me të cilin redaktorët ndërhyjnë në media për të parandaluar botimin e informacionit i cili e portretizon biznesin ose biznes partneritetin e tyre në aspektin negativ, gjegjësisht ndërhyjnë për të parandaluar arritjen e kërkesave të vazhdueshme për publikimin e informacionit në lidhje me problemin.

Çarls T. Gorham në librin "Inkuizicioni i Mesjetës" shkruan se "Çlirimi i parë papal në këtë temë është dekreti i lëshuar nga ana e papës Gregori XI në vitin 1376, në të cilin janë dhënë instruksionet për inkuizicionin që t'i hetojë dhe dënojë shkrimet e dyshimta, por nuk është e njohur se cilat ishin rezultatet. Ishte vërtetuar se arqipeshku i cili i dogji disa shkrime të Xhon Viklifit në Pragë i kishte tejkaluar

kompetencat e tij, kështu që deri në fillim të shekullit gjashtëmbëdhjetë ishte vendosur censurë e rregullt, ndërsa më pastaj vetëm në Gjermani. Edhe përkundër kësaj, inkuizicioni ishte përgatitur që të ndërmarrë përgjegjësi shtesë dhe me këtë kishte krijuar rregull sipas të cilit, ai i cili posedon libra fetare të dyshimta, duhej në një afat prej tetë ditëve që t'i dorëzojë te peshkopi ose te inkuizatori në rajonin e tij."[36]

Është interesante se autori në fund të kësaj fjalie flet për "instruksionet e dhëna nga inkuizicioni që t'i hetojë dhe dënojë shkrimet e dyshimta, por nuk janë të njohura rezultatet"[37], kurse me këtë bëhet e ditur se nuk ishte e lehtë që të shkatërrohen dhe digjen librat që ishin publikuar, pa marrë parasysh përmbajtjen e tyre. Në kohën e ish Jugosllavisë kishte disa lloje të censurës, kryesisht në letërsi dhe muzikë. Ajo paraqitej nganjëherë në formën e "paralajmërimit" kur ju thuhej gjatë përgatitjes se "kjo nuk shkon". Si për shembull, regjisorit Agim Sopi në filmin "Njeriu prej dheut"[38] në produksion të Kosovafilmit, iu imponua që t'i heqë disa sekuenca ku shihen "shqiptarët duke u ndjekur me dhunë për t'u shpërngulur në Turqi." Ngjashëm kaloi edhe aktori maqedonas Risto Shishkov i cili për shkak të një shpërthimi njerëzor gjatë xhirimit të filmit UJËRAT ("KOHA, UJËRAT është film maqedonas me skenar të Jovan Strezovski, në regji të Branko Gapo. Montazhin e ka bërë Olga Donkiq, muzikën e ka

[36]Чарлс Т.Горхам, "Средновековна инквизација" (студија за религиозните прогонства), превод Лидија Ковачева: Центар за духовно и културно наследство, Скопје, 2015, стр. 109.
[37] Чарлс Т.Горхам, "Средновековна инквизација" (студија за религиозните прогонства), превод Лидија Ковачева: Центар за духовно и културно наследство, Скопје, 2015, стр. 109.
[38] https://sq.wikipedia.org/wiki/Njeriu_prej_dheu.

kompozuar Risto Avramovski. Në film luajnë Boris Dvornik, Dushko Kostovski, Lidija Pletl, Petre Përliçko, Meto Jovanovski, Petar Arsovski, Milan Shtrljiq etj."[39]), kur tha "deri kur ne aktorët maqedonas do të luajmë jeniçerët, kurse aktorët kroat dhe serb do t'i luajnë heronjtë tanë"[40] ai u dënua me burg. Sipas Wikipedia, "Në vitin 1979 është akuzuar për ofendim të aktorëve serbë dhe kroatë, po ashtu edhe të Titos. Është akuzuar si nacionalist, separatist dhe hegjemonist dhe më 15 janar 1980 ai hyri në burg."[41]

Me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe me rënien e komunizmit nëpër të gjitha shtetet socialiste, u imponua teza se popujt e këtyre shteteve do të jenë më të lirë, arti do të zhvillohet nëpërmjet vlerave artistike pa ideologjizime dhe kuptohet, pa censurë.

### 4.1.3. Periudha e tranzicionit kulturor në Maqedoni (1990-2000)

Në këtë periudhë, të gjitha shoqatat kulturore që u formuan në bazë të iniciativave të pavarura ose ishin iniciuar prej qarqeve partiake të partive të shqiptarëve, turqve, serbëve, romëve etj., kishin për synim, madje edhe premtime se do të jenë pjesë e përkrahjes stabile financiare e shtetit të Maqedonisë. Pikërisht për këtë shkak, duke pritur në derë, ndërsa dera askund nuk shihej. Shoqata e Botuesve Shqiptarë në vitin 2000 dërgoi letër deri te të gjitha strukturat e larta qeverisëse në vend, deri te KB, UNESKO, SHBA, NATO etj., me dokumentin e titulluar GJENOCIDI KULTUROR MBI SHQIPTARËT nga viti 1990 deri në vitin

[39]https://mk.wikipedia.org/wiki/Време,_води_(филм).
[40]Парфразиран говор кој е сличен на оној висњтнискиот на Ристо Шишков, оти беше невозможно да најдеме документирана негова изјава.
[41] https://mk.wikipedia.org/wiki/ Ристо_Шишков.

2000. Fjalori i këtij dokumenti me të vërtetë ishte jodiplomatik dhe gjuhëmprehtë, mirëpo argumenti i shtruar në atë kohë sipas kësaj shoqate ishte:

*Ministria e Kulturës nën kulmin e saj i kishte rreth 260 institucione kulturore (ndërsa vetëm një gjysmë institucion – Dramën Shqiptare te teatri i kombësive), në të cilën ishin të punësuar rreth 2900 persona, prej të cilëve vetëm 60 ishin shqiptarë. Në vetë Ministrinë e Kulturës, prej 34 të punësuarve, vetëm dy janë shqiptarë etnik, derisa në mesin e 15 të tjerëve të cilët punojnë me kontratë, asnjëri prej tyre nuk është shqiptar. Situata është e ngjashme edhe nëpër institucionet tjera kulturore me interes publik (shtëpitë e kulturës, bibliotekat, arkivet, muzetë...).*[42]

Me alarmimin e situatës me kulturën në Maqedoni, me të vërtetë strukturat politike në vend filluan që ta tërheqin vëmendjen në këtë pakënaqësi të shprehur nga ana e botuesve shqiptarë. Madje, deputetët e opozitës dhe pozitës së atëhershme shqiptare (Aziz Pollozhani, Arben Xhaferi) të cilët ishin në Unionin Evropian si deputetë vëzhgues në Parlamentin Evropian, ata u obliguan se do ta aktualizojnë këtë dokument në këtë parlament. Në dokumentet zyrtare të Unionit Evropian nuk gjendet ky dokument, në qarqet jozyrtare dokumenti ishte lëndë e përpunimit dhe analizës. Por për fat të keq, që nga ajo kohë situatat në vend shumë pak janë përmirësuar.

Zhvillimi kulturor pas vitit 2000 fillon të zhvillohet në stilin KUKAFSHEHTAS apo më saktë KUSH KË DO TA MANIPULOJË MË SHUMË. Kuptohet, ai që është në pushtet, ai gjithmonë do të jetë në pozitë më të mirë.

[42] Shoqata e Botuesve Shqiptarë: Gjenocidi arsimor dhe kulturor ndaj shqiptarëve të Maqedonisë 1990-2000, Shkup, 01.04.2000.

Në këtë garë, tërësisht ka humbur fryma e kulturës në të cilën veprimtaritë kulturore shqiptare, turke, rome dhe serbe tërësisht janë anashkaluar.

Kjo shihet qartë në vetë Raportin të cilin e dorëzon Ministria e Kulturës çdo vit në PROGRAMIN VJETOR për realizimin e interesit nacional në kulturë për vitet në vijim. Për shembull, në vitin 2008 në web faqen: http://kultura.gov.mk/images/stories/dokumenti/programa/PROGRAMA__2008_n.pdf, nuk ka raporte të këtij lloji për vitet e mëparshme, por edhe sikur të ishin apo të na e kishin dhënë një raport të tillë të detajuar për ndarjen e mjeteve, përqindja e parave për kulturat jomaqedonase do të ishte e ngjashme, madje më negativ. Karakteristikë për këtë periudhë është jotransparenca, përdorimi i masave dhe rregullave të cilat përdoreshin në ish RSFJ. Por, për hir të së vërtetës, këto masa dhe kritere ishin më të standardizuara se sa pas kësaj periudhe. Ndikimi i ministrave në këto kritere ishte minimal, gjë që nuk është rasti prej vitit 2003 deri në vitin 2012. Çdo ministër, pas ardhjes së tij sillte masa dhe rregulla të reja të cilat vetë nuk i respektonin ose më saktë i injoronin. I këtillë ishte rasti me formimin e Këshillit të kulturës në vitin 2008 kur reaguan disa shoqata të qytetarëve: Shoqata e Shkrimtarëve Shqiptarë, e historianëve, e botuesve, pastaj ART VIZIONI si artistë, si dhe Qendra Kulturore SHKUPI. Reagimi i tyre ishte se në këshill nuk ishte asnjë jomaqedonas. Pas këtyre reagimeve, ata emëruan verbalisht vetëm dy persona të nacionalitetit jomaqedonas prej gjithsejtë 15 këshilltarëve të ministres. Madje edhe ata dy (një shqiptar dhe një turk) kurrë nuk u kuptua se a ishin dhe kush ishin ata.

# V. PËRFUNDIMI PËR KONTEKSTIN E BRENDSHËM KULTUROR

## 5.1. SHMANGIA E KONFLIKTIT

### 5.1.1 RIORGANIZIMI I MINISTRISË SË KULTURËS

**P**ërveç arsyetimeve të theksuara kohë pas kohe që nga viti 2000 kur edhe daton iniciativa për formimin e një departamenti të veçantë për kulturën shqiptare, mendojmë se zgjidhja më pragmatike dhe më e sigurt është riorganizimi i brendshëm i Ministrisë së Kulturës, ashtu që të krijohen tre departamente të kulturës me ndarje proporcionale të mjeteve dhe me autonomi të plotë të vendim marrjes të secilit prej tyre.

Ministria e Kulturës do të ishte nën një ndërtesë, por me tre departamente, edhe atë:

1.Departamenti i kulturës maqedonase

2.Departamenti i kulturës shqiptare

3.Departamenti për bashkësitë tjera etnike në RM

Me një zgjidhje të këtillë, ne do të përpiqeshim që tërësisht ta depolitizojmë dhe departizojmë kulturën në vendin tonë.

Kjo nënkupton:

- Korniza stabile për qëndrueshmërinë dhe afirmimin e vlerave kulturore
- Institucionalizimi i zhvillimit të kulturës (dhe jo zhvillimi i rastësishëm kulturor i kulturës jo-maqedonase)
- Afirmimi i institucioneve të depolitizuara (Ministria e Kulturës, Arsimit, Sportit, Mjedisit, etj.)
- Mekanizëm mbrojtës të shpërndarjes proporcionale të buxhetit të shtetit mbi përfaqësimin etnik.

•Përgjegjësia e këtyre organeve shtetërore dhe institucioneve për avancimin kulturor të vlerave (sistemi i vlerave nuk ekziston për një kohë të gjatë, madje as ato që nuk i dëshironim në një kohë tjetër dhe nuk krijuam të reja)

•Eliminimi i abuzimeve financiare dhe i keqpërdorimeve tjera të pozitës (konflikt interesi, abuzim financiar, kulturë e angazhuar në një kuptim politik, etj., të cilat ishin karakteristikë e Ministrisë së Kulturës në këto 15 vjet, dhe veçanërisht në 4 vitet e fundit, në të cilat jotransparenca, fshehja e buxhetit dhe ndarja e atij buxheti jepte dyshime të përditshme për opinionin, ndërsa ata që supozohej t'i parandalonin, u bënë mbrojtësit e tyre. E çuditshme, apo jo?!)

•Krijimi i mundësive të barabarta për menaxhim profesional të kulturës (pa amatorizëm, pa projekte klasike fitimprurëse).[43] Shiko Programin e kulturës për vitin 2008.

•Krijimi i një atmosfere të vërtetë multikulturore në vend (dhe jo një multikulturë që zhvillohet për keqpërdorimin e parave të shtetit dhe donatorëve të huaj).

•Krijimi i rivalitetit të vlerave kulturore.

•Njohja e vërtetë me vlerat kulturore të tjetrit dhe avancimi i përbashkët i vlerave të përbashkëta kulturore.

Këto janë përfitimet e riorganizimit të Ministrisë së Kulturës, ndërsa nëse vazhdohet me metodën e vjetër e cila është aktuale, ne besojmë se nuk ka mekanizma as për shpërndarjen proporcionale të mjeteve, as përgjegjësi adekuate për kulturat individuale, as mundësi minimale për zhvillim të ekuilibruar kulturor.

[43]http://kultura.gov.mk/images/stories/dokumenti/programa/PROGRAMA__2008_n.pdf

# VI. IMPLIKIMET E POLITIKËS KULTURORE E CILA IDENTIFIKOHET ME PROJEKTIN "SHKUPI 2014"

## 6.1.1. PROJEKTI "SHKUPI 2014" NË ASPEKTIN KULTUROR

Se fillimi i ngjarjeve të vitit 2007 filloi të dalë në pah pikërisht për shkak të dëshirës për një epërsi kulturore është deklarata e Knut Velebeck. Në deklaratën e tij të cilën e dha në mbledhjen plenare të 718 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, Komisari i Lartë për pakica kombëtare i OSBE-së theksoi se një interes i veçantë për vizitën e tij në vend në vitin 2008 ishte arsimi i mesëm. Ai deklaroi se "ka trend alarmues për ndarje në bazë të vijës etnike." Sipas tij, kjo ndarje në disa raste të caktuara rezulton madje edhe në dhunë. Ai i thirri autoritetet që t'i ndalin këto trendë të ndarjes.[44] Pikërisht në këtë aspekt, në librin e njëjtë të serialit të popullarizuar shumëgjuhësh për fëmijë "Nashe maalo" thuhet: "Në një seri sondazhesh të kryera me rastin e serialit televiziv "Nashe Maalo", u shqyrtuan stereotipet etnike për maqedonasit, shqiptarët, turqit dhe romët që kanë fëmijë në moshën dhjetë vjeçare - anëtarë të të katër komuniteteve etnike. Rezultatet treguan se përveç fëmijëve romë, të gjithë fëmijët e tjerë e shohin grupin e tyre etnik në një dritë pozitive dhe të gjithë të tjerëve iu atribuojnë stereotipe negative. Në të njëjtën kohë,

[44] STUDIJA za multikulturalizam i me|uetni~ki odnosi vo obrazovanieto / [avtori Violeta Petroska - Be{ka ... i dr.]. - Skopje : Kancelarija na UNICEF, 2009 st. 21 (Statement by Knut Vollebaek, OSCE High Commissioner on National Minorities, The 718th plenary meeting of the OSCE Permanent Council (2009).

romët janë shënjestra e stereotipave më intensive negative dhe distancimit shoqëror, veçanërisht nga fëmijët shqiptarë dhe turq, ndërsa fëmijët maqedonas ua atribuojnë karakteristikat më negative agresive shqiptarëve dhe turqve."[45] Këto të dhëna vërtet alarmante, në vend që vendi të bënte projekte me interes dhe karakter të përbashkët për t'i afruar qytetarët e saj, Qeveria e Republikës së Maqedonisë nga viti 2007 e tutje, bëri të kundërtën. Projekti "Shkupi 2014" me të gjitha monumentet e tij të kontestuese të cilët jo vetëm që janë në kundërshtim me frymën dhe imazhin e qytetit të Shkupit, i cili është kryesisht një qytet multietnik, i cili për një kohë të gjatë historikisht dhe demografikisht ishte qyteti më i madh ku shqiptarët ishin shumicë deri në regjistrimin e fundit nga viti 1919, ku sipas autorit të tekstit "...në vitin 1919 në Shkup jetonin: 81,31 përqind shqiptarë, 0,0 përqind maqedonas."[46]Në Shkup kishte 81,31 për qind shqiptarë dhe asnjë maqedonas, përkundër regjistrimit të fundit zyrtar të vitit 2002 kur në Shkup kishte 25,71 përqind shqiptarë. Regjistrimi i fundit kaloi me pakënaqësi nga disa anë. Shqiptarët besojnë se numri i tyre është shumë më i lartë dhe nga ana tjetër, disa organizata më të vogla politike joparlamentare maqedonase besojnë se numri i shqiptarëve është nën 20 përqind, me qëllimin që të drejtat e tyre të mos garantohen me kushtetutë për një popullsi, përqindja e së cilës është 20 përqind.

Sidoqoftë, Shkupi me 25,71, dhe mbi atë përqindje ose më pak, ende e ka imazhin dhe shpirtin e një qyteti

[45] STUDIJA za multikulturalizam i me|uetni~ki odnosi vo obrazovanieto / [avtori Violeta Petroska - Be{ka ... i dr.]. - Skopje : Kancelarija na UNICEF, 2009 str. 23.
[46]https://telegrafi.com/shkupi-1919-81-31-per-qind-e-popullsise-shqiptare-zero-per-qind-maqedonas/

multikulturor, për shkak të faktit se në të jetojnë turq, bullgarë, serbë, vllehë, boshnjakë, romë, kroatë, malazezë, etj., aq më tepër që si kryeqytet i Maqedonisë, në të vijnë dhe shkojnë turistë, biznesmenë, të afërm, etj. nga të gjitha kombet e Ballkanit.

Pikërisht për shkak të këtij aktiviteti, Shkupi nuk mund të jetë as qytet antik, as qytet ortodoks, as shqiptar, as grek, maqedonas, bullgar, serb etj. Gjatë historisë, Shkupi e ka ndërtuar imazhin e një qyteti të hapur të lirë dhe pas tërmetit të vitit 1963, kur shumë shtete nga e gjithë bota e ndihmuan Shkupin që të ndërtohej, ai imazh fitoi edhe më shumë rëndësi. Në fakt, kjo frymë ndihet, duke pasur parasysh qëllimin e projektit "Shkupi 2014" për t'i dhënë një imazh tjetër qytetit.

Autorja dr. Maja Stojanova, në përshkrimin e saj të gjerërreth asaj se *PSE DUHET TË RISHIKOHET PROJEKTI "Shkupi 2014"*[47], ka sjellë disa të dhëna interesante, për shembull, në pjesën ku thuhet: "Është e nevojshme të rishikohet projekti "Shkupi 2014" në disa aspekte: ndërtimore, arkitektonike, juridike, politike dhe historike. Nëse konfirmohet se nga pikëpamja e ndërtimit ky projekt nuk mbështetet ose se ligjet janë shkelur... atëherë Qeveria duhet të fillojë seriozisht të mendojë për ndryshimet në projekt - nga zhvendosja e përmendoreve dhe skulpturave, rindërtimi i fasadave e deri në rrënimin e projektit."[48]

Në tekstin e gjerë dhe analitik të profesoreshës ka shpjegime të shkruara si tituj të ndërmjetëm, siç është ky: "Krijimi i një politike të re identiteti."[49] Në këtë pjesë, ajo shkruan: "Nëse krahasojmë pamjen e kryeqytetit nga

[47] http://respublica.edu.mk/blog/2014, објавен Вторник, 28 Ноември 2017, (Наслов).
[48] http://respublica.edu.mk/blog/2014 (Поднаслов).
[49] http://respublica.edu.mk/blog/2014 (Меѓунаслов).

pavarësia në vitin 1991 e deri më sot, do të vërehet se qyteti ka pësuar një transformim rrënjësor, por jo si rezultat i përshtatjes ndaj trendeve të reja arkitektonike, por mbi të gjitha si pasojë e projektit madhështor "Shkupi 2014." Qëllimi kryesor konceptual i këtij projekti ishte rikrijimi i historisë së popullit maqedonas dhe kështu krijimi i një politike të re identiteti i konceptuar përmes të ashtuquajturës procesi i ***antikizimit***, mesazhet e të cilit iu drejtuan kryesisht fqinjit jugor Greqisë, me të cilin kemi mosmarrëveshjen e mirënjohur të pazgjidhur të emrit. Qëllimi në atë aspekt u arrit me ngritjen e përmendores së Aleksandrit të Madh në qendër të sheshit të qytetit të quajtur "Luftëtari mbi kalë" në vitin 2011. Më vonë, babait të tij Filipi II i Maqedonisë; monumenti i nënës së tij Olimpia; pastaj me riemërtimin e Aeroportit Petrovec në Aeroportin Aleksandri i Madh; me riemërtimin e autostradës nga Tabanovce në Gjevgjeli në Aleksandar Makedonski dhe me riemërtimin e stadiumit të futbollit në Shkup në Arena Filipi i Dytë Maqedonas. Sipas një qëndrueshmërie logjike, termi ***antikizim*** nuk është aspak një term adekuat si emërues i përbashkët për të gjitha objektet që gjenden në projektin e futjes së neoklasicizmit në arkitekturën e zonës në qendër të qytetit, sepse projekti "Shkupi 2014" përmban gjithsej 137 objekte, 34 prej të cilave janë përmendore dhe 39 skulptura dhe të gjitha ato nuk janë pjesë e periudhës antike.

Problemi i dytë që tregon se me këtë zgjidhje arkitektonike krijohet de facto një politikë të re identiteti është pohimi që i imponohet me këmbëngulje publikut se maqedonasit rrjedhin nga maqedonasit antikë dhe jo nga sllavët. Një promovim i tillë i tezave të ndryshme për

origjinën e kombit shkakton debate gjithnjë e më të tensionuara dhe konfuzion të madh.

Nëse teza për origjinën antike të maqedonasve u imponohet brezave të rinj, atëherë çfarë do të ndodhë me ata që mësuan se rrjedhin nga sllavët që erdhën në Ballkan nga prapa Karpateve në shekujt 6 dhe 7? Është e qartë se aktualizimi i kësaj çështje ngriti disa dilema të tjera: (1) A e njohim mjaft mirë historinë tonë?; (2) Pse opinioni profesionist qëndroi anësh në vend që të lajmërohet se cila nga dy tezat është më e besueshme?[50]

Këtyre shpjegimeve të thella të profesoreshës, duhet shtuar se veçoritë fetare, etnike dhe të tjera të qytetit po shemben, sepse sheshi i qytetit në këtë mënyrë joprofesionale është i mbushur me një tezë të imponuar dhe ideologji kulturore, e cila nuk ka pika të përbashkëta me njerëzit e gjallë këtu të clët kontribuan në ndërtimin dhe ekzistencën e Shkupit. Tajfel dhe Tarner e theksojnë veçanërisht njohjen/pranimin se "cili është aspekti më minimal i identitetit. Kjo është e rëndësishme për të përcaktuar se deri në cilën shkallë autsajderët e pranojnë dhe e njohin një identitet të veçantë, ndërsa deri në cilën shkallë e pranon veçantinë dhe ekskluzivitetin, pra deri në çfarë mase i përjashton të tjerët."[51] Qeveria e mëparshme nuk u kushtoi vëmendje këtyre identiteteve kulturore të lëkundura në Shkup dhe në vend.

[50] http://respublica.edu.mk/blog/2014 (Текст од меѓународен).

[51] Tajfel, Henry ed.,,Social Identity and Intergroup Relationas", Cambridge University Press, 1982 и Turner, Jonathon "A Theory of Social Interaction, Stanford University Press, 1988.

## 6.1.2. PROJEKTI "SHKUPI 2014" NË ASPEKTIN ARKITEKTONIK

**Sh**umë pak njerëz e kuptojnë se fillimet e projektit "Shkupi 2014" u hodhën në vitin 2005, kur Ministri i Kulturës Blagoja Stefanovski, duke filluar nga fiksimet e tij teatrore profesionale si regjisor dhe nostalgji për ish teatrin hebre, gjegjësisht teatrin serb, të quajtur Teatri i Vjetër, e filloi idenë për rinovimi e këtij teatri të famshëm në Shkup. Fondet e para të alokuara për teatrin në 2006 ishin rreth 4 milion euro.

Buxheti i përgjithshëm për këtë teatër në atë kohë ishte rreth 15 milion euro. Arkitektët e atëhershëm nga VMRO vlerësuan se buxheti ishte i fryrë dhe jo real. Fatkeqësisht, kur ata erdhën në pushtet, ky buxhet u bë rreth 50 milion euro! Por kjo është një temë tjetër.

Teatri nga Teatri i Vjetër tani është bërë zyrtarisht Teatri Kombëtar Maqedonas. Vepra politike e ringjalljes së këtij mega-projekti filloi me pothuajse të gjithë aktorët politikë në qeveri që nga viti 2005. Të gjithë e shtuan një gur për ndërtimin e këtij projekti, disa me propozime specifike dhe konkluzione të Qeverisë (LSDM dhe VMRO), dhe të tjerët me propozime folklorike në media se gjoja projekti nuk është monoetnik dhe monofetar (BDI dhe PDSH).

Dhe në tërësi, tani e kemi situatën që sheshi është përgjysmuar nga vendosja e objekteve, fontanave, përmendoreve dhe skulpturave, që për disa është bukuri, dhe për të tjerët është tmerr.

Për një projekt të këtillë, profesoresha dr. Maja Stojanova ka shprehur dilemën se a është ky renovim urban apo kiç arkitektonik, duke thënë: "Projekti "Shkupi 2014" i

cili ishte paralajmëruar qysh në vitin 2010 si një prej mega projekteve të Qeverisë së Nikolla Gruevskit, përfundimisht është njëri prej projekteve më të përfolura dhe më kontrovers i cili e tërhoqi vëmendjen jo vetëm të opinionit në Maqedoni, por edhe në botë.

Është e qartë se Gruevski me vetëdije shkonte në kundërshtim me rrjedhat globale të cilat ishin gjithkund. Për këto lëvizje është mirë të përmendet qëndrimi i teoricienit serb Mirosllav Pejiçiq i cili thotë: "Lloj i veçantë i globalizimit politik është përhapja e demokracisë dhe i të drejtave të njeriut nëpër rajone të botës, ku nuk kanë qenë kurrë. Që nga rrënimi i regjimit diktatorial në Portugali në vitin 1974, numri i demokracive në botë përjetoi një rritje të shpejtë, duke u ngjitur nga 39 në 174. Kjo iu dha bazë disa teoricientëve që ta vendosin teorinë 'për valën e tretë të demokracisë' i cili përhapet pa u ndalur nëpër botë me zhvillimin e shoqërisë postindustriale e globale."[52]

Mediumet e njohura botërore folën dhe shkruan për mënyrën e çuditshme dhe mistike të krijimit dhe realizmit të projektit të këtillë (**BBC**, **CNN**, **New York Times**, **the Guardian**, **Die Presse**).[53]

Disa pika problematike në aspektin ndërtimor, arkitektonik, historik dhe politik mund të veçohen si karakteristike. Ato janë:

***1. Mbipopullimi në m²:*** Një numër i madh i skulpturave, i përmendoreve, fontanave dhe i objekteve tjera të financuara me paratë e qytetarëve e kanë transformuar pamjen e Shkupit dhe ajo që është edhe më

[52]Miroslav Pecujlic: "Lavirinti politicke globalizacije". Anali Pravnog fakulteta Drzavnog
univerziteta u Beogradu, 2001, vol..49, br.1 - 4, str. 416.
[53] http://respublica.edu.mk/blog/2014.

mbresëlënëse, ato janë vendosur në një distancë shumë të vogël e cila krijon kaos urban, fillimisht në rajonin më frekuentues, në sheshin qendror Maqedonia. Pushtimi i barokut në stil të njëjtë vazhdon edhe përgjatë rrugës Maqedonia, duke filluar nga hoteli Meriot, te shtëpia e Nënë Terezës, kisha e sapondërtuar Shën Konstandini dhe Elena (rrënimi i pretenduar i së cilës ishte një justifikim i shkëlqyeshëm për një përballje me kryetarin e sapozgjedhur të Komunës së Qendrës, Andrej Zernovski i cili në fushatën parazgjedhore lajmëroi një rishikim të projektit "Shkupi 2014", sepse ndodhet në territorin e Komunës së Qendrës); e deri te tre objektet e reja në fund të rrugës Maqedonia: Pallati "Panko Brashnarov", Pallati "Lazar Pop Trajkov" dhe objekti administrues i SHA Elektranat e Maqedonisë. Sipas arkitektëve, ekziston koncentrim shumë i madh i përmendoreve në një vend dhe kjo mënyrë e vendosjes së tyre është jo adekuat edhe përkundër asaj se nuk ekziston rregull se sa përmendore duhet të vendosen në shesh me madhësinë e sheshit tonë.[54]

***2. Është vendosur numër më i madh i përmendoreve nga të planifikuara në vetë projekt:*** Nëse bëhet një paralele nga kjo distancë kohore mes asaj që ka përfshirë brenda vetes projekti madhor "Shkupi 2014" dhe videoja me titull **"Vizualizimi i qendrës së Qytetit të Shkupit"** në të cilën Qeveria edhe zyrtarisht e paralajmëroi projektin "Shkupi 2014", do të shihet se ekziston një hendek i madh mes numrit fillimisht të planifikuar të objekteve dhe të atyre që janë vendosur deri në vitin 2013, më saktë deri në ditën e parë të punës së udhëheqjes së re të Komunës Qendër, kur në mbrëmjen e 7 prillit 2013 u vendosën **mbi dhjetëra përmendore të reja.** Zhernovski në mandatin e tij si prefekt

[54] http://respublica.edu.mk/blog/2014.

komune, arriti që ta ndalojë barokëzimin e QTQ, e ndaloi ndërtimin e shkallëve spanjolle dhe ndërtimin e garazhit me kate te Auto Makedonija.[55]

***3. Tejkalimi i pragut të burimeve të planifikuara financiare:*** Tejkalimet nuk ekzistojnë vetëm te numri i objekteve të ndërtuara, por edhe te lartësia e parave publike të harxhuara gjatë realizimit të projektit "Shkupi 2014". Nëse numri i përmendoreve të vendosura është tri herë më i madh jashtë planifikimit, atëherë harxhimet për realizimin e tyre janë rritur madje për shtatë herë më shumë se mjetet e nevojshme financiare të parashikuara. Apo shprehur në numra - **40 projekte të promovuara (viti 2010) - 137 projekte të realizuara (viti 2017).**

Sa i përket shumës së mjeteve të shpenzuara, fillimisht 80 milion euro të parashikuara, u rritën në më shumë se 560 milion euro. Në këtë mënyrë, Qeveria, si krijuesi dhe zbatuesi i shumicës së zgjidhjeve ideore për këto koncesione, nuk filloi fare një diskutim dhe auditim publik dhe të ekspertëve. Shuma të mëdha parash u ndan jo vetëm për ndërtimin, por edhe për dhënien e honorareve për autorët e këtyre punimeve dhe për kompanitë e ndërtimit që ndërtuan objektet.[56]

***4. Favorizimi i autorëve dhe i firmave të ndërtimit-realizues të këtij projekti:*** Skulptorja Valentina Stevanovska, „Neumar Inzhenering" nga Shkupi dhe „Arhitektonika" SHPK Shkup ishin **tre autorët më të favorizuar** të cilët i kanë punuar zgjidhjet ideore për projektin "Shkupi 2014", derisa kompania e ndërtimit "Beton" ka fituar numrin më të madh të tenderëve dhe ka ndërtuar më së shumti objekte të cilat janë pjesë e projektit

[55] http://respublica.edu.mk/blog/2014.
[56] http://respublica.edu.mk/blog/2014.

(1/3 e gjithë projektit). Përveç SHA "Beton" Shkup dhe Shtip, për ndërtim janë paraqitur edhe tre realizues të tjerë. Në prapavijën e ndërtimit, si shumicë e investuesve edhe përkundër numrit të madh të personave privat dhe fizik qëndrojnë Qeveria e RM, Ministria e Kulturës, Qyteti i Shkupit dhe Komuna Qendër (deri në vitin 2013).

***5. Uzurpimi i sipërfaqeve të gjelbra në qendër të qytetit*** praktikisht ishte dëmi që u shkaktua me realizimin e të ashtuquajturit projektit "Shkupi 2014". U prenë shumë pemë në qendër të qytetit: dy gështenjat te restoranti "Pelister" në rr. Maqedonia me qëllim që të zhvendoset për disa centimetra përmendorja e Car Samoilit; te parku "Zhena borec" gjithashtu janë prerë pemë me qëllim që të bëhet vend për vendosjen e përmendoreve dhe skulpturave nga bronzi dhe betoni; barishtja te Hotel Bristoli i cili paraprakisht ishte mbyllur, është shkatërruar dhe te vendi i hijes së madhe të cilën e krijonin pemët dyzetvjeçare është ndërtuar një objekt tetëkatësh në të cilën është vendosur Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale, ndërsa edhe te vendi i barishtes në anën e kundërt ku gjendej skulptura „Shkupi1963" kushtuar viktimave të tërmetit të vitit 1963 e punuar nga skulptori i njohur Tome Serafimovski, mbinë dy ndërtesa baroku. Beteja në Komunën Qendër në raport me këto tre projekte përfundoi pa sukses, sepse ato ishin projekte të kontraktuara nga udhëheqja e mëparshme. Për t'u amortizuar uzurpimi i këtillë i vendeve të gjelbra, komuna ripërtëriu 70.000 m2 të sipërfaqeve të gjelbra, ndërsa u mbollën edhe 283 pemë të reja në periudhën 2013-2017.[57]

Për të gjitha këto arsye, ky transformim rrënjësor i pamjes së qendrës së Shkupit për shumicën e arkitektëve jo

[57] http://respublica.edu.mk/blog/2014.

vetëm nga Maqedonia por edhe nga bota është kiç dhe nuk mund të konsiderohet një rinovim modern urban. Disa të tillë si kritiku arkitekturor kroat Maroje Mrduljash, shkojnë deri atje sa projektin "Shkupi 2014" ta quajnë një vrasje urbane (urbanicid). Sipas tij, me një projekt të këtillë është shkatërruar vizioni inovativ për zonën në qendër të qytetit rreth së cilës ishin bashkuar të gjithë arkitektët evropianë dhe jugosllavë që morën pjesë në ndërtimin e Shkupit pas tërmetit.

*Mendimet në opinion për këtë projekt janë të ndara dhe prekin skajet ekstreme në të dyja anët. Përkrahësit e ish kryeministrit konservator Nikolla Gruevski e arsyetojnë projektin duke thënë se me të Shkupi është shndërruar në një qytet evropian. Në anën tjetër, për kritikët kjo është zgjidhja më e keqe e mundshme e cila hermetikisht e mbyllë qendrën e qytetit me objekte të shumta në numër, tepër të mëdha, të pavlera dhe si të tilla i japin qendrës një dukje kiç. Mbetet të shohim se çfarë vendimi do të sjellë grupi i punës i cili punon në analizën e projektit. Ekzistojnë tre opsione: (1) të mbeten të gjitha që janë ndërtuar deri më tani; (2) të zhvendoset një pjesë e përmendoreve; (3) të rrënohet projekti.*[58]

*Këto dilema të cilat i përmend autorja e tekstit, në të vërtetë janë edhe dilema të cilat duhet t'i ketë çdo qeveri e ardhshme e RM, për shkak se nuk duket mjaft tërheqëse rrënimi i projektit, pavarësisht dëmit të cilin e ka bërë ai në planin e brendshëm e të jashtëm. Për këtë, ne mendojmë se këtu duhet të intervenojë politika me qëllim që t'i zvogëlojë dëmet e këtij projekti, ashtu që ndërtesat të cilat e prishin ajrin e qytetit të rrënohen, përmendoret të largohen nga sheshi. Është interesant edhe*

[58] http://respublica.edu.mk/blog/2014 (Текст од меѓународ).

*përfundimi, gjegjësisht epilogu të cilin e jep dr. Maja Stojanova, duke thënë: EPILOG: dislokim ose rrënim.*[59]

Tani për tani, ende nuk dihet se cili është fati i projektit kontrovers "Shkupi 2014", sepse puna e grupit të punës është duke vazhduar. Normal se analiza shkon nëpër etapa, për shkak se ekzistojnë dokumente të shumta që kanë të bëjnë me projektin.

Koordinatori i grupit të punës, arkitekti prof. dr. Mirosllav Gërçev e mban qëndrimin se **ky projekt duhet të rrënohet dhe të largohet nga Shkupi si mbeturinë ndërtimore.** Qëndrimin e tij e argumenton nëpërmjet sqarimit se projekti jo vetëm që nuk është logjik në aspektin ndërtimor dhe arkitektonik, por edhe nëpërmjet asaj se ekzistojnë shumë implikime të tjera, me këtë rast duke menduar se gjatë realizimit të projektit janë shkelur shumë ligje: **Ligji për përmendore përkujtimore dhe monumente, Ligji për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike, Ligji për ndërtim dhe për planifikim hapësinor dhe urbanistik**.[60] Mirëpo, ai thekson se grupi i punës në kuadër të Ministrisë së Kulturës i cili e bën analizën e këtij projekti, nuk ka kompetenca që të vendos rreth asaj se a duhet të rrënohet projekti ose jo, por ai e ka për detyrë vetëm të parashtrojë elaborate deri te Qeveria dhe të japë rekomandime, kurse Qeveria është ajo e cila në fund do të vendos se çfarë do të ndodh me projektin.

Para do kohësh, **ministri i kulturës Robert Allagjozovski paralajmëroi se nuk kanë ndërmend që të rrënojnë,** por do të shpallet konkurs për idetë rreth riparimit të kësaj, siç e quajti ai, katastrofe shkatërruese.

[59] http://respublica.edu.mk/blog/2014.
[60] http://respublica.edu.mk/blog/2014.

**Në anën tjetër, kryeministri Zoran Zaev me një rast pati deklaruar se ndoshta nuk është ide e keqe që të largohet më së paku një fasadë baroku,** që të arrihet përshtypja në opinion se projektet e këtilla nebuloze më nuk do të bëhen në të ardhmen.

Informacioni i fundit zyrtar lidhur me projektin vjen nga Qyteti i Shkupit, se kryetari i ri i zgjedhur i Shkupit, **Petre Shilegov ka dhënë urdhër që të ndalohet ndërtimi i 95 fasadave barok.**[61]

Duke i marrë parasysh të gjitha aspektet problematike dhe kundërthëniet e këtij projekti të cilat u përmendën më herët, është më se e qartë se nevojitet revidimi i tyre në shumë aspekte: ndërtimor, arkitektonik, juridik, politik dhe historik. Nëse vërtetohet se në aspektin ndërtimor ky projekt nuk qëndron ose se janë shkelur disa ligje të cilat e rregullojnë ndërtimin e tij, ndërsa në aspektin politik se qëllimi kryesor nuk ka qenë përmirësimi i infrastrukturës së qytetit, por ridefinimi i historisë nacionale, atëherë është e domosdoshme që Qeveria të fillojë seriozisht të mendojë për ndryshimet në projekt – zhvendosja e përmendoreve dhe skulpturave, rikonstruksioni i fasadave nga ato neoklasike, për shembull në fasada efikase energjetike ose për rrënimin e projektit, kuptohet në atë mënyrë siç mund të bëhet më së miri dhe më e qëndrueshme (të bëhet me humbje sa më të vogla financiare nga rrënimi). Kuptohet se pas kryerjes së revizionit, rezultati duhet të jetë në përputhje me rekomandimet e personave ekspertë në këtë fushë.

Ndërsa në aspektin e transparencës së Qeverisë ndaj opinionit të gjerë dhe për hir të respektimit të vullnetit të shumicës, është e rekomanduar që në vendimin

[61] http://respublica.edu.mk/blog/2014.

përfundimtar të përfshihen edhe qytetarët me anë të deklarimit në referendum.[62]

Zgjidhja e arsyeshme politikisht do të ishte me atë se qytetarët e Shkupit bashkë me komunat rurale, ta japin mendimin në referendum rreth asaj se çka duhet të hiqet dhe çka duhet të rrënohet. Gjitha të tjerat janë paksa më vështirë të realizohen, për shkak se garniturat politike kanë kujdes që jehona e revidimeve të tyre ndërtimore mos t'ju shkaktojë atyre humbjen e votave, pavarësisht nga fakti se ndonjëherë rishikimet e tilla vërtetohen si ligjërisht ashtu edhe si tëarsyeshme.

[62]http://respublica.edu.mk/blog/2014 (Заклучен текст).

## 6.1.3. PROJEKTI "SHKUPI 2014" DHE PËRÇARJA NË MESIN E MAQEDONASVE

**P**olitika kulturore e cila udhëhiqej nëpërmjet identifikimit të kësaj politike kulturore të quajtur "Shkupi 2014" jo vetëm që i prishi marrëdhëniet ndëretnike mes shqiptarëve dhe maqedonasve, por i prishi edhe marrëdhëniet në mes vetë maqedonasve në Maqedoni dhe jashtë saj. Kemi shembuj të shumtë se si akuzoheshin mes vete gazetarët, poetët, artistët, arkitektët etj. nga vetë blloku maqedonas. Në përpjekje për ta definuar kulturën nacionale maqedonase, në punën e saj shkencore për identitetin maqedonas, Biljana Ristovska shkruan: "Mirëpo, në një hapësirë të caktuar u formua dhe u individualizua një kulturë të cilën ne sot kushtimisht e quajmë si 'kulturë nacionale.' Ajo është krijuar në mënyrë koekzistente dhe komplementare me etnokulturat tjera ndër shekuj në këto hapësira. Sot shumë shpesh theksohet kultura e Maqedonisë antike, por ajo është vetëm një komponentë e caktuar në amalgamën të cilën e ka afirmuar historia. Dhe nuk ka nevojë shkencore që të vendoset njëfarë 'hendeku' mes Maqedonisë antike dhe maqedonasve sllavë, as madje të identifikohet njëfarë bashkimi dhe identiteti. Maqedonasit janë krijuar nëpër një proces të vazhdueshëm, pa ndarje dhe 'hendeqe' dhe sigurisht jo vetëm nga sllavët që kanë ardhur vonë në Ballkan."[63] Në anën tjetër, prof. dr. Aneta Shukarova thotë se etnogjeneza e "maqedonasve antikë është nga popullsia paleoballkanike me prejardhje

[63]Билјана Ристовска-Јосифовска, Изворен научен труд; УДК: 316.356.4(497.7):930, АКЕДОНСКИОТ ИДЕНТИТЕТ И ИСТОРИСКИТЕ ПРОУЧУВАЊА, фусн. 3 на стр.31-32.

indoevropiane. Si etnos i veçantë janë formuar në shek. VII p.e.s. prej popullatave të cilat qysh në mijëvjeçarin e III janë vendosur në hapësirat e Ballkanit qendror. Hulumtimet arkeologjike, historike, onomastike, linguistike e tregojnë lidhjen etnografike dhe gjuhësore të Brigëve me maqedonasit antik..."[64] Nëse do të vazhdonte ky trend i zhvillimit të kësaj politike kulturore, nuk do të ishte e çuditshme se do të ishin krijuar dy kombe prej vetë maqedonasve të tanishëm. Pak është dashur që të krijohen dy popuj të rinj në Maqedoni; maqedonasit antik dhe maqedonasit sllavë. Deri ku mund të shkojë përçarja, ne e kemi zgjedhur një shembull të poetes maqedonase Elizabeta Sheleva e cila pas ndryshimeve në pushtetin e Gruevski u emërua si kryetar i Bordit drejtues në Mbrëmjen strugane të poezisë për vitin 2018. Absurdi i këtij shembulli të butë më shumë është kritikë për qeverinë e re, për shkak se edhe ajo hamendej: Çfarë tha Sheleva për projektin "Shkupi 2014" para shtatë viteve në një tryezë të rrumbullakët?! Me këtë rast duke i eliminuar vlerësimet lidhur me Shelevën si poete dhe letrare, për vendimin e saj që ajo të jetë kryetare e atij bordi!

Pikërisht për këtë shkak kishte edhe sqarime dhe risqarime nga vetë Sheleva se çfarë tha saktë ajo për "Shkupi 2014" dhe cilat janë qëndrimet e saj në lidhje me këtë projekt. Në tekstin në vazhdim ju lutemi që ta lexoni me vëmendje se çfarë thotë Fokusi për këtë problem të krijuar dhe çfarë thotë vetë Sheleva në tekstin e publikuar në Fokus më datën 22.8.2017: "Kryetari i bordit drejtues i Mbrëmjeve strugane të poezisë, pozitë kjo e cila e tërhoqi vëmendjen e opinionit jo paraprakisht, por pas emërimit të

[64]Шукарова, Анета ИСТОРИЈА НА МАКЕДОНСКИОТ НАРОД / [автори Анета Шакарова... [и др.]. – Институт за национална историја, Скопје, 2008 стр.12-13.

poetit Darko Leshoski i cili u largua nga funksioni për shkak të reagimeve të shumta në opinion, me ç'rast është emërtuar Elizabeta Sheleva. Tani, as Sheleva nuk është e kursyer nga tehu i gjuhëve maqedonase."[65]

Kështu ishte hyrja e tekstit të gazetës së njohur Fokus, ndërsa lexojeni në vazhdim se çka thotë Sheleva lidhur me këtë:"*Më vjen keq që këtë bisedë me juve e zhvillojmë në temën e cila nuk ka asnjë lidhje me festivalin e ardhshëm letrar 'Mbrëmjet strugane të poezisë 2017' dhe vëmendjen që e meriton. Fokusi i interesimit të mediave (sërish) orientohet drejt çështjeve jashtë sferës së letërsisë dhe afirmimit ndërkombëtar të kulturës maqedonase, e parashikuar me mbajtjen e këtij formati të festivalit. Më në fund, edhe nga domeni bazë i veprimit tim, për shkak se jam zgjedhur në këtë detyrë*" – deklaroi në fillim Sheleva.[66]

Nëpër rrjetet sociale, profesoresha është akuzuar për shkak të tribunës rreth projektit "Shkupi 2014" që është mbajtur para shtatë viteve. Deklaratat e saj, siç thotë ajo, nuk janë transmetuar saktë apo janë lexuar me tendenciozitet në disa media, me ç'rast thotë ajo, në mjedisin maqedonas sundon një zemërim i madh dhe tendencë e qartë për diskreditim personal në bazë të pjesëmarrjes në një diskutim dhe të rezymeve sipërfaqësisht të transmetuara të gazetarëve i të njëjtës – duke e anashkaluar profilin e përgjithshëm të arritur të veprimtarisë dhe intelektual, angazhmanin dhe kontributin paraprak të personit konkret.[67]

[65]https://fokus.mk/sheleva-so-skopje-2014-seioy-pretera-no-me-zhalosti-shto-vladee-otrov-na-nashata-mediumska-stsena/

[66] https://fokus.mk/sheleva-so-skopje-2014-seioy-pretera-no-me-zhalosti-shto-vladee-otrov-na-nashata-mediumska-stsena/

[67]https://fokus.mk/sheleva-so-skopje-2014-seioy-pretera-no-me-zhalosti-shto-vladee-otrov-na-nashata-mediumska-stsena/

Me këtë gazeta jep shpjegime shtesë rreth qëndrimeve të thëna nga poetja, pastaj që të vazhdojë me deklaratën e profesoreshës Sheleva:*"Refuzoj të bëhem viktimë e instrumentalizimit të këtillë të keq! Dhe të futem në vorbullin e zënkave reciproke... Të gjitha janë bardh e zi, gjithçka është ose më së miri ose më së keqi, thellë e polarizuar – dhe helmuese. Shpresoj se do të vijë një kohë më ndryshe e harmonisë konstruktive dhe kthim kah perspektiva pozitive. Në këto momente neuralgjike mbisundon nevoja me çdo çmim dhe mbi të gjitha – që të kërkohen motivet e fshehura, konspirative dhe lukrative… Nëse ndryshohet ose lihet vetëm një fjalë – intervenohet në vetë kontekstin – me ç'rast plotësisht ndryshon kuptimi i gjithë shprehjes së thënë"* – thotë profesoresha.[68]

Lidhur me pohimet se fuqishëm e ka përkrahur rregullimin arkitektonik të kryeqytetit nëpërmjet projektit "Shkupi 2014", Sheleva demanton. Tekstet, kolumnat, librat tashmë gjatë kohë janë të orientuara rreth poetikës së pastrehimit në letërsi. Ajo nuk ka shkruar e as që ka publikuar ndonjë tekst autorial, ese ose ndonjë artikull kushtuar konkretisht projektit "Shkupi 2014". Ajo thotë se fjalët e përdorura në një shkrim të një gazete, kinse Shkupi është qytet i fantazmave, aspak nuk është formulim i saj por i autorit i cili e ka bërë këtë shkrim.[69]

...Në vazhdim, profesoresha Sheleva edhe më saktë është dekan dhe kurrë nuk ka përkrahur një projekt të këtillë përçarës siç është "Shhkupi 2014" dhe thotë:"Në debatin e përmendur, unë i kam shprehur dhe përsëritur tezat e eseut tim, "Shpëtojeni Shkupin" fillimisht i publikuar në vitin 2003 në revistën sllovene për kulturë (me

[68]https://fokus.mk/sheleva-so-skopje-2014-seioy-pretera-no-me-zhalosti-shto-vladee-otrov-na-nashata-mediumska-stsena/

[69]https://fokus.mk/sheleva-so-skopje-2014-seioy-pretera-no-me-zhalosti-shto-vladee-otrov-na-nashata-mediumska-stsena/

titull „Save as Skopje“). Në këtë ese dhe pavarësisht nga projekti i dhënë, unë kam folur për Shkupin në aspektin kulturor si qytet – brikolazh, i cili duke i marrë parasysh katastrofat e mëparshme (djegia e tij nga ana e Pikolominit, tërmeti i vitiitn 1963) – gjithmonë janë përzier stile të ndryshme dhe ndikime multikulturore, njëherësh edhe dy fytyrat e qytetit: virtuale (dikur) dhe aktuale (tani). Aspak nuk i kam trajtuar diskurset dhe aspektet arkitektonike. Kjo nuk është fusha ime e kompetencave. Por, kam trajtuar memorien nostalgjike e cila gjendet te banorët më të moshuar të Shkupit, me theks të veçantë të shkrimtarëve të cilët ende e mbajnë në mend, shkruajnë dhe udhëhiqen sipas emërtimeve të vjetra të rrugëve dhe ndërtimeve, edhe pse të njëjtat tashmë janë rrënuar dhe nuk ekzistojnë më. Nga këtu, konstatimi se Shkupi është qytet i fantazmave aspak nuk është fjali e imja, por është titull të cilin e ka formuluar vetë gazetari” – thotë Sheleva.[70] Pas këtij sqarimi të Shelevës, gazeta Fokus përfundon se: “Në vend që të interpretojë arbitrarisht vlerësimet në media, Sheleva thotë se përpjekjet e saj duhet të kërkohen në artikujt e autorit, të cilat ajo ka shkruar deri më tani si dhe në angazhimin e saj të përkushtuar në fushën e kulturës.[71] Më në fund, ajo i dha dy deklarata më të shkurtra rreth kuptimit të përgjithshëm të pozicioneve të saj në lidhje me dilemën e ngritur nga kundërshtarët e saj politikë:

“Nuk ekziston tekst i shkruar nga ana ime, më konkretisht lidhur me projektin “Shkupi 2014”. Unë u jam referuar aspekteve kulturore të banimit në Shkup, si

[70] https://fokus.mk/sheleva-so-skopje-2014-seioy-pretera-no-me-zhalosti-shto-vladee-otrov-na-nashata-mediumska-stsena/

[71] https://fokus.mk/sheleva-so-skopje-2014-seioy-pretera-no-me-zhalosti-shto-vladee-otrov-na-nashata-mediumska-stsena/

kolumnist dhe profesor. Por, siç mund të shihet, deri më tani, unë nuk kam bërë ndonjë tekst autorial mbi temën e mësipërme. Unë nuk jam dhe as nuk jam udhëzuar në planet e tyre, kjo nuk është në domenin e profesionit tim" - shton ajo.

"Në fillim të vitit 2009 ne as që kemi mundur të supozojmë se do të ndodh e gjithë kjo. Nuk mund të dihej se cilat dhe në çfarë dimensione do të zhvillohet i gjithë projekti ndërtimor, se rregullisht do të shtohen skulptura të reja, ndërtime të llojllojshme, galia të ngulitura, rrota panoramike, me theks të veçantë se me këtë rast do të investohen shuma të atilla financiare të cilat për shumëfish janë më të larta se sa ato të planifikuara ose publikisht të deklaruara. Ne ishim dëshmitarë se qyteti dita ditës po ndryshonte në mënyrë drastike. Ndoshta, idetë dhe synimet fillestare ishin të ndryshme, por në fund të fundit, gjithçka shkoi shumë larg, është ekzagjeruar, sheshi është mbipopulluar, për të mos përmendur fondet e mëdha dhe të harxhuara në mënyrë të paarsyeshme" - mendon ajo.[72]

Përndryshe, Sheleva është profesoreshë e rregullt në katedrën e Letërsisë së Përgjithshme dhe Komparative. Është autore e më shumë se 200 punimeve, eseve dhe librave nga fusha e letërsisë. Ka qenë anëtare e Plenumit të Profesorëve që nga themelimi i tij dhe e ka përkrahur Plenumin e Studentëve gjatë lëvizjeve në universitet kundër ndryshimeve të propozuara në Ligjin për shkollimin e lartë.

[72] https://fokus.mk/sheleva-so-skopje-2014-seioy-pretera-no-me-zhalosti-shto-vladee-otrov-na-nashata-mediumska-stsena/

## 6.1.4PROJEKTI "SHKUPI 2014" NË KUADËR TË IDENTITETIT TË SHKUPIT

**P**rojekti i quajtur "Shkupi 2014" në të vërtetë është identifikim i politikës kulturore të cilën e udhëhiqte Qeveria e RM nga viti 2007 deri në vitin 2017. "Shkupi 2014" jo vetëm që fitoi ekskluzivitet të zhvillimit kulruror të një kombi, ai mori edhe ekskluzivitet të zhvillimit të një partie politike, pra të kajmakut të asaj partie politike. Ideologu i kësaj politike kulturore ishte arkeologu Pasko Kuzman i cili në fund përfundoi me proces gjyqësor për shitje jolegale të artefakteve. Ai në fund të procesit gjyqësor në vitin 2016 u dënua me 3 vite burg. Bashkë me të u dënuan edhe gjashtë bashkëpunëtorë të tij të tjerë. Për arrestimin e tij kështu shkruanin mediat: "Gjashtë të akuzuar, në mesin e të cilëve edhe ish drejtori i Drejtorisë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, Pasko Kuzman, të cilët do të mbajnë burgun për tregti me artefakte dhe për keqpërdorim të pozitave të punës", transmeton Telma.

Kuzmani është dënuar me 3 vite burg për shkak se ua dha pëlqimin personave fizikë për kryerjen e punëve të gërmimit në dy lokacione me qëllim të kontrollimit të pretendimeve për ekzistimin e trashëgimisë kulturore-historike.

I pandehuri i parë, ish-shefi i Departamentit të Parandalimit në Zyrën e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore, Bojçevski, i cili ishte më i zëshmi gjatë procedurave, u dënua me shtatë vjet e gjysmë burg për veprat e mëposhtme: bashkim kriminal, abuzim i detyrës, vjedhje e rëndë dhe fshehje.

Ai në mbrojtjen e tij pohonte se ishte viktimë e një dëshmitari të rremë dhe cak i hakmarrjes pikërisht sepse ai ishte ballafaquar me sukses me tregtinë e paligjshme të artefakteve. Sipas tij, pas tregtisë me artefakte në Maqedoni qëndrojnë fuqitë e mëdha financiare që janë të infiltruar në çdo sferë të shoqërisë.

Sipas prokurorisë, pohohet se ky dokument nuk është i paraparë me ligjet dhe aktet nënligjore të Drejtorisë. Kuzman argumentoi në gjyq se vetëm Drejtoria ishte kompetente për të dhënë pëlqim në raste të tilla.[73] Ky përfundim gjyqësor në të vërtetë tregon se ideologu i politikës kulturore të VMRO DPMNE dhe i Qeverisë për periudhën 2007 - 2017, në fakt, sa i padenjë për qytetarët e Shkupit dhe Maqedonisë, është edhe më i padenjë për vlerat kulturore të vetë projektit, sepse Pasko Kuzman u dënua me 3 vjet, jo për abuzim me pozitën e tij zyrtare, por për mosmarrëveshje reciproke me udhëheqësit e qeverisë së atëhershme, me shumë gjasa për ato që nuk ishin shkruar në procesin gjyqësor: Mosmarrëveshjet e ndërsjella për përqindjen e politikanit të vjetër. Kush ishte dhe për çka ishte nuk flitej askund. Kjo është dilema jonë, jo shitja e artefakteve. Kjo është saktësisht e kundërta e multikulturalizmit që është tipike për Shkupin. "Multikulturalizmi sipas etikës liberale për lirinë e zgjedhjes, nënkupton se duhet të lejohet zgjedhja e anëtarësisë tonë, në vend që të jetë e determinuar kryesisht me anë të trashëgimisë. Në këtë drejtim, multikulturalizmi duhet t'jua mundësojë njerëzve që të jenë të lirë deri aty që të mund të konvertohen në një kulturë tjetër. Që të mbijetojë, multikulturalizmi duhet të jetë i hapur në atë

[73] https://www.press24.mk/sudot-presudi-zatvor-za-pasko-kuzman (15.01.2016 - 12:59).

mënyrë duke shkuar më larg tolerancës, duke e mbrojtur rrugën ndaj botëkuptimeve dhe kulturave të ndryshme, madje duke kërkuar ndjekjen e tyre. Kjo do të thotë se ai është i mirë e jo vetëm e keqja e domosdoshme shoqërore."[74] Për fat të keq, ideja e Xhejms Edvard depërtoi në veshin e Gruevskit, Kuzmanit dhe "aventurierëve politikë" të ashtuquajtur, të cilët e dëmtuan shumë keq Maqedoninë.

Këtë shembull e veçuam për të argumentuar se sa është jologjik dhe i dëmshëm projekti "Shkupi 2014" i cili identifikohet me politikën kulturore të Qeverisë së RM për një periudhë dhjetëvjeçare. Në rastin kur kemi një shpalosje të rastit me ideologun pa emër të kësaj politike kulturore, vallë mund të presim një ndikim shembullor në kushtet shoqërore të kësaj politike kulturore. Pikërisht për shkak të kësaj politike kulturore të paedukatë, ne në qytetin e Shkupit kemi pasur një seri tërrahjeve të nxënësve shqiptarë nga ana e rrugaçëve të paguar maqedonas. Flitej se një gazetar i afërt me qeverinë iu ka dhënë nga 50 euro rrugaçëve maqedonas që ta rrahin ndonjë nxënës shqiptar. Që ironia të jetë më e madhe, ishin me dhjetëra raste të këtilla, por asnjëri prej këtyre rrugaçëve maqedonas nuk përfundoi në burg. Në anën tjetër, gjithmonë kur kishte rrahës shqiptarë mbi fëmijët maqedonas, përherë kishte përfundim gjyqësor. Ne e kemi pasur rastin kur një fëmijë shqiptarë gjatë një zënke për biçikletën e vjedhur ose jo, e mbyti fëmijën maqedonas në lagjen Gjorçe Petrov, me ç'rast pas kësaj ngjarje fëmija shqiptar u arrestua dhe u dënua me burg, gjë e cila është në kuadër të funksionimit normal të drejtësisë. Mirëpo, në të njëjtën ditë patëm djegie të

[74]James, Edward, "The Multivision of Multiculturalism", web. bu.edu/wcp/papers.com.

pasurive dhe dyqaneve të dhjetëra shqiptarëve në Gjorçe Petrov, ndërsa në këtë turmë të protestuesve kishte edhe funksionarë të lartë të qeverisë së RM, ministra dhe deputetë të VMRO-së, ndërsa nuk kemi asnjë të akuzuar për djegien e dyqaneve dhe të pronave të shqiptarëve në Gjorçe Petrov?! Ky është një shembull tipik se çfarë ka sjellë politika kulturore e ekskluzivitetit dhe neveritjes së "Shkupi 2014".

Me këta tre shembuj të veçantë ne duam të dëshmojmë se pasqyrimi i kësaj politike kulturore mbi frymën e lirisë dhe të hapur të qytetit të Shkupit është ndërprerë seriozisht, dhe është shumë me fat që kjo politikë u ndërpre nga zgjedhjet e fundit parlamentare në 2016. Por dëmi mbeti për t'u rimarrë kjo frymë liridashëse e cila kërkon kohë.

## 6.1.5. PËRMENDORET QË I IRRITOJNË SHKUPJANËT

**P**ërmendoret që ishin parashikuar me projektin "Shkupi 2014" është projekt me të cilin parashihet ndërtimi i përmendoreve të personave historik nga mermeri dhe bronzi, fontana, skulptura dhe ndërtime të reja të institucioneve për rajonin qendror të qytetit. Projekti është paraqitur në opinion nëpërmjet videos në organizim të komunës Qendër.[75]

Përmendoret e Metodija Andonov Çento, Car Samoilit dhe Justinianit të Parë[76] sipas raportit fillestar të Qeverisë, të bëra nga mermeri dhe të gjithë të tjerët, duke përfshirë Goce Delçev, Dame Gruev, i Gemixhive, Shën Cirili dhe Metodi, Shën Klimenti dhe Naumi, luanët në urën "Goce Delçev[77], ... të bëra prej bronzi.

Sipas planit të detajuar urbanistik, është planifikuar edhe ndërtimi i hoteleve dhe i kishës ortodokse "Shën Konstandini dhe Elena."

Në sheshin „Maqedonia"[78] tani veç më janë fontana me përmendoren e Aleksandrit të Madh në Bukefal. Është interesante se në parashikimet para se të rrumbullakohet projekti "Shkupi 2014", flitet për ndërhyrje shumë të vogël të projekteve. Kështu që sipas autorit të Wikipedia, thuhet edhe kjo: Fontanë do të ketë edhe në sheshin "Kryengritja e Karposhit" në anën e kundërt të Urës së Gurit. Në të

[75]www.idividi.com.mk, *Презентиран проектот „Скопје 2014"*, пребарано на 10 мај 2010 г.
[76] https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0% %D1%98%D0%B5_2014.
[77] https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%A1% D0%B5_2014.
[78] https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%A1%D0%BA%.

vërtetë, fontanat të cilat duhet të vendosen në Vardar, do të fillojnë të ndërtohen kur do të ketë nivel të ulët të lumit. Shtylla e ujit e fontanave pritet të arrijë deri në 30 metra.

Në anën e majtë të lumit Vardar do të jetë objekti i teatrit të vjetër në Shkup dhe Muzeu i Luftës Maqedonase si dhe ndërtesa në të cilën do të vendoset Gjykata Kushtetuese, Arkiva Shtetërore dhe Muzeu Arkeologjik. Në afërsi të tyre është parashikuar që të ndërtohen edhe objektet e MPJ, Agjencisë për Komunikime Elektronike, e Prokurorisë Publike dhe Policia Financiare. Objekti i sallës së re të koncertit të Filharmonisë Maqedonase duhet të përfundojë në fund të vitit 2012.[79]Këto projekte ndërtimore përfunduan shumë më vonë, për shembull Filharmonia përfundoi në vitin 2017, pikërisht për shkak të ndryshimeve në planet e arkitektëve, por edhe të punëtorëve ndërtimorë. Do të thotë, kishte disa aneks marrëveshje të projektit të përmendur, i cili në fund të ndërtimit u tha se kushtoi 30 milionë euro!

Ura e këmbësorëve "Syri" i cili çon drejt ndërtesës së Gjykatës Kushtetuese, Arkivës Shtetërore dhe Muzeut Arkeologjik parashihet të ketë 28 skulptura të larta nga dy metra, të punuara nga bronzi.

Ura e artit ose ura e këmbësorëve i cili do të shkojë drejt ndërtesës së Prokurorisë Publike dhe Policisë Financiare është në gazën e konkursit. Edhe në këtë urë janë parashikuar 28 skulptura nga bronzi, të larta nga dy metra të vendosura në mënyrë simetrike në të dyja parmakët.

[79] https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%A1%D0B5_2014.

Këtu pritet që të gjenden skulpturat e Toshe Proevskit, Vëllezërve Milladinovci, Koço Racinit, Grigor Përliçevit, Aco Shopovit etj.

Do të zëvendësohen edhe parmakët e urave Goce Dellçev, Ura e Re dhe Ura e Revolucionit. Është paraparë mbindërtimi i ndërtesës së Parlamentit me një kat shtesë dhe vendosja e kupolave. Në sheshin "Pela" do të jetë porta "Maqedonia" ose "Lufta Maqedonase" apo "Porta e pavarësisë së Maqedonisë", projekt ky i Ministrisë së Kulturës. Në vend të ish Bankës Popullore të Maqedonisë parashihet një objekt afarist. Do të ripërtërihen edhe fasadat e ndërtesave në qendër të Shkupit për t'iu përshtatur pamjes së re të pjesës qendrore të qytetit. Është parapara edhe zhvendosja e përmendoreve ekzistuese me çka duhet të përputhen në projekt.[80] Të gjitha këto përmendore janë ndërtuar, madje janë shtuar edhe dhjetëra përmendore e skulptura, rreth 100. Për këtë, në opinionin maqedonas ekzistojnë qëndrime ekstreme të ndryshme dhe kundërthënëse rreth dobisë dhe nevojës reale për realizimin e një projekti të këtillë të shtrenjtë. Sipas pikëpamjeve të mia, nuk duhet të anosh shumë kah arti për ta vërejtur se ky projekt i fryrë në të gjitha anët në shesh të ngjajë në një kiç të përgjysmuar në të gjitha anët.

Kundrejt përmendoreve tjera të cilat janë vendosur te SYRI si dhe në shesh, gjendet edhe përmendorja e Car Dushanit të cilin shqiptarët nuk e pëlqyen aspak. Madje kishte edhe protesta të cilat në fund nuk arritën që ta largojnë përmendoren te SYRI. Është interesante se për vendosjen e asaj përmendore te ura "Syri" askush nuk e

[80]spic.com.mk, *Пајонската свештеничка се сели на мостот „Око"*, пребарано на 10 мај 2010 г.

mori përgjegjësinë se e ka vendosur përmendoren. Qyteti i Shkupit, Ministria e Kulturës si dhe Qeveria e RM në deklaratat e tyre janë distancuar se janë ata që e kanë vendosur këtë dhe katër përmendoret tjera. Ngjashëm ishte rasti edhe me përmendoren e Qoseto. Shumica e përmendoreve nuk e paraqitnin pasqyrën e vërtetë demografike dhe kulturore të Shkupit. Duke u nisur nga ky aspekt, konsiderojmë se kjo politikë kulturore e cila shihet në këtë projekt të madh, më shumë bën përçarje dhe largim të shkupjanëve sesa që krijon kohezion dhe harmoni e cila me shekuj është ngritur në Shkup.

## 6.1.6. PROCEDURAT PËR NGRITJEN E PËRMENDOREVE

**N**ga pozicioni aktual, thashethemet për mosrespektimin e procedurave ligjore në zbatimin e projektit "Shkupi 2014", kur tashmë kemi grupe të krijuara të punës në Ministrinë e Kulturës për të hulumtuar se si është realizuar ky projekt, madje edhe më shumë ekzistojnë me dhjetëra artikuj hulumtues nga disa gazetarë, krijohet përshtypja se i gjithë projekti u realizua sipas dëshirave të udhëheqësve të qeverisë dhe të mëdhenjve të saj. Me këtë rast, ne e veçuam tekstin e Katerina Bllazhevska i publikuar në http://prizma.birn.eu.com/мк, në të cilin tekst përmenden disa raste interesante të cilat e vërtetojnë përshtypjen tonë. Në tekstin e titulluar "Shkupi 2014: Fillimisht mbin përmendorja e pastaj ideja për të?!",[81] në nëntitullin e këtij teksti thuhet: "Pjesa më e madhe e personaliteteve për të cilët janë ngritur përmendore, post festum janë futur në programin për përmendore pasi që ishin lidhur kontratat për punimin e tyre. Dosja e projektit "Shkupi 2014" për këto dhe për shkak të procedurave tjera jashtëligjore, dy vite është në duart e Prokurorisë, ndërsa një periudhë të gjatë nën vëzhgim të Policisë Financiare, por për momentin nuk ka sinjale për zgjidhje."[82]

Në mestitullin "Në fillim kontrata – pastaj Programi"[83] thuhet: "Programi miratohet me shumicën e votave të anëtarëve prezent, ndërsa Këshilli e emëron Drejtorinë për ngritjen e përmendoreve. Në pajtim me nenin 10, drejtoria

[81] http://prizma.birn.eu.com/%D0D0%BE (17.06.2016).
[82] http://prizma.birn.eu.com/%D0% D0%BE (17.06.2016).
[83] http://prizma.birn.eu.com/%D0% %BE (17.06.2016).

shpall konkurs të hapur për punimin e projektit ideor, kujdeset për zbatimin e procedurës së tenderit dhe për zgjedhjen e projektit i cili do të realizohet. Kështu, rendi i vendosur juridik në praktikën e projektit "Shkupi 2014" u reduktua në një farsë. Këtë e dëshmoi edhe raporti i Komisionit i formuar nga prefekti i komunës Qendër, Andrej Zhernovski për ta vërtetuar gjendjen faktike me ndërtimin e përmendoreve në kuadër të projektit "Shkupi 2014", ndërsa të financuara nga buxheti i përgjithshëm.

"Më shpesh e gjithë procedura për ngritjen e përmendoreve ishte realizuar para se të sillet programi ose të plotësohet programi për shënimin e ngjarjeve me rëndësi historike dhe të personave të dalluar me anë të përmendoreve. Pjesa më e madhe e personaliteteve për të cilat janë ngritur përmendore, janë futur në program pasi që janë lidhur kontratat për punimin e tyre, gjegjësisht programet janë sjellë post festum me qëllim që të përmbushet forma dhe obligimi ligjor", konstatuan autorët e raportit, Dr. Sllagjana Taseva dhe Dragan Malinovski.

Shumë kontrata për ngritjen e përmendoreve dhe përkujtimeve i paraprinë Programit të miratuar më 5.2.2009 në vend që ai t'ju paraprijë atyre. Trendi i njëjtë vazhdoi edhe në periudhën prej 5.11.2009 deri 28.12.2012, kur u sollën edhe nëntë vendime për plotësimin e tij.[84] Në kutinë e këtij teksti është një pyetje interesante: **Në cilin program janë ata?** Në raportin e auditimit të Komunës Qendër është vërtetuar se ekzistojnë përmendore dhe objekte tjera për të cilat nuk ka informata adekuate nëse dhe në çfarë mënyre ato ishin parashikuar në programe. Si të tilla përmenden 18, duke përfshirë Urën e Artit 1 dhe 2, luanët në urën "Goce

[84]http://prizma.birn.eu.com/%D0%BC%D00%BE (17.06.2016).

Delçev", dy fontanat në Vardar, Rotonda (ndërtesa e NP "Vodovod"), Kolonada, sheshet "Kryengritja e Karposhit" dhe "Maria e shenjtë" , Letnikovec ... Shuma e shpenzuar vetëm për ndërtimin e këtyre nëntë ndërtesave i tejkalon 61 milion euro.[85]

Për rolin e këshilltarëve që duhet të jenë artikulimi i qytetarëve, autori i këtij studimi shkruan në titullin "Këshilltarë ose ushtarë të verbër të Samoilit?" Autori i artikullit e shpjegon këtë pyetje gazetareske përmes fakteve ku janë të dukshme shkeljet e procedurave ligjore nga vetë komuna. Në vazhdim të tekstit thuhet: Shembuj ka shumë, ndërsa komisioni i auditimit si afërsisht ilustruese e paraqet procedurën për përmendoren e Car Samoilit. Iniciativa e Ministrisë së Kulturës (nr. 41-3060/1) daton që nga 4 marsi 2008. Vendimi i Këshillit të Komunës Qendër (nr. 07-648 / 4) arrin dhjetë ditë më vonë, më 14 mars. Raporti nga Bordi në Këshillin e Komunës së Qendrës u paraqit më 9 qershor. Më 27 qershor pason konkluza e Këshillit mbi pranimin e raportit. Vendimi për nevojën e prokurimit publik për ta bërë një skulpturë të Car Samoilit në mermer (nr. 08-1542 / 4) u mor më 29 shtator, megjithëse dy muaj më herët më 8 korrik autori paraqiti një llogaritje për koston e bërjes së një skulpture mermeri dhe relievit në vlerë prej 105 mijë euro dhe në të njëjtën ditë ai nënshkroi kontratën për atë shumë për të bërë një projekt ideor dhe për të bërë modele të skulpturave dhe relievit.

Pas të gjitha këtyre procedurave – e fundit vjen ajo e cila sipas ligjit duhet të jetë e para. Car Samoili më 5 shkurt 2009 hyn në Programin për shënimin e ngjarjeve me rëndësi dhe të personave të shquar, i cili u publikua në Gazetën

[85]http://prizma.birn.eu.com/%D0% %BE.

Zyrtare të komunës Qendër numër 4, gjegjësisht 10 muaj pasi që në Ministrinë e Kulturës "lindi" iniciativa për përmendoren e tij. Shumë radhitje të këtilla të kundërta kanë kaluar në Këshillin e komunës Qendër, me siguri iu janë imponuar ushtarëve të verbuar të Samoilit e jo këshilltarëve të obliguar që ta respektojnë dhe t'i realizojnë procedurat ligjore. Jovan Tagasovski, këshilltar nga radhët e LSDM-së edhe në mandatin e mëparshëm, një epilog i këtillë e shpjegon faktin se ata nuk kishin qasje në punën e Komisionit.

„Në fillim të mandatit tonë, Këshilli formoi Komision të ri në të cilën nuk ishte asnjë përfaqësues i LSDM-së. Nuk deshëm që të jemi në Komisionin i cili në mënyrë të paligjshme i propozonte emrat e personave, pa ndonjë sqarim dhe arsyetim për meritat e tyre", tregon Jovan Tagasovski Me këtë, këshilltarët e LSDM-së faktikisht mbetën pa njohuri se çka është parashikuar me programin dhe se çka mbulohej post festum me sjelljen dhe plotësimin e tij të rregullt.

„Propozim programi fillimisht kaloi te komisioni për ndërtimin e përmendoreve i formuar nga ana e këshillit të komunës. Në këtë komision, nuk kishte përfaqësues të LSDM-së. Ata që ishin anëtarë ishin shpërblyer mirë për punën e tyre, për të cilën gjë në fillim të mandatit tonë e njoftuam opinionin. Si këshilltarë e kritikuam edhe punën e tyre dhe lartësinë e shumave që i kishin marrë", thotë Tagasovski. Duke e marrë parasysh renditjen e atëhershme të forcave, LSDM me 11 këshilltarë, ndërsa VMRO-DPMNE me 12, nuk ishte e vështirë që të gjitha vendimet e shumicës të kalojnë në këshill.

Nuk kishte njeri që të pyeste për prioritetin e programit. Se këshilltarët nuk vepruan sipas ligjit, kjo

shihet, madje argumentohet edhe më shumë me atë se për këto programe tashmë kemi procedura gjyqësore dhe policore. Në vazhdim të tekstit të këtij artikulli interesant hulumtues të Katerina Bllazhevska, thuhet: "Nën vëzhgimin e Policisë Financiare."

Për këtë shkak dhe për një mori të paligjshmërive të vërtetuara nëpërmjet revizionit të dokumentacionit ekzistues – kurdisja e tenderave dhe të ardhurat e prokurimit në mënyrë joligjore, më 30 nëntor 2013, prefekti i komunës Qendër ngriti në prokurori padi penale. Prej atëherë e deri më tani kaluan dy vite në heshtje.

Në pyetjen e BIRN se a ka vepruar Prokuroria Publike dhe deri ku ka arritur procedura në bazë të padisë penale të parashtruar deri te komuna Qendër, pas gjetjeve të komisionit për projektin "Shkupi 2014", nga atje u dha një përgjigje e shkurtër: „Pas grumbullimit të dëshmive dhe të materialit relevant për lëndën për të cilën po pyetni, prokurori publik kompetent e ka dërguar lëndën te Drejtoria e Policisë Financiare me qëllim që të bëhet një analizë shtesë e dëshmive dhe e materialeve. Pas ndriçimit të lëndës, do të pasojë vendimi i prokurorisë publike për procedurën e mëtejme", kumtoi prokuroria.

Burimet nga Prokuroria thonë se ky sqarim "po zgjatë një kohë të gjatë" por nuk janë të sigurt se a është shndërruar kjo në një alibi të llojit të vet apo gjërat po ecin ngadalë për shkak të ekipit relativisht të vogël kadrovik në policinë financiare, të cilës i duhet kohë për t'iu përgjigjur kërkesave.

Vanja Mihajllova, ish anëtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) është e habitur nga pasiviteti i autoriteteve dhe tregon se cilat institucione u është dashur të reagojnë dhe të marrin masa deri më tani.

"Sjellja e programeve për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe të personaliteteve të shquar të historisë me anë të përmendoreve, post festum është në kundërshtim me dispozitat e qarta ligjore dhe për këtë duhet të mbajë përgjegjësi në shtetin juridik. Për shkak të seriozitetit të shkeljeve të procedurave ligjore, vëllimit të fondeve të përfshira në projektin "Shkupi 2014" dhe dyshimeve për abuzim dhe korrupsion, të gjitha autoritetet kompetente, mbi të gjitha Prokuroria Publike, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Zyra Shtetërore e Revizionit, Zyra e Avokatit të Shtetit dhe të tjerët kanë pasur dhe kanë një detyrim ligjor për të marrë të gjitha masat brenda kompetencës së tyre për të vendosur përgjegjësinë për shkelje të tilla të rënda të rregulloreve. Habit heshtja dhe pasiviteti i të gjitha këtyre organeve për të vepruar në bazë të gjetjeve të raportit të auditimit të Komunës Qendër, por edhe në vlerësimet e Raporteve të KE që i referohen këtij projekti të diskutueshëm", tha Mihajlova.

Mirëpo, kolegët e saj nga përbërja e tanishme e KSHPK me siguri nuk mendojnë kështu. Personi përgjegjës për marrëdhënie me publikun as që përgjigjet në telefonin e dedikuar për kontakt, as që përgjigjet në pyetjet e dërguara deri te komisioni në formë elektronike.

Edhe ish kryetari i KSHPK-së, Gjorgji Slamkov refuzon që të përgjigjet në pyetjen se gjatë mandatit të tij a është hapur procedura lidhur me këtë rast, me arsyetimin se "nuk dëshiron të përzihet në punët e udhëheqjes së tanishme të Komisionit." Në vërejtjen se pyetja ka të bëjë kryesisht me efektin gjatë mandatit të tij, ai thjesht e mbylli bisedën telefonike. Mirëpo, Slamkov nuk është i vetmi i cili nuk dëshiron që të përzihet në punët që kanë qenë ose janë kompetencë e tij.

Ish-kryetarët e komunës Qendër gjithashtu janë të padisponueshëm për shpjegimin e procedurave, të cilët me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale kanë autorizimin për të kontrolluar ligjshmërinë e rregulloreve të miratuara nga Këshilli Komunal (neni 50, paragrafi 1 neni 2 i Ligjit), si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e rregulloreve të Këshillit para publikimit të tyre.

Në nenin 51 është vërtetuar detyra e prefektit që në afat prej shtatë ditëve nga dita e paraqitjes me vendim ta ndalojë publikimin me të cilin do t'i japë arsyet e ndalimit të çdo rregullore në Këshill për të cilën mendon se nuk është në pajtim meKushtetutën dhe me ligjet.

Lidhur me procedurat në lidhje me fillimet e projektit "Shkupi 2014" (të cilat datojnë qysh nga nëntori 2006), kontrollin e ligjshmërisë nuk e kanë bërë as kryetarja e komunës Qendër, Violeta Alarova dhe as pasardhësi i saj Vladimir Todoroviç, gjatë mandatit të të cilit kulmoi projekti "Shkupi 2014".[86]

Këto argumente konfirmojnë tezën se i gjithë projekti për "Shkupi 2014" është shpërndarë qëllimisht midis Ministrisë së Kulturës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qytetit të Shkupit dhe Komunës Qendër, për të ardhur në një pozitë kur ka ndërtesa ose monumente të diskutueshme të këtij projekti, ashtu që të gjithë t'i ngremë duart se nuk është projekt i tyre! Imagjinoni të ndërtoni ndërtesa milionëshe dhe askush mos të marrë përgjegjësi?! Është një tipar dhe imazh i këtij projekti i cili është vendosur si një politikë kulturore e vendit në dhjetë vitet e mëparshme.

[86] http://prizma.birn.eu.com/%D0%BC%D0% %D0%B5-2014 %82-% BE.

## 6.1.7. KOMITETI PËR MARRËDHËNIE NDËRNACIONALE

Që nga viti 2002 me ndryshimet kushtetuese u formua Komiteti për marrëdhënie ndërnacionale me qëllim që të vendos dhe të propozojë te Kuvendi çdo çështje që i tangon marrëdhëniet mes nacionaliteteve në Maqedoni. Ky trup është formuar për të mos pasur majorizim të grupit më të madh etnik ndaj të tjerëve. Ligjërisht, ky trup mund të ndalojë çdo çështje që është objekt i mospajtimeve ndëretnike. Por a ishte kështu këto 15 vite. Ne u përpoqëm që në ueb faqen e Kuvendit të RM të marrim të dhëna për mbledhjet e këtij trupi të rëndësishëm kundër majorizimit, por asnjë gjurmë nga kjo. Madje nuk gjendet në asnjë dritare në këtë ueb faqe. Çka do të thotë kjo? Sipas kësaj, do të thotë se ky trup nuk ka funksionuar sipas të drejtave të përcaktuara kushtetuese dhe obligimeve të këtij Komiteti. Për detyrat e këtij Komiteti, në librin "Identitetet kulturore në politikë", autorja Ana Çupeska thotë: "Rreth kërkesave për shprehjen e identitetit, shteti garanton mbrojtjen, përparimin dhe pasurimin e thesarit historik dhe artistik të Maqedonisë dhe të gjitha bashkësive në Maqedoni, ndërsa për ligjet të cilat direkt kanë të bëjnë me kulturën, me përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumenteve personale dhe përdorimit të simboleve, Kuvendi vendos në pajtim me principin e Badenterit. Në rast të kontestit në kuadër të Kuvendit lidhur me përdorimin e kësaj rregullore, kompetencat i ka Komiteti për marrëdhënie mes

bashkësive"[87] me tregues specifik për strukturën e këtij Komiteti "të cilin e përbëjnë shtatë anëtarë, secili nga radhët e maqedonasve dhe shqiptarëve në Kuvend dhe pesë anëtarëve nga radhët e turqve, vllehëve, romëve dhe dy bashkësive tjera. Secili nga pesë anëtarët do të jetë nga bashkësitë e ndryshme; nëse më pak se pesë bashkësi tjera janë të përfaqësuara në Kuvend, Avokati i popullit pas konsultimeve me liderët e bashkësive relevante do t'i propozojë anëtarët tjerë jashtë përbërjes së Kuvendit. Kuvendi i zgjedh anëtarët e Komitetit."[88] Pyetje logjike gazetareske lidhur me këtë çështje do të ishte: Komiteti formohet vetëm që të kanë paushall më të madh të parave ata deputetë të cilët janë anëtarë të këtij Komiteti, pa marrë parasysh se kanë mbajtur shumë pak mbledhje gjatë mandatit të tyre apo i kanë mbajtur vetëm disa për formimin dhe eventualisht ndonjë temë rreth marrëdhënieve ndërnacionale e cila krahasuar me çështjen e projektit identitar kulturor "Shkupi 2014" prapëseprapë është trup që duhet të ruhet dhe të përkrahet, sepse ideja e funksionimit të saj është pikërisht që të mos majorizohen kultura shqiptare dhe të gjitha kulturat tjera etnike në vend. A nuk është e çuditshme dhe si është e mundur që ky trup kundër majorizimit, aspak të mos e vendos në rend të ditës "Shkupi 2014"? Në nenin 10 të Ligjit për Komitetin për marrëdhënie mes bashkësive[89] thuhet kështu:

[87]ЧУПЕСКА, Ана, Културните идентитети во политиката : аспекти на мултикултурализмот / Ана Чупеска. - Скопје : Фондација Конрад Аденауер, 2013, стр. 130-131.
[88]ЧУПЕСКА, Ана, Културните идентитети во политиката : аспекти на мултикултурализмот / Ана Чупеска. - Скопје : Фондација Конрад Аденауер, 2013, стр. 131.
[89]https://www.google.com/search?ei=MvlqW-

**Neni 10**

(1) Komiteti shqyrton çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në Republikën e Maqedonisë, jep propozime dhe mendime për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në Republikën e Maqedonisë dhe i paraqet propozimet dhe mendimet në Kuvend.

(2) Komiteti sjell vendim për mënyrën e vendimmarrjes në Kuvend gjatë miratimit të ligjeve në rast të një mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e procedurës së votimit, të cilat kanë të bëjnë dhe prekin veçanërisht:

- kulturën,
- përdorimin e gjuhëve,
- arsimin,
- dokumentet personale dhe
- përdorimin e simboleve.

(3) Komiteti vendos për çështjet e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

(4) Kuvendi është i detyruar të shqyrtojë mendimet dhe propozimet e Komitetit të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni dhe të marrë një vendim lidhur me to.

(5) Kuvendi zhvillon procedurë votimi në përputhje me vendimin e Komitetit për çështjet e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni.

Sipas kompetencave që i jepen Komitetit në nenin 10, pikat 1, 2 dhe 3, përcaktohet saktë se në cilat sfera të marrëdhënieve ndërkombëtare Komiteti jep konkluzionet e tij, të cilat duhet të votohen me dy të tretat e shumicës dhe me dy vota. Kultura është e para në ato kompetenca të cilat duhet t'i ketë ky Komitet. Ne u përpoqëm të zbulonim se cilat pika ishin në rendin e ditës të atyre seancave të

mbajtura nga ky Komitet, por askund nuk gjetëm që është diskutuar për projektin "Shkupi 2014", i cili në të vërtetë është një politikë kulturore e Qeverisë për periudhën dhjetëvjeçare. Ne kërkuam nëpër portale për atë se çfarë është biseduar në mbledhjet e këtij Komiteti dhe rezultatet nga 734 të dhënave të gjetura, të cilat më shumë janë kopje nga ueb faqe të ndryshme, askund nuk ishte një pikë e vetme e rendit të ditës që të flitet për "Shkupi 2014". Për këtë, mendojmë se ky projekt e ka edhe këtë dobësi, ashtu që as nuk është shqyrtuar e as që është biseduar për këtë në trupin më me përgjegjësi në Kuvendin e RM për këtë projekt.

# VII. IMPLIKIMET E PROJEKTIT "SHKUPI 2014" NË PLANIN E JASHTËM

## 7.1.1. PËRMENDORET KONTESTUESE ME GREQINË NGA KOHA ANTIKE (Aleksandri i Madh, Filipi i Dytë dhe nëna Olimpia)

Në kohën e sotme të të jetuarit, vendet e botës janë të detyruar që të bashkëpunojnë. Vlen të përmendet mendimi i teoricientit beogradas Mitroviq i cili thotë: "Regjionalizimi është formë e dëshiruar e globalizimit të Ballkanit dhe mburojë kundër globalizmit si hegjemoni neoimperialiste e vendeve në qendrën e botës. Në këtë aspekt, globalizimi ka funksion të shumëfishtë: a) lajmërohet si faktor i zhvillimit të brendshëm nacional dhe rajonal; b) lajmërohet si faktor i integrimit demokratik të vendeve ballkanike (krijimi i tregut të përbashkët, unioni i lirë doganor...); c) lajmërohet në formën e demokratizimit të brendshëm të shteteve demokratike nëpërmjet decentralizimit të sistemit dhe forcimit të kapaciteteve të demokracisë përfaqësuese – vetëqeverisjes lokale dhe rajonale; ç) lajmërohet si mburojë dhe mbrojtje kundër globalizmit i manifestuar si projekt i pabarazive të reja në botë, por njëherësh lajmërohet edhe si faktor në luftë për marrëdhënie të reja më të barabarta ndërkombëtare ekonomike, sociale, politike dhe kulturore në botë, ku nuk do të ekzistojnë disproporcionet dhe ndarjet e mëdha si ato tani në relacionin Veri – Jug, gjegjësisht qendrës botërore – periferisë së botës..."[90]Nga

[90]Ljubiša Mitrović: SUDBINA KULTURNIH I ETNIČKIH IDENTITETA U PROCESIMA

një këndvështrim tjetër, Tejlori lidhur me dilemat e identitetit thotë: "...mospranimi ose pranimi i gabuar i identitetit të caktuar (aspekti bërthamor dhe stabil i vetvetes) mund të jetë formë e represionit, duke e mbyllur dikë në modelin e gabuar, të shtrembëruar dhe të reduktuar të ekzistencës. Në të vërtetë, pa respektimin e identitetit mund të shkaktohet plagë e dhimbshme dhe për këtë, pranimi nuk është vetëm mirësjellje, por edhe nevojë vitale e njeriut."[91]

Si një hyrje në temën e maqedonasve antik, e cila gjatë këtyre dhjetë viteve është kthyer në një debat të madh, madje kemi me qindra libra dhe tituj të cilët i identifikojnë maqedonasit e tanishëm si trashëgimtarë të maqedonasve antik, kemi zgjedhur që ta citojmë një pjesë të librit 700 faqesh nga Risto Stevov me titull "Historia e popullit maqedonas nga kohët e lashta e deri sot", ku ai e citon Aleksandar Donskin, me ç'rast sipas tij: "...ekzistojnë shumë indikacione se maqedonasit antik kanë prejardhje venetike (shprehja "sllave" është përdorur shumë më vonë) dhe ekzistojnë dëshmi në favor të kësaj."

**Dëshmitë historike:** Nga disa burime antike të dokumentuara mund të shohim se maqedonasit dhe helenët ishin dy popuj të ndryshëm. Disa historianë grekë dhe romakë e kanë hulumtuar këtë pikëpamje dhe kanë lënë prova të mbledhura nga kohërat e lashta, të cilat

---

GLOBALIZACIJE I REGIONALIZACIJE NA BALKANU, rad sa projekta „Etnički i kulturni
odnosi na Balkanu – mogućnosti regionalne i evropske integracije", realizovan u Institutu za
sociologiju, Filozofski fakultet-Niš, str.29.

[91]Taylor, Chrales, "The Poltics of Recognition", ed. Gutmann E. "Multiculturalism and the Poltics of Recognition", Princeton University Press, Princeton 1992.

tregojnë qartë se maqedonasit e lashtë kanë origjinë venetike.

**Dëshmitë linguistike:** Megjithëse fjalori i maqedonasve antik që ka arritur të mbijetojë është relativisht i vogël, ai është një tregues i mirë në favor të tezës tonë dhe kjo është se gjuha bashkëkohore maqedonase është të paktën pjesërisht vazhdimësi e gjuhës në të cilën ka folur Aleksandri i Madh dhe bashkëkohësit e tij.

**Dëshmitë onomastike:** Ekziston një trashëgimi e konsiderueshme e mbetjeve arkeologjike edhe në fushën e ritualeve të varrimit. Ato përmbajnë në njërën anë shumë shembuj të ngjashmërisë midis gjuhës antike dhe asaj moderne maqedonase dhe në anën tjetër të gjuhëve tjera sllave. "Ekzistojnë gjithashtu disa dëshmi gojore që tregojnë në të njëjtin drejtim."

Aleksandar Donski së fundmi botoi një libër mbi këtë temë dhe tani është në dispozicion edhe në anglisht.

Libri i botuar së fundmi "Venetët: Ndërtuesit e parë të Bashkësisë Evropiane" / "Veneti: First Builders of European Community", e cila konsiderohet si një nga veprat më gjithëpërfshirëse në historinë e hershme të sllavëve, i paraqet venetët proto-sllavë si kombi i parë i njohur në Evropën Qendrore dhe sllovenët si pasardhësit e tyre më të drejtpërdrejtë. Venetët (nuk duhet gabimisht t'i krahasojmë me venedikasit) ishin vendosur në malet e Sllovenisë, Italisë Veriore, Zvicrës Lindore dhe Austrisë gjatë epokës së bronzit, rreth vitit 1200 para Krishtit. Në zonat ku ata fillimisht ishin banuar, ekzistojnë edhe sot vende të panumërta me emra sllovenë.

Këto fakte të paraqitura në libër, nuk janë të reja dhe deri më tash janë studiuar dhe për to janë shkruar raporte

nga ana e ish studiuesve, por për arsye të panjohura, nuk janë marrë seriozisht.

Përveç të dhënave të rëndësishme historike, autorët e këtij libri kanë paraqitur toponime të shumta sllovene në rajonin e Alpeve, në perëndim dhe veri, ku dikur jetonin venetët. Përveç kësaj, libri zbulon shumë ngjashmëri midis gjuhës moderne sllave dhe gjuhës së venetëve. Kërkimet e kryera mbi mbishkrimet venetike dëshmon se jo vetëm që gjuha antike venetike (në krahasim me linguistët zyrtarë) ishte protosllav, por se sllavishtja moderne është vazhdimësi e saj.Populli i parë i njohur në Evropën Qendrore sipas autorëve të këtij libri, ishin venetët protosllavë dhe gjuha fillestare në Evropën Qendrore para ardhjes së indoevropianëve rreth 2000 vjet para Krishtit ishte gjuha sllovene.[92]

Në anën tjetër, në një libër tjetër vëllimor në gjuhën shqipe i autorit Shefki Ollomani me titull "Leka i Madh" (Aleksandri i Maqedonisë) /rrënjët e vërteta/ e publikuar në vitin 2015 në Shkup, po ashtu duke u thirrur në autorë të huaj, rrënjët e Aleksandrit të Madh thuhet se janë ilire. Në pjesën e cituar thuhet: "Profesori Oto Miler shkruan: "Mbretërit e këtyre tri provincave, Epirit, Maqedonisë dhe Ilirisë, kanë mbajtur rroba të njëjta dhe janë lidhur mes vete gjithmonë me anë të martesave. Kështu, gjyshja e Aleksandrit të Madh ka qenë ilire ndërsa nëna e tij Olimpija ishte nga familja epirote."

Në librin "Historia e Aleksandrit të Madh"', historiani romak Kurt Rufi, mes tjerash tregon: "...do të gjejmë të dhëna shumë interesante për studimin e Aleksandrit të Madh, periudhë në të cilën mes tjerash kuptojmë se

[92]Ристо Стевов, `Историја на македонскиот народ од антички времиња`, Risto Stefov Publications, Toronto, Canada, 2008, стр. 23 и 24.

'Aleksandri i Madh fliste gjuhë ndryshe nga ai i ushtarëve të tij.'"

Në ndërkohë, Straboni në një vend tjetër thotë: "Si gjithmonë, edhe sot në një pjesë të Maqedonisë, nga Thesalia e mbajnë barbarët, moloziakët, tesprotët dhe të tjerët". Por, historiani Kasij Dio thotë: *"Toka që quhet Maqedoni është vend i popullit të vendosur më herët nga barbarët: Ilirët dhe Bardhët."*

Studiuesja Barbara Jelaviç do të shprehet: "*Rrënjët etnike të maqedonasve antik ishin me sa duket ilire, megjithëse në atë kohë shtresa e sipërme e shoqërisë maqedonase kishte rënë nën ndikimin e kulturës greke". Historiani i madh i shekullit XIX, Teodor Momzen, shkruan: "Në Ballkan në kohën romake, provincat e brendshme të Maqedonisë, përveç latinishtes dhe greqishtes, kanë ruajtur gjuhën e tyre - ilirishten*".

Kah mesi i shekullit të kaluar, shkencëtari gjerman Han, kishte formuluar këto teza të tij:

1. Epirotët dhe maqedonasit në kohën e Strabonit ishin jogrekë ose barbarë.

2. Epiri, Maqedonia dhe Ilirët janë farefis, ndërsa gjuha ilire në kuptimin më të gjerë rrjedh nga pellazgët.

Me këto teza, shkencëtari i njohur gjerman Han, ilirët i radhit si paraardhës të shqiptarëve, duke përfshirë Epirin dhe maqedonasit antik. Do të thotë, të gjithë këta popuj vijnë nga pellazgët.

Teza për përkatësi të përbashkët etnike të epirëve, ilirëve të lashtë dhe të maqedonasve është një mendim i pranuar nga të gjithë, sepse ka shumë pak argumente se ata e kanë lënë gjuhën e këtyre popujve, flet qartë për ngjashmërinë e tillë. Filipi i Dytë i Maqedonisë iu është bashkëngjitur këtyre fiseve / kombeve në një fuqi të vetme.

Në këtë mënyrë, trakët, maqedonasit dhe ilirët u bënë themeli i ushtrisë fitimtare të Aleksandrit të Madh.

Ambasadori amerikan në Athinë dhe në Mal të Zi, Georg Fred Vilijams në vitin 1912-1914 thotë: "Gjuha shqipe ishte gjuha e Aleksandrit të Madh i cili e pushtoi botën, gjuha e Epirit është ajo epire, njërit prej gjeneralëve më të mëdhenj të suksesshëm që e përmend historia."[93]

Sipas këtij libri të autorit Shefki Ollomani, kemi mjaft argumente të shkëlqyera se Aleksandri i Madh në të vërtetë është ilir, pra shqiptar. Mirëpo, për shkak të euforisë së madhe për kulturën helene e cila ekziston te popujt evropianë dhe botërorë, kjo tezë nuk mund të kalojë për shkak se grekët moti kohë i kanë përvetësuar veprat dhe historinë e maqedonasve antik.

Pikërisht për shkak të këtyre dilemave, edhe autori Branisllav Sarkanjac shkruan në kolumnën e tij të publikuar më 2 dhjetor 2009 në portalin 'Makedonska nacija' me titull 'I kujt është Aleksandri?' Duke bërë një distancë të vogël profesionale, autori citon edhe autorë të tjerë të cilët e kanë këtë dilemë të vetë autorit. Kështu, në këtë kolumnë shkruan: "Nuk përfitojmë shumë nëse dikujt në Angli ose Greqi i tregojmë se jemi maqedonas, për shkak se Kërste Misirkovi ka shkruar për punët maqedonase. Nuk mund të presë dikush në Oksford që ta njohë Misirkovin njëjtë siç nuk mund të presë që ta njohë Pecko të Dar Marit. Ajo që përgjithësisht është e njohur në Maqedoni, nuk është përgjithësisht e njohur në botë dhe vështirë kalon si njohuri referente në një kontest në të cilin jemi të detyruar me grekët. Na duhet diçka më shumë. Për këtë, nuk duam as tekste që kanë të bëjnë me ne, te të cilat zbulojmë derivate të

[93]Shefki Ollomani, "Leka i Madh", "Shkupi", Shkup, 2015, стр 15 и 16.

historive të huaja dhe të shkencave, ku nuk ekziston, ku mohohet Maqedonia. Posaçërisht derivate të historive shtetërore të imperializmave ballkanik.

Si për shembull, në librin e Entoni D. Smit "Identiteti nacional" që e përpunon çështjen e identitetit nacional. Përndryshe, profesori Entoni Smit këto dekadat e fundit është udhëzuesi kryesor për lexuesit në gjuhën angleze, kur bëhet fjalë për temat komb dhe nacionalizëm.

Në një vend në librin e tij thuhet: "Grekët dhe bullgarët debatojnë për origjinën 'kombëtare' të varreve mbretërore të Maqedonisë Antike." Pyetjen që do ta shtronte menjëherë secili në Maqedoni është - prisni, pse nuk ka maqedonas në atë mosmarrëveshje, pse nuk përmenden maqedonasit? Pse një autoritet i tillë si profesor Smith i ka harruar maqedonasit? Sepse profesor Smith citon burime greke dhe bullgare dhe nuk citon burime maqedonase. Sepse historia greke dhe bullgare si shkencë shtetërore janë më të fuqishme se ajo maqedonase.

Pra, nëse flasim për veten tonë, ne përfundojmë vetëm duke bërë gjysmën e punës. Nga ana tjetër, është e vështirë të merresh me atë që na "fshin" nga historia dhe ka më shumë pushtet politik se ne...

Kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë për njerëz që flasin në favorin tonë e të cilët kanë më shumë pushtet politik sesa ata që flasin kundër nesh.

Dy pasuset në vijim janë një ilustrim i asaj që unë dua të vendos si një rekomandim intelektual.

I kujt është Aleksandri i Madh? Si do ta detyroni Entoni D. Smit që t'i përfshijë maqedonasit në kontest? Pra, duke iu referuar teksteve të autoriteteve shkencore ndërkombëtare.

Për shembull, çfarë do të thoshin grekët në lidhje me tekstin e Kristian Majer, profesorit të historisë në Universitetin e Mynihut, në një nga revistat më prestigjioze në Gjermani dhe botë "Merkur", nëntitulli i së cilës është "revista gjermane për mendimin evropian." Titulli i tekstit është "Barazia dhe kufijtë. Aristoteli, grekët, barbarët, skllevërit." (botimi shtator dhe tetor 1995) Siç thekson Meyer, grekët antik duke e bërë dallimin midis grekëve të lirë dhe barbarëve (përveç gjuhës dhe fesë), vendosën unitetin grek. Sidoqoftë, ai unitet nuk është unitet politik. Megjithëse Aristoteli tha se grekët mund të sundonin kombet e tjera nëse ata mund të bashkoheshin në një unitet të vetëm politik, ai përsëri fliste vetëm për polise, kështu që ai ndoshta nuk mendonte se një gjë e tillë ishte e mundur. Megjithëse ideja për të pushtuar pjesë të mëdha të Azisë nuk ishte në anën e grekëve. Por Aristoteli fliste vetëm për polise të vogla dhe ndoshta e dinte se grekët nuk mund të bashkoheshin aq fort. Prandaj, Kristian Majer vazhdon: "Atë që e bëri Aleksandri i Madh, atë e bëri si mbret i maqedonasve, një popull që nuk i përket grekëve. Atë që bëri Aleksandri, nuk e bëri si grek, as si dishepull i Aristotelit!"

Dhe çfarë shkruan profesor Stefan Breuer në studimin e tij "Shteti":

"Edhe të pranohet faktin se në ushtrinë e Aleksandrit numri i grekëve nuk është shumë më i vogël se numri i maqedonasve dhe edhe të pranohet se në Perandorinë Ptolomeje burokracia përbëhej nga grekët - përsëri, fakti që këto mbretëri nuk kanë vazhdimësi me polisin grek mund të hidhet poshtë, por ato janë vepër e Aleksandrit të Madh!"

Tani, i kujt qenka Aleksandri?

Kur Entoni Smit përmend maqedonasit në një botim të ri të "Identitetit Kombëtar" ose në një libër të ri, konflikti i identitetit me Greqinë do të duhet të zhduket.

Kjo është arsyeja pse ne kemi nevojë për njerëz që qëndrojnë pas fuqisë së kombeve të mëdhenj dhe fuqisë së shkencave të kombeve të mëdhenj. Sigurisht, zëri i çdo maqedonasi dhe i shkencës maqedonase janë gjithmonë të rëndësishëm - çdo zë i detyron fuqimisht shkencat dhe publikun e atyre vendeve të mëdha që të merren me Maqedoninë."[94]

Fundi i këtij teksti duket të jetë një sinjal i situatës aktuale kur Maqedonia dhe Greqia bënë Marrëveshjen e Prespës, me mbështetjen e vendeve të huaja të fuqishme, të tilla si Gjermania. Marrëveshja është interesante në shumë aspekte, ndërsa me përmendoret kontestuese të Aleksandrit të Madh të cilin qeveria e mëparshme e kishte quajtur 'Luftëtari në kalë', si dhe ajo e Filipit II, mbetën që të mos zhvendosen, por në to të shkruhet 'Aleksandri, Mbret i Madh i Maqedonisë Antike.' Ngjashëm ndodhi edhe me Filipin II.

Kjo zgjidhje në të vërtetë tregon se sa e lehtë është të gjesh një zgjidhje, kur ekziston një mirëkuptim midis dy burrështetasve të arsyeshëm të dy shteteve. Sepse implikimet e historisë në politikë janë të gabuara dhe katastrofike për kombet. Qeveria e mëparshme, duke përvetësuar me këmbëngulje figurat historike si ekskluzivitetin e një populli, bëri një politikë të tillë kulturore që gjente vazhdimisht patriotë dhe tradhtarë mes vetë maqedonasve, dhe më pas prishi marrëdhëniet e brendshme ndëretnike, kryesisht maqedono-shqiptare dhe

[94]http://www.mn.mk/aktuelno/860, (Објавена на 2 декември 2009).

më pas edhe në planin e gjerë ndërajonal ballkanik, duke krijuar mospajtime rrënjësore. Ky është një shembull i një politike të keqe kulturore që ndikoi drejtpërdrejt në imazhin e Maqedonisë, si një vend grindjesh dhe mosmarrëveshjesh të vazhdueshme me shqiptarët dhe me vendet fqinje të saj të parë Greqinë dhe Bullgarinë.

## ZGJIDHJA E KONTESTIT NËPËRMJET MARRËVESHJES SË PRESPËS

Se nuk ka probleme dhe konteste që nuk mund të zgjidhen mes shteteve, këtë e treguan dy kryeministrat, ai i Greqisë (Cipras) dhe i Maqedonisë (Zaev) nëpërmjet bisedimeve dhe negociatave intensive të cilat ndodhën gjatë vitit 2017. Këto bisedime të vështira e të ndërlikuara gjatë tërë vitit ndodhën në disa nivele të bisedimeve, por në fund ato përfunduan me rezultat – me një marrëveshje të gjerë dhe të detajuar për emrin e vendit tonë dhe për të gjitha aspektet e bashkëpunimit në mes të dyja shteteve. Në shtojcën e këtij punimi ua prezantojmë tekstin e plotë integral të kësaj marrëveshje të quajtur Marrëveshja e Prespës, nga viti 15.6.2017.

Kjo marrëveshje është nënshkruar nga ana e ministrave të punëve të jashtme të Maqedonisë dhe Greqisë me dëshminë dhe në pajtim me Rezolutën 817 (1993) dhe Rezolutën 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të KB nga Metju Nimic në Prespë, dhe për këtë edhe u quajt Marrëveshja e Prespës.[95]

[95]https://www.mkd.mk/makedonija/politika/celosen-transkript-od-dogovorot-megju-makedonija-i-grcija (ВО ДОДАТОКОТ НА ДОКТОРСКАТА).

## 7.1.2. PËRMENDORET DHE NGJARJET KONTESTUESE ME BULLGARINË (Car Samoili, Shën Klimenti i Ohrit, Goce Dellçevi, Ilindeni etj.)

**B**ullgaria dhe Maqedonia kanë kontest të vjetër për shkak të faktit se Bullgaria e konteston gjuhën e maqedonasve, sepse ajo konsiderohet si "gjuhë tjetër bullgare". Kontesti është edhe më i madh i personaliteteve dhe ngjarjeve historike siç janë Car Samoili, Shën Klimenti i Ohrit, revolucionari Goce Dellçev, Jane Sandanski, Republika e Krushevës etj. Të gjitha këto personalitete dhe ngjarje historike janë pjesë e librave të historisë te të dy popujt si të tyre. Ky kontest i cili në shikim të parë është shumë i rënde dhe i ndërlikuar, para fundit të vitit 2017 mori epilog për fillimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve nëpërmjet marrëveshjes miqësore ndërshtetërore mes Bullgarisë dhe Maqedonisë.

Që të gjendet esenca e kontestit me Maqedoninë, sipas autorit bullgar Georgi Kadev i cili në shkrimin "Raportet e Bullgarisë me Maqedoninë dhe me të tjerët, problemet dhe kontradiktat" pasi që flet për kohën e Samoilit, Betejën e Kosovës, Perandorinë Osmane dhe deri në periudhën e sotme para Luftës së Dytë Botërore thotë: "Në vitin 1939 filloi Lufta e Dytë Botërore. Bullgaria u inkuadria në vitin 1941 në anën e Paktit Trepalësh (Forcave të Boshtit). Trupat bullgare sërish hynë në Maqedoninë e Vardarit. Populllata lokale bullgare i përshëndeti si çlirimtarë e jo si okupatorë – siç pohojnë historianët maqedonas. E gjithë kjo mund të shihet në fotografitë e bëra në atë kohë, ku shihet se si ushtarët tanë janë pritur – me lule dhe buzëqeshje nga ana

e popullsisë në Maqedoni."[96] Në vazhdim të librit ka edhe mendime tjera interesante, ndërsa ne e veçuam atë që është më se e njohur e liderit komunist bullgar Dimitrov gjatë takimit me Stalinin dhe me Titon. Në takimin e Dimitrovit, Titos dhe Stalinit, Tito i ofron Dimitrovit që "Bullgaria të bëhet republika e 7 e Jugosllavisë", ndërsa Dimitrovi kërkoi "Konfederatë të Bullgarisë me Jugosllavinë në të cilën pjesë do të hyjë Pirini, me ç'rast bullgarëve të cilët quhen maqedonas t'ju sigurohet autonomia."[97] Citimi i Kadevit lidhur me këtë është kështu: "Më 27.9.1944, Georgi Dimitrov në Moskë bisedoi me Titon për krijimin e unionit mes Bullgarisë dhe Jugosllavisë. Ideja ishte që të krijohet një federatë e sllavëve jugorë. Sipas projektit jugosllav, Bullgaria thjesht duhej të bashkëngjitet si anëtarja e shtatë e federatës, që do të thotë se Jugosllavia do ta gëlltit Bullgarinë. Projekti bullgar siguron federatën e Jugosllavisë me Bullgarinë, me qëllim që të krijohen dy shtete federale të barabarta. Stalini e përkrahu kërkesën bullgare dhe e urdhëron Georgi Dimitrovin që ta përshpejtojë procesin e maqedonizimit të rajonit të Pirinit. Sipas tij, duhet të ekzistojë Autonomia e rajonit të Pirinit në kuadër të Bullgarisë, edhe pse nuk ekziston vetëdije e zhvilluar maqedonase te popullata. Në ndërkohë, në mars të vitit 1945 u soll ligji në Republikën Popullore të Maqedonisë për formimin e gjykatës për mbrojtjen e dinjitetit nacional maqedonas. Gjatë tërë atij viti, zyrtarisht u formuan populli

[96]Георги Кадев, ОТНОШЕНИЯТА МЕЖДУ БЪЛГАРИЯ И РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЯ – ПРОБЛЕМИ И ПРОТИВОРЕЧИЯ, стр. 227 (земено од ПДФ формат на интернет страница: ip.swu.bg/.../20%20Отношенията%20между%20България%20и% ).

[97]Георги Кадев, ОТНОШЕНИЯТА МЕЖДУ БЪЛГАРИЯ И РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЯ – ПРОБЛЕМИ И ПРОТИВОРЕЧИЯ, стр. 228(земено од ПДФ формат на интернет страница: ip.swu.bg/.../20%20Отношенията%20между%20България%20и% ).

maqedonas dhe gjuha maqedonase, alfabeti i krijuar nga Bllazhe Konevski dhe Edvard Bernshtajn."[98]

Në këtë punim shkencor mjaft atraktiv është komentuar edhe Marrëveshja e miqësisë mes Bullgarisë me Jugosllavinë e nënshkruar në Bled të Sllovenisë, ku Dimitrovi pajtohet që në Maqedoninë e Pirinit të mësohet dhe të flitet gjuha maqedonase. Kështu, Kadevi thotë: "Në vitin 1947 Dimitrov dhe Tito e nënshkruan Marrëveshjen e miqësisë dhe ndihmës së ndërsjellë në Bled, Sllloveni.

Sipas asaj marrëveshje:

1. Duke e përfshirë Maqedoninë e Pirinit si njësi federale në Jugosllavi, si pjesë e IRJM-së;

2. Nisja e Jugosllavisë nga vendet perëndimore dhe kthimi në kufijtë e Bullgarisë;

3. Heqja e vizave ndërmjet dy shteteve;

4. Vendosja e unionit doganor.

Qeveria e Georgi Dimitrov është obliguar që në Maqedoninë e Pirinit ta hapë teatrin maqedonas, librarinë maqedonase dhe nëpër shkollat maqedonase ta fusë mësimin e gjuhës dhe historisë maqedonase. Në pajtim me marrëveshjen e njëjtë, në Maqedoninë e Pirinit arritën një numër i madh i mësuesve, bibliotekistëve, inspektorëve, regjisorëve dhe personave tjerë të cilët filluan që ta përhapin vetëdijen nacionale maqedonase në mesin e popullsisë. Këta tellallë të Titos dhe Kolishevskit janë të varur nga shteti bullgar. Mirëpo, ata punojnë kundër ligjeve dhe interesave të saj me fillimin e fushatës

[98] Георги Кадев, ОТНОШЕНИЯТА МЕЖДУ БЪЛГАРИЯ И РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЯ – ПРОБЛЕМИ И ПРОТИВОРЕЧИЯ, стр. 228 (земено од ПДФ формат на интернет страница: ip.swu.bg/.../20%20Отношенията%20между%20България%20и% ).

sistematike kundër kulturës dhe gjuhës bullgare."[99] Për një kohë të shkurtër, kjo marrëveshje u bë e pavlefshme, ashtu që Maqedonia e tanishme mbeti pa iu bashkëngjitur Bullgarisë. Pastaj pasoi: "Në pranverën e vitit 1948, kundërthëniet në mes Stalinit dhe Titos eskaluan në një konflikt të hapur. Funksionarët bullgarë filluan gradualisht që të distancohen nga kjo pozitë e çështjes maqedonase. Më pas, rezoluta e Inforbyrosë e vitit 1948 e cila e akuzoi UNPC-në dhe udhëheqjen e saj për paraqitjen e nacionalizmit dhe trockizmit, shkaktoi përçarje në marrëdhëniet mes Jugosllavisë dhe BRSS. Kjo çoi deri te çrrënjosja e gjendjes jonormale në Maqedoninë e Pirinit – ku banorët mbështeteshin në maltretime të rënda politike dhe morale të kryera ndaj tyre nga ana e ithtarëve të tezës së maqedonizmit."[100]

Ngritja e Car Samoilit, Goce Dellçevit, Jane Sandanskit dhe të tjerëve të cilët janë lëndë e historisë në shesin e Shkupit, në kuadër të projektit "Shkupi 2014" ishte e dëmshme për Maqedoninë dhe vlen të citohet autori i njëjtë bullgar i cili për popullin maqedonas dhe për politikanët thotë: "Për fat të keq, prapë politikanët po vazhdojnë të jenë të orientuar drejt serbëve dhe politikës serbe për maqedonizmin. Bullgaria prapë është armiku numër një. Historianët nga Shkupi po vazhdojnë që të fusin fakte dhe ngjarje të gabuara historike. Sipas tyre, Cirili dhe Metodi janë rilindës maqedonas, mbreti Samoil është paraqitur si

[99]Георги Кадев, ОТНОШЕНИЯТА МЕЖДУ БЪЛГАРИЯ И РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЯ – ПРОБЛЕМИ И ПРОТИВОРЕЧИЯ, стр. 229-230 (земено од ПДФ формат на интернет страница: ip.swu.bg/.../20%20Отношенията%20между%20България%20и% ).

[100]Георги Кадев, ОТНОШЕНИЯТА МЕЖДУ БЪЛГАРИЯ И РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЯ – ПРОБЛЕМИ И ПРОТИВОРЕЧИЯ, стр. 229 (земено од ПДФ формат на интернет страница: ip.swu.bg/.../20%20Отношенията%20между%20България%20и% ).

mbret maqedonas, Goce Dellçevi, Jane Sandanski dhe revolucionarët tjerë bullgarë janë paraqitur si maqedonas për nga nacionaliteti, madje edhe Nikolla Vapcarovi ishte emëruar si themelues i letërsisë maqedonase, edhe pse nëna e tij Elena Vapcarova thotë se është letërsi bullgare. Storja jonë është e bazuar në dokumente. Ata pohojnë se Samoili dhe të lartpërmendurit janë bullgarë. Interpretimi maqedonas i ngjarjeve historike sot e kësaj dite nuk është e pranuar nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për shkak të mungesës dëshmive dhe dokumenteve. Mirëpo, prapë fëmijët në Republikën e Maqedonisë vazhdojnë të hutohen. Nëpër librat e historisë, bullgarët prezantohen si tatarë dhe si armiq më të mëdhenj të Maqedonisë."[101]

Kontesti mes Bullgarisë dhe Maqedonisë gjithmonë ka qenë mjaft interesant, paralajmërues dhe i vëmendshëm nga të dyja anët. Me siguri, ky kujdes nga të dyja anët ishte për shkak të faktit se Bullgaria është kujdesur që mos t'i humb argumentet e tij për gjuhën dhe historinë e njerëzve të saj të cilët veten e kanë quajtur maqedonas, ndërsa në anën tjetër edhe maqedonasit janë kujdesur që mos ta humbin Bullgarinë dhe bullgarët, për shkak se ata i kanë parë si "vëllai i madh" me të cilin e ndajnë historinë dhe të kaluarën nacionale. Ekzistojnë shumë burime bullgare të cilët moti e shkruajnë këtë, mendoj se për këtë punim është interesant qëndrimi i veprimtarit bullgar Stefan Zahariev i cili në veprën e tij shkruan: "...mjaft folën për dasmën e maqedonasit të pasur Karan, tani ta lëmë Atinejin e përmendur që të dëshmojë se romakët e kanë pranuar

[101]Георги Кадев, ОТНОШЕНИЯТА МЕЖДУ БЪЛГАРИЯ И РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЯ – ПРОБЛЕМИ И ПРОТИВОРЕЧИЯ, стр. 231 (земено од ПДФ формат на интернет страница: ip.swu.bg/.../20%20Отношенията%20между%20България%20и% ).

shkëlqimin nëpër dasma nga maqedonasit dhe t'i shohim maqedonasit e tanishëm të cilët, të verbuar nga rrezatimi sublim i mençurisë helene, pranojnë të përçmojnë dhe heqin dorë nga kombësia e tyre. Për këtë, përshkrimi i gostive të Karanit më janë dukur të volitshme për kohën e të them, ja me të vërtetë jemi larg kohës kur sot prej të gjithëve Elada (Greqia) e quajtur ka qenë e nënshtruar nga pushteti maqedonas dhe u largua nga heroizmi i tyre, te ahengjet e tyre të pasura duke i adhuruar si robër... Sipas kësaj, nëse qëllimi ynë ishte që t'i përshkruajmë ato të ruajtura nëpër librat greke, traditat e dasmave dhe gostitë e maqedonasve të lashtë", arsyeja e largimit nga tema është të provosh civilizimin e sllavëve maqedonas, se çfarë përbëhej në kohën e Aleksandrit dhe deri ku shkoi arsimimi i tyre, për të përdorur helenët për tallje, mashtrim dhe injorancën e tyre të tanishme në të cilën ata hodhën ipeshkvijtë grekofenere që t'i ftojmë bashkatdhetarët tanë patriotë t'i ndihmojnë si nga ana morale, ashtu edhe nga ana materiale..."[102]

Kjo nostalgji e historisë bullgare dhe e shoqërisë për popullin maqedonas gjendet në tekstin e Javor Mihajllovit me titull "Bullgaria, Maqedonia: Lufta për histori nëpërmjet bllogjeve"[103] e cila u publikua më 11 prill të vitit 2008. Në këtë tekst thuhet: "Raportet e Bullgarisë dhe Maqedonisë janë njëjtë komplekse dhe të pakuptueshme sikurse ato në mes Greqisë dhe Maqedonisë, edhe pse nuk ka eksponim të madh mediatik. Problemi kryesor mes Sofjes dhe Shkupit prapë është historia."[104] Kjo do të thotë

[102]На 25 март 1870. Во Т. Пазарџик, Стефан Захариев Читалиште (Цариград) I/7 (1871, стр. 214-216).
[103] https://mk.globalvoices.org/04/11/83/
[104]https://mk.globalvoices.org/04/11/83/(поечеток на статијата).

se plotësisht janë të sakta tezat dhe dilemat të cilat e rrethojnë opinionin shkencor dhe atë publik që ekziston në Maqedoni. Kështu autori vazhdon: "Sipas bullgarëve, maqedonasit kanë qenë pjesë e kombit bullgar deri në fillim të shek. XX kur një pjesë e madhe e Maqedonisë me Luftërat Ballkanike ra nën sundimin serb. Atëherë, për shkak të politikës së Serbisë ndaj rajonit dhe doktrinës së maqedonizmit, ndodhën ndryshime në mendimet e popullsisë lokale, duke çuar deri në formimin e kombit maqedonas. Qëndrimet e Kominternës dhe Stalinit lidhur me këtë çështje kishin ndikim të madh në rezultat."[105]

Këto qëndrime gjatë kohë kanë qenë në këtë rajon si spekulime të cilat gjithmonë janë llogaritur si "konspiracion politik" kundër Maqedonisë. Në tekstin e këtij shkrimi interesant, autori shton: "Maqedonasit në anën tjetër llogariten si komb komplet i veçantë, trashëgimtarë të popujve të lashtë. Ata e akuzojnë fqinjin e tyre Bullgarinë për marrjen e një pjese të tokës së tyre dhe pohojnë se Sofja po përpiqet që të marrë pjesë nga historia maqedonase, si për shembull: Car Samoilin, Shën Klimentin e Ohrit, revolucionarin Goce Dellçev etj."[106] Në anën tjetër "...bullgarët drejtojnë akuza të ngjashme drejt Maqedonisë. Kontesti ditë me shumë po përkeqësohet me frikën e Maqedonisë se Sofja po përpiqet që t'i "përvetësojë" maqedonasit, derisa bullgarët po dyshojnë se fqinji i tyre po përpiqet që ta grabisë rajonin e Pirinit i cili është pjesë e Maqedonisë së Madhe."[107] Gjërat interesante në këto teza vijnë më shumë nga qarqet e ashtuquajtura nacionaliste të diasporës të cilët duke ëndërruar për shtete

[105] https://mk.globalvoices.org/04/11/83/
[106] https://mk.globalvoices.org/04/11/83/
[107]https://mk.globalvoices.org/04/11/83/

të mëdha, bëjnë harta të vetëkënaqjes e të cilat shumë shpejtë i gjejnë ithtarët e tyre nëpër vendet amë. Me Maqedoninë problemi u thellua me politikën kulturore e cila u identifikua me "Shkupi 2014" ku pushteti duke u përpjekur që të bëhen "nacionalistë" më të mëdhenj se diaspora e tyre, e grumbullonte projektin "Shkupi 2014" me përmendore të cilat në Bullgari dhe në Greqi konsiderohen si themelues të historisë së tyre. Në fund të tekstit, autori i këtij artikulli të shkurtër thotë: "Të gjitha këto kundërthënie u hodhën në hapësirën virtuale dhe me këtë filloi lufta e përhershme për historinë në mes bllogerëve bullgarë dhe atyre maqedonas – luftë e cila shpesh i kalonte rregullat e bontonit. Blogosfera bullgare gjithashtu debatonte rreth qëndrimit të Bullgarisë ndaj Maqedonisë."[108] Kjo do të thotë se "lufta" virtuale po bëhet gjithnjë e më e ashpër me politikat konkrete të këqija të Maqedonisë të cilat drejtpërdrejtë ishin pengesë për marrëdhëniet fqinjësore me Bullgarinë. Se ekzistojnë mundësi për marrëveshje dhe mënyra për t'u tejkaluar hendeku mes Bullgarisë dhe Maqedonisë, këtë e paralajmëroi gazeta bullgare "24 çasa" e cila në titullin: "Çka nëse Bullgaria e pranon gjuhën maqedonase?"[109] Sipas gazetës, "...me këtë rast Bullgaria me siguri do ta humb Maqedoninë e Pirinit, autonomia kulturore e së cilës do të shndërrohet në administrative, me hymnin e saj, me kryetarin..."[110] Ky dyshim i gjason frikës së panevojshme nga ana e atyre qarqeve të cilat e përhapin të njëjtën, për shkak të faktit se pretendimet e tilla i kanë përhapur vetëm nacionalistët e frustruar nga diaspora dhe pushteti i

[108]https://mk.globalvoices.org/04/11/83/
[109] https://mk.wikibooks.org/wiki/%D0%A8%D1%
[110]https://mk.wikibooks.org/wiki/%D0%A8%D1%

mëparshëm i cili në mënyrë indirekte ëndërronte vetëm shpirtërisht për një Maqedoni të tillë.

Korrespondenti i rregullt i Utrinski Vesnik, Viktor Cvetanovski nga Sofja në këtë artikull të shkruar më 23 shkurt 2016, pra para nënshkrimit të Marrëveshjes mes Bullgarisë dhe Maqedonisë, shkruan: "Sipas ekspertëve bullgarë, kontesti gjuhësor me Maqedoninë mund të zgjidhet në atë mënyrë, ashtu që marrëveshjet do të nënshkruheshin në gjuhën bullgare dhe në gjuhën maqedonase, por me një deklaratë shoqëruese të Sofjes, në të cilën do të jepej sqarimi se me këtë gjuhë nënkuptohet gjuha shtetërore e krijuar në Maqedoni në vitin 1945. Në të njëjtën kohë, në Shkup do të deklaronin se heqin dorë nga pretendimet minoritare dhe territoriale ndaj Bullgarisë, pra do të ndryshohej formula e pranimit të realiteteve në Maqedoni kundër ruajtjes së të kaluarës tonë të përbashkët." Kjo është formula të cilën sipas "24 çasa" është duke e shqyrtuar Sofja. Gazeta shton se derisa nuk gjendet zgjidhje për kontestin, kryetari i shtetit Petar Stojanov nuk do ta vizitojë Maqedoninë. Gazeta pohon se autoritetet maqedonase janë pajtuar me formulën e propozuar, por janë menduar se si në mënyrë më elegante t'ia shpjegojnë këtë opinionit me heqjen dorë nga pretendimet minoritare dhe territoriale."[111] Si duket, gazeta me kohë dhe mirë kishte qenë e informuar, gjë që ishte e pranueshme për palën bullgare dhe atë maqedonase. Kështu sipas korrespondentit të Utrinski Vesnik, duke e shprehur qëndrimin e saj me pranimin e gjuhës me humbjen e Pirinit, thotë: "Në të njëjtën kohë, "24 çasa" ua ofron lexuesve skenarin e saj për atë se çka do të ndodhte

[111] https://mk.wikibooks.org/wiki/%D0%A8%D1%

nëse Bullgaria e pranon gjuhën maqedonase. Në tekstin me titull dramatik "Si po e humbim Pirinin", gazeta kthehet për disa vite mbrapa duke potencuar se në vitin 1992, me pranimin vetëm të shtetit maqedonas e jo të popullit maqedonas, Bullgaria është siguruar prej fatkeqësive që do të pasonin në të ardhmen. Me këtë Sofja e ka pranuar territorin e bullgarëve në anën tjetër të kufirit, mirëpo ka refuzuar që të pranojë se njerëzit atje nuk janë bullgarë, se gjuha e tyre është e huaj, historia është e ndryshme... Nëse e pranojmë gjuhën, menjëherë do të fillojnë eksperimentet me popullsinë në Bullgarinë Jugperëndimore. Të shtypur nga kriza dhe nga synimet që mos ta shqetësojmë NATO-n dhe UE, Sofja do të shndërrohet në pëllumb ballkanik i cili do të këndojë. Kjo do t'i japë krahë Shkupit që të marrë pozitë më luftarake... ndërsa politikanët maqedonas do të kërkojnë autonomi kulturore për Maqedoninë e Pirinit dhe të njëjtën do ta fitojnë, kurse nëpër shkolla do të recitohet një Javorski i çuditshëm dheVapcarovski i shtrembëruar, ironizon "24 çasa".[112]

Ne nuk e dimë se a është kjo frikë e vërtetë e një gazete ditore në Sofje apo është vetëm një shtysë për pozita më të pranueshme të palës bullgare në gjetjen e zgjidhjes për kontestin. Gazeta madje shkruan se "Për mbështetjen e këtyre tezave, "24 çasa" thirret në shkencëtarët e institutit shkencor maqedonas lidhur me VMRO-SMD të cilët qysh në vitin 1995 e kanë paralajmëruar ministrin e atëhershëm të punëve të jashtme Georgi Pirinski, se nëse Bullgaria e pranon gjuhën, një pjesë e trupit etnik bullgar do të ndahet, jo pas luftës, por për shkak të paaftësisë së saj." Autori i tekstit paralajmëron se me këtë do të hamendej vetëndjenja

[112]https://mk.wikibooks.org/wiki/%D0%A8%D1%

nacionale e të ikurve nga Maqedonia dhe e pasardhësve të tyre, kurse me legjitimimin e popullit maqedonas do të maqedonizohej e gjithë historia bullgare dhe figurat më të dalluara -Cirili dhe Metodi, Pajsij Hilendarski, Goce Dellçev etj. Kështu do të vritej kujtimi i ndritshëm i përkatësisë ndaj Bullgarisë dhe e bullgarëve maqedonas në SHBA, Kanada dhe në Australi, shkruan gazeta.[113] Për të vazhduar me frikë më konspirative rajonale e cila "...sipas "24 çasa", e gjithë kjo është një fotografi e zbukuruar, ndërsa fotografia e zezë ka filluar kur autonomia kulturore e Maqedonisë së Pirinit do të kalonte në atë administrative, me hymnin, kryetarin, kryeqytetin e saj, kurse në këndin e Bullgarisë do të paraqitej diçka e ngjashme me Kosovën në Jugosllavi. Më pas, separatistët e OMO Ilinden në Pirin do ta vendosin bajrakun maqedonas. Sapo ta shohë këtë Shkupi, do t'ia mbush veshët botës se Sofja po e shkel minoritetin maqedonas, duke çuar në rebelim dhe dëshpërim," shkruan "24 çasa".

Korrespondenti i "Utrinski Vesnik" nga Sofja citon edhe dy gazeta tjera ku thuhet: "Në numrin e sotëm Duma e akuzon Radio Evropën e Lirë se me emisionin special për guidën skandaloze për Ohrin për nevojat e turistëve bullgarë, po e nxit Shkupin kundër Sofjes. Në bisedën e hapur, udhëheqësi i emisionit Ekaterina Bonçeva, botimin e guidës e vlerëson si libër provokues i cili mund t'i dëmtojë marrëdhëniet e ndjeshme bullgaro-maqedonase. Gazeta e socialistëve kërkon nga radio që të jetë lojale ndaj shtetit, pavarësisht se si është e vërteta."[114] Në fund, duke e cituar gazetën tjetër, tregon: "Në të njëjtën kohë në Demokraci lansohet ideja e hapjes së qendrave kulturore bullgare në

[113]https://mk.wikibooks.org/wiki/%D0%A8%D1%
[114]https://mk.wikibooks.org/wiki/%D0%A8%D1%

Maqedoni, ngjashëm si ai në Dimitrovgrad i cili shkaktoi reagime të mëdha në RS të Jugosllavisë. Nuk mund të paramendohet që në fund të shek. 20 në Shkup apo në Ohër mos të ketë qendër kulturore bullgare, ndërsa librat, gazetat apo filmat bullgarë ende të janë të ndaluar", shkruan autori.[115]Këto qëndrime të hapura dhe nganjëherë të sinqerta në fund të kontestit përfunduan me një marrëveshje solide, ashtu që të dy palët mbetën të kënaqur. Është e çuditshme se për gjithë këtë periudhë të aspiratave të negociatave të Maqedonisë me Bullgarinë, pushteti i Gruevskit ishte shumë afër me atë të Beogradit, kur apetitet serbomëdha ishin edhe kundër popullit maqedonas. Hegjemonia serbe mbi popujt tjerë shihet edhe në librin e Mirosllav Brandt, Bozhe Çoviq "Burimet e agresionit serbomadh" ku thuhet: "Pjesa e mbetur e Jugosllavisë (përveç Banovinës së Dravës dhe Banovinës së Kroacisë) duhej të bashkoheshin në të ashtuquajturën "toka serbe" me seli në Shkup. Me këtë do të realizohej ideja ku Jugosllavia do të ishte shtet i serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, ndërsa me këtë Bosnja e Hercegovina më në fund do të ndahej, kurse për shkak të madhësisë së territorit si dhe me shtypjen e etniteteve tjera (muslimanëve, malazezëve, shqiptarëve, hungarezëve, maqedonasve...) do të dominonte Serbia e Madhe."[116]Në fund, duke e publikuar marrëveshjen për shkak se është e shkurtër, duam të theksojmë se mes rreshtave ndjehet gëzimi dhe mërzia për kontestin e kapërcyer të këtyre dy shteteve. Në njërën anë shohim gëzim nga të dyja palët,

[115] https://mk.wikibooks.org/wiki/%D0%A8%D1%

[116] Miroslav Brandt, Bože Čović; Izvori velikosrpske agresije: rasprave, dokumenti, kartografski prikazi, August Cesarec, 1991 (Original from: The University of Michigan, 2008).

ndërsa në anën tjetër parashtrohet pyetja: Vallë është dashur aq shumë kohë që të pritet? Është interesante se dikush mezi kishte pritur që kjo marrëveshje të publikohet në Wikipedia. Kështu, në njërën anë në Wikipedia shkruan: "Marrëveshja e miqësisë, fqinjësisë dhe bashkëpunimit mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë (bullgarisht: Договор за приятелство, добросъседство и сътрудничество между Република България и Република Македония) — marrëveshja mes Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë e nënshkruar më 1 gusht 2017 mes kryeministrave Bojko Borisov dhe Zoran Zaev në Shkup."[117]

Me këtë faktikisht realizohet Marrëveshja sipas mënyrës të cilën paraprakisht e dhanë ekspertët bullgarë si zgjidhje e mundshme e të dyja palëve. Në këtë marrëveshje shihet qartë intenca e të dyja palëve që t'i tejkalojnë mospajtimet dhe të hapërojnë bashkë në një rajon më të qetë dhe në bashkëpunim. Marrëveshja që u nënshkrua, tregoi se të dy vendet mund të japin shembull se si të zgjidhen problemet e ndryshme. Ata e dëshmuan këtë me shembuj konkret të shënimit të përbashkët të Ilindenit në Shkup, pastaj me marrëveshje dhe kontakte tjera mes institucioneve të të dyja vendeve. Njëri prej tyre kuptohet se është ky bashkëpunim me UNIBIT dhe FON. Duke mos hyrë shumë në çështjet religjioze, me rastin e shpalljes së Kishës Ortodokse Bullgare, një prift nga Bullgaria mes tjerash tha: "Kjo është më e pakta që mund ta bëjmë për popullin tonë!" Me këtë dëshmohet afërsia dhe dëshira që t'i ndihmohet KOM, por edhe popullit maqedonas i cili padyshim se ka histori të përbashkët me popullin bullgar.

[117]https://mk.wikipedia.org/wiki/Договор_за_пријателство,_добрососедство_и_соработка_меѓу_Република_Македонија_и_Република_Бугарија.

## VIII. FJALA PËRFUNDIMTARE
## Për ndikimin e politikës kulturore në rrethanat shoqërore NË KONTESTIN E BRENDSHËM DHE NË KONTESTIN ME GREQINË DHE BULLGARINË

### 8.1.1. SHMANGIA E KONFLIKTIT TË BRENDSHËM

Në këtë kontribut modest është paraqitur se si është zhvilluar kultura në Maqedoni në tri periudha të ndara, edhe atë:

1. prej 1945 deri 1990,
2. prej 1990 deri 2007,
3. prej 2007 deri 2017.

**K**uptohet se pjesa më e madhe e disertacionit i është lënë periudhës së tretë, për shkak se në këtë periudhë kemi zhvillim kuantitativ të kulturës me projekte të mëdha financiare, por në planin kualitativ me diskutime të shumta dhe dilema për cilësinë e tij. Kjo do të thotë se pavarësisht interesimit dhe kujdesit shumë të madh të shtetit në këtë periudhë, politika kulturore e nxitur prej preferencave dhe ekskluziviteteve personale të disa njerëzve në majën e pushtetit, çoi deri te ajo që ky zhvillim tepër i madh kuantitativ të jetë tapet për artistët, për partitë opozitare, për qytetarët jomaqedonas, në rend të parë të shqiptarëve, shkupjanëve të vjetër të cilët nuk mund ta paramendojnë se si iu rrënohen kujtimet me përmendore, fontana dhe me ndërtesa barok (të cilat nga ana e jashtme janë vetëm fasadë, ndërsa brendësia e tyre është më e keqe sesa gjendja e mëparshme). Mbi të gjitha, në vend kishte më shumë njerëz të cilët nuk pajtoheshin sesa ithtarë të "Shkupi 2014" i cili u bë simbol i "politikës së keqe kulturore" e cila

padyshim se shkaktoi përçarje në shoqëri në të gjitha nivelet. Fillimisht u lajmëruan disa arkitektë të cilëve nuk iu pëlqeu improvizimi i barokut në pjesën qendrore të qytetit, pastaj u lajmëruan artistët të cilëve nuk iu pëlqeu sheshi i mbingarkuar me përmendore të njerëzve dhe statuja të kafshëve të ndryshme nëpër shesh, u lajmërua ajka e kulturës të cilëve iu pengonte i tërë "projekti diskutabil kulturor arkitektonik në sheshin Maqedonia."[118] Me këtë rast, duke harruar se multikulturalizmi është faktor kyç i qytetarit i cili fillimisht është lojal ndaj shoqërisë, por toleron dhe përkrah të drejta sekondare lojale në të cilat kanë të drejtë veçoritë tjera individuale, zakonet etj., sepse kjo është pjesë e "pakos" së qytetarit."[119] Këtë e thotë Fleras Eliot. Thjesht, shoqëria qytetare në Maqedoni u bë e ndarë si kurrë më parë. Mirëpo, maja e qeverisë së RM "me ngulm" i realizonte frustrimet e saj në llogari të taksapaguesve të saj, pa marrë parasysh qëndrimin e tyre ditë e më shumë negativ. Madje, në momentet e kësaj çmendurie të qeverisë, personalisht në shenjë të pakënaqësisë e përkujtova mitingun e madh të nobelistit për të drejtat e njeriut të zezakëve, Martin Luter King kur tha: " Kur të lejojmë që liria të kumbojë nga secili qytet e secili fshat, nga secili shtet dhe nga secili qytet, atëherë mund ta përshpejtojmë ardhjen e ditës kur të gjithë bijtë e Zotit do të jenë të zinjtë dhe të bardhët, hebrenj dhe johebrenj, protestantë dhe katolikë të cilët do t'i përvjelin mëngët dhe ta këndojnë këngën e vjetër të zezakëve: "Më në fund, falas! Më në fund, falas! Falënderuar Zotit të

[118]Наш став.

[119]http://www.southeast-europe.org/pdf/04/DKE_04_A_E_Berkes-Lilla_Kantor-Judit.pdf (стр 4) FLERAS, ELLIOTT, 1997. 36.

Plotfuqishëm, më në fund ne jemi të lirë."[120] Për politikën kulturore në një shtet multikulturor, mendim interesant ka ish ministrja e kulturës Ganka Samoilova Cvetanovska e cila thotë: "Shoqëritë multikulturore kanë nevojë për politikën e qartë të definuar e cila -nëpërmjet kornizës së përcaktuar kulturore – ka për qëllim që ta nxitë pluralizmin kulturor, me këtë rast duke intensifikuar komunikimin në mes kulturave të ndryshme, mënyrave dhe stileve të të jetuarit. Njëri prej prioriteteve kryesore e politikave kulturore në shoqëritë multikulturore është promovimi dhe përparimi i dallimeve kulturore."[121]

Për ta shpëtuar pamjen dhe frymën e qytetit të Shkupit si dhe për t'u ruajtur dimensioni etnik, religjioz dhe kulturor i qytetit dhe i vendit, fillimisht duhet të gjenden: **mekanizmat për zhvillim të barabartë e të drejtë** të kulturës nëpërmjet buxhetit të arsyeshëm dedikuar veprimtarive kulturore. Në këtë drejtim, duhet të bëhet sistematizimi dhe riorganizimi i Ministrisë së Kulturës për arsye pragmatike, reale dhe të nevojshme në tre reparte për kulturë. **Kreativiteti** duhet të jetë në rend të parë në përkrahjen e projekteve që kanë interes nacional në kulturë. Nxitja e projekteve të cilat i afirmojnë vlerat kulturore të bashkësive të ndryshme kulturore. **Përkrahja e organizatave profesionale** dhe i personave të cilët afirmojnë të arritura kreative artistike në sferën e tyre të kulturës. **Shmangia e përkrahjes se projekteve të realizuara joprofesionale me tenderë korruptues dhe të kurdisur** të cilët bartin para për aplikuesit e zgjedhur, por

[120]http://test.chicagoraja.net/2013/08/27/san-martina-luthera-kinga-pobjedi-ljudskih-prava-sloboda-je-dozivio-jedan-od-najvecih-poraza-bosni-hercegovini/

[121]Проф.Др. Ганка Цветанова, Културните разлики и општествената интеграција : Македонија пред и по Рамковниот договор, Институт за економски стратегии и меѓународни односи - ОХРИД, 2007, стр. 85.

të cilët realizojnë projekte mjaft të diskutueshme. Si për shembull, përkrahja për publikimin e mbi 2000 librave për raste të ndryshme, pastaj ajo për 100 nobelistët e letërsisë, 1000 tituj të literaturës së huaj profesionale, 130 vëllime të letërsisë maqedonase e përkthyer në 5 gjuhë të huaja etj., projekte këto të shitësit të pllakave grafike ose të cilat grafikun e bënë "botuesin" më të madh në Maqedoni. Puna e tyre u tregua si sipërfaqësore, pa pamje dhe frymë të një libri të denjë për t'u botuar sipas meritave të cilat i kanë këto vepra letrare dhe profesionale. Për zhvillim të drejtë dhe të denjë kulturor dhe për tokë të mirë të politikës kulturore, duhet që të **depolitizohen dhe departizohen** të gjitha institucionet kulturore në vend. Për realizimin e kësaj pune, më së miri është që të riorganizohet dhe sistematizohet **Ministria e Kulturës** në tri **reparte të veçanta për bashkësinë maqedonase, shqiptare dhe bashkësive tjera në vend.** Me këtë vendoset baza e zhvillimit të barabartë institucional kulturor i cili do t'i nxitë punëtorët e kulturës për rivalitet kulturor, me këtë edhe në njohjen dhe përparimin e vlerave kulturore dhe të veçorive të të gjitha grupeve etnike në vend.

## 8.1.2 SHMANGIA E KONFLIKTIT TË JASHTËM ME GREQINË

**M**osmarrëveshjet historike të Maqedonisë për një kohë të gjatë me Greqinë mbi emrin e vendit, ku pala greke duke u thirrur në kulturën e saj antike si dhe në territorin e quajtur Maqedoni brenda Greqisë (rreth 51 përqind), dhe duke mos lejuar që një vend tjetër të quhej Maqedoni, kishin periudha kohore kur të dy vendet e mbajtën distancën e tyre të marrëdhënieve ftohtë-nxehtë. Këto marrëdhënie u përkeqësuan pasi u aktivizua në mënyrë euforike ideja se maqedonasit aktual janë pasardhës të Aleksandrit të Madh, gjë që ishte krejtësisht e papranueshme për palën greke. Pikërisht ky afirmim i politikës kulturore i ngritur në interesin kombëtar shtetëror, i prishi të gjitha marrëdhëniet miqësore të Maqedonisë jo vetëm me fqinjët, por edhe me vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Ata thjesht ishin pozicionuar tek anëtari i tyre i BE, d.m.th. në anën greke. Përpjekjet e Maqedonisë për t'i bindur të huajt për të vërtetën e tyre antike ishin të kota, për shkak të faktit të thjeshtë se popujt evropianë në librat e tyre shkollore për kulturën helene dhe Aleksandrin e Madh i identifikuan ata me grekët e tanishëm. Pavarësisht nga fakti që edhe historianë të huaj të njohur e identifikojnë Aleksandrin e Madh me shqiptarët. Kjo periudhë e keqe e antikizimit të Maqedonisë dhe popullit maqedonas mori fund me Marrëveshjen e guximshme të Prespës midis dy palëve, ku Maqedonia pranoi një emër për përdorim të përgjithshëm Republika e Maqedonisë Veriore.

Kjo marrëveshje do të jetë një udhërrëfyes për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë jo vetëm midis

Maqedonisë dhe Greqisë, por për të gjithë rajonin. Marrëveshja 20 faqe ka përshkruar në detaje të gjitha përmirësimet e mundshme në marrëdhëniet midis dy vendeve. Prandaj, në vëzhgimet dhe leximet e mia të kësaj Marrëveshjeje, konsideroj se një Marrëveshje e tillë e modifikuar duhet të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjitha vendet e Evropës Juglindore, për të kapërcyer reliket e së kaluarës. Duke ua lënë historinë historianëve, ndërsa jetën qytetarëve të tyre, politikanët mund të ndihmojnë si Maqedoninë ashtu edhe Greqinë që të prosperojnë. Vetë nevoja për bashkëpunim ekonomik, kulturor, shoqëror dhe çdo bashkëpunim tjetër ndërmjet qytetarëve të të dy vendeve, ofron një mundësi për një rajon më të qëndrueshëm dhe paqësor. Për shembull, sipas Marrëveshjes, duke i dhënë një vend të caktuar një porti detar nga Greqia për nevojat e ekonomisë për Maqedoninë, në një formë të ndryshme nga portet aktuale në Greqi, sigurisht i jep shtysë ekonomisë së Maqedonisë. Ky është vetëm një shembull i cili tregon se me bashkëpunim të sinqertë dhe profesional, më lehtë evitohet matrica e gjendjeve konfliktuoze të të kaluarës. Se sa ishte e rëndësishme kjo marrëveshje, tregon edhe aktori i njohur i filmit "Gladiator", aktori i famshëm holivudian Rasel Krou (13 qershor 2018) i cili në profilin e tij në Tviter e shprehu qëndrimin e tij lidhur me lajmin për marrëveshjen për zgjidhjen e kontestit shumëvjeçar rreth emrit mes Maqedonisë dhe Greqisë: „Mendime të rastit nga Firenca, e dua Greqinë, e dua Maqedoninë, shpresoj segjithçka do të jetë në rregull."[122] Në fjalimin e kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev pas nënshkrimit, vërehej gëzimi të

[122]http://javno.mk/rasel-krou-si-kazha-shto-misli-za-dogovorot-za-reshenie-na-sporot-megu-makedonija-grtsija/

cilin ai ia kumtoi qytetarëve të Maqedonisë, me fjalët: "Kemi mësuar se duhet të mësojmë nga historia e jo ta përsërisim atë. Në themelet nga e kaluara, ne po e ndërtojmë të ardhmen. Me këtë marrëveshje ne marrim kurajo dhe aspirim për besim më të madh mes të dyja shteteve. Zgjidhja dhe procesi nëpër të cilin kaluam, na solli një mik. Do të jemi partnerë dhe aleatë. Tashmë kemi një realitet të ri."[123] Fjalim të ngjashëm kishte edhe kryeministri i Greqisë, Aleksis Cipras i cili tha: "Nënshkrimi i marrëveshjes është një hap i guximshëm, historik dhe i domosdoshëm për qytetarët e të dyja vendeve. Jemi këtu që t'i shërojmë plagët që i la koha, të hapim rrugën e paqes, vëllazërisë dhe zhvillimin e shteteve tona."[124] Në periudhën në vazhdim do të shihet se sa do të arsyetohen këto deklarata optimiste përplot me gëzim të dy kryeministrave.

[123] https://www.mkd.mk/makedonija/politika/zaev-od-prespa-trgnavme-i-stignavme-do-reshenie-neka-ni-e-so-srekja

[124] https://www.dw.com/mk/ историја-во-преспа-потпишан-договорот-за-името/a-4426114 0

## 8.1.3 SHMANGIA E KONFLIKTIT TË JASHTËM ME BULLGARINË

Sipas Sidni Verbi, politika kulturore e pasqyron vetë orientimin politik të një vendi dhe të njëjtën mund ta kuptojmë nga definicioni i saj: "Kultura politike e një shoqërie përbëhet prej sistemit të bindjeve empirike, simboleve të shprehjes dhe vlerave, të cilat e përcaktojnë situatën në të cilën ndodh aksioni politik"[125], ndërsa pikërisht kjo mund të ketë ndikim të brendshëm dhe të jashtëm dhe në pajtim me atë politikë të udhëhequr kulturore është shembulli i Maqedonisë me Bullgarinë.

Historia dhe kultura maqedonase duke dashur që të bëhet më e pasur, për ta dëshmuar pasurinë e saj kombëtare, nuk i kushtoi vëmendje faktit se shumë ngjarje dhe figura të historisë, komuniteti i huaj shkencor tashmë i identifikon si ngjarje dhe figura që i përkasin historisë bullgare. Nga ana tjetër, Bullgaria duke e konsideruar popullin maqedonas si një vëlla më të vogël i cili ka "ikur" nga shtëpia dhe shpreson se një ditë ai "do të kthehet", ishte e para që e njohu emrin e asaj shtëpie, por nuk njohu mbiemrin e vëllait, pra gjuhën dhe etnitetin.

Pikërisht për këtë shkak, Bullgaria pavarësisht faktit se nuk i pëlqente ky zhvillim gjatë gjithë historisë, kurrë nuk bëri "zhurmë" të madhe për historinë dhe kulturën të cilën maqedonasit e paraqitën si të tyren, por kur kjo paraqitje gjatë kohës së kryeministrit Nikolla Gruevski nga Maqedonia filloi të merrte vrull me ngritjen e monumenteve të mëdha për revolucionarët si Goce Delçev,

[125] Verba, S., "Comparative Political Culture", in: L. W. Pay and S. Verba (eds.), Political Culture and Political Development, Princeton Univ. Press, 1965).

ndodhitë e Ilindenit etj., vëllai i madh nuk u "shqetësua" shumë, por u thellua kur frustrimi i qeverisë së Gruevskit filloi të kërkonte rrënjë te Aleksandri i Madh, kjo përfshirje e Car Samoilit me Aleksandrin e Madh shkaktoi pakënaqësi dhe dëshpërim te pala bullgare, kështu që marrëdhëniet midis qeverisë së Gruevskit dhe Borisov "u ftohën" dhe asnjë marrëveshje nuk u arrit midis dy vendeve. Është e qartë se Kryeministri i Maqedonisë u ndikua nga disa qarqe në Serbi, interesi i të cilëve është që Maqedonia mos të ketë marrëdhënie të mira me Bullgarinë dhe Shqipërinë. Sipas supozimeve tona, Maqedonia dhe Bullgaria në të ardhmen duhet të zhvillojnë bashkëpunim gjithëpërfshirës në të gjitha sferat e nevojave shoqërore të të dyja vendeve, në planin shkencor, historik, ekonomik, turistik, kulturor etj., me qëllim që të vihet deri te mirëkuptimi i popujve të të dyja vendeve, posaçërisht të popullit maqedonas, se e vërteta është ajo se maqedonasit dhe bullgarët aktualë kanë një histori të përbashkët e cila duhet të zhvillohet, vlerësohet dhe përkrahet ashtu siç është, pa hyrë në përcaktimet aktuale të të dyja vendeve.

Ky që është qëndrimi ynë, në një mënyrë tjetër është e shkruar edhe në marrëveshjen e Maqedonisë dhe Bullgarisë, gjë e cila është e mirë, sepse marrëveshja është fleksibile, varësisht nga politikat kulturore dhe shoqërore të cilat do të zhvillohen në të dyja vendet, do të mund të ketë zhvillim, bashkëpunim dhe paqe mes dy shteteve.

Duke e lënë të kaluarën pas shpine, Bullgaria dhe Maqedonia, posaçërisht populli bullgar dhe ai maqedonas mund të arrijnë te ajo shkallë e kohezionit të cilën e dëshiron populli bullgar e të cilën garniturat e deritanishme në pushtet në Maqedoni e refuzonin me ngulm. Për këtë shkak, mendoj se "fjalori fleksibil" i marrëveshjes mes

Bullgarisë dhe Maqedonisë është bazë e mirë për arritje paqësore të nevojave reale të të dyja vendeve.

Në këtë drejtim, shqiptarët e Maqedonisë, autoritetet në Kosovë dhe Shqipëri kurrë nuk kanë qenë pengesë për zhvillimin politik dhe kulturor dhe të identitetit të maqedonasve të tanishëm, e më së paku të bullgarëve nga Bullgaria.

Fakti se në Sofje kishte organizata shqiptare të cilat kanë luftuar për pavarësinë e shqiptarëve nga perandoria osmane është argumenti më i madh i përkrahjes reciproke të shqiptarëve dhe bullgarëve. Qysh "...në vitin 1899 në shtypshkronjën "Mbrothësia" në rrugën "Vitosha" te ndërtesa e shitësit të limonadës "Carigrad" është shtypur abetarja e parë në gjuhën shqipe me shkronja shqipe nga Stambolli."[126]

Këto bashkëpunime historike mendoj se janë bazë për kuptim të ndërsjellë dhe bashkëpunim edhe në periudhën e mëtejme të të dy popujve. Madje mendoj se marrëveshjet e këtilla të Maqedonisë me Bullgarinë dhe Greqinë duhet t'i arrijnë edhe vendet tjera në Ballkan, me qëllim që rajoni të zhvillohet, të bëhet tërheqës për qytetarët e tyre.

[126] http://bnr.bg/sq/post/100901914/shtypshkronja-mbrothesia-ne-sofje-dhe-ceshtja-arsimore-shqiptare

# 9. PËRFUNDIM

## 9.1.1. REKOMANDIMI PËR PAQE NË VEND DHE RAJON

**P**rojekti "Shhkupi 2014" si identifikim i periudhës nga viti 2007 deri në vitin 2017 është shembulli më tipik i politikës së keqe kulturore konfliktuoze e cila Maqedoninë e përçau në planin e brendshëm dhe në atë të jashtëm me Greqinë dhe me Bullgarinë. Nëse kësaj politike kulturore i shtohet edhe problemi kishtar i KOM me KOS, atëherë shihet se Maqedonia në këtë periudhë kishte politikë kulturore të zbatuar jashtëzakonisht keq, e cila në mënyrë direkte ndikoi në gjendjet e përgjithshme shoqërore, me ç'rast në planin e brendshëm bëhej:

- diskriminimi në të gjitha bazat në planin kulturor të kulturës shqiptare, jomaqedonase dhe jovmro-së,
- krijimi dhe përçarja mes maqedonasve antik dhe atyre sllavë, rrënimi i përgjithshëm i gjithë asaj që ishte kulturë në të kaluarën,
- krijimi i projekteve korruptive në të gjitha segmentet, posaçërisht me projektet nga "Shkupi 2014",
- zhvleftësimi i gjithçkaje që është esnaf kulturor në vend, për shembull i rrënuan botuesit profesionistë ndërsa krijuan "gjigand të rinj të botuesve" me anë të tenderëve të kurdisur korruptivë nga "shitës i pllakave grafike dhe shtypshkronjë e thjeshtë",
- nga arkitektët dhe piktorët modestë krijuan pasanikë më të mëdhenj në rajon, madje disa prej tyre pastaj na u bënë "donatorë" të përmendoreve,

- e shkatërruan pamjen dhe frymën e Shkupit si qytet i paqes dhe i rehatisë, në një qytet pa pamje dhe parehati në shumë segmente etj.

Pikërisht kjo politikë kulturore e udhëhequr keq nëpërmjet projektit "Shkupi 2014" ndikoi në prishjen e marrëdhënieve me Bullgarinë dhe Greqinë. Ekskluzivitetin që dëshironte ta tregojë nëpërmjet heronjve dhe ngjarjeve të cilat janë pjesë e përbashkët e historisë me popullin bullgar në njërën anë dhe aventurës së imponuar se Aleksandri i Madh iu takon maqedonasve të tanishëm i ndezi grekët, të cilët në asnjë rast nuk duan që këtë histori ta ndajnë me dikë tjetër, pa marrë parasysh librat shumëvëllimëshe të cilat janë botuar në gjuhën maqedonase, shqipe dhe në gjuhë të tjera rreth prejardhjes së Aleksandrit të Madh, ishin arsyet për prapambetjen e marrëdhënieve fqinjësore me Bullgarinë dhe Greqinë.

Me ndryshimin e pushtetit në vitin 2016, gjegjësisht në vitin 2017, fryma e marrëdhënieve të mira fqinjësore filloi të marrë hov me vetë dëshirën e vendeve fqinje për bisedime të hapura direkte e të sinqerta. Këtu vlen të përmendet edhe përkrahja të cilën qeveria e re, e kishte nga UE, NATO dhe SHBA për t'i mbyllur temat e hapura me Bullgarinë dhe Greqinë. Kjo edhe ndodhi me përkrahjen e tyre të madhe e të fuqishme, ashtu që marrëveshjet për miqësi dhe paqe me Bullgarinë dhe Greqinë shumë shpejtë edhe ndodhën.

Për t'u përmirësuar imazhi i vendit është i domosdoshëm revidimi i projektit "Shkupi 2014", në të vërtetë ndryshimi i politikës kulturore në vend, edhe atë në fillim të:

- hetohen dhe dënohen të gjitha projektet të cilat ishin pjesë e korrupsionit, jo për hakmarrje, por me qëllim që kurrë më politika mos të përpiqet që nëpërmjet projekteve

të ashtuquajtura megalomane të kulturës, të bëjnë para për aktivitetet e tyre partiake,

- hiqen të gjitha përmendoret kontestuese me Greqinë, Bullgarinë dhe në planin e brendshëm me popullin jomaqedonas,

- heqja e përmendoreve dhe e statujave të cilat në aspektin kulturor, artistik dhe kulturor me vlerë janë kiç dhe thjesht e ngulfatin sheshin e Maqedonisë,

- sistematizimi dhe riorganizimi i Ministrisë së Kulturës në tre reparte të veçanta të kulturës (Reparti për kulturën maqedonase, reparti për kulturën shqiptare dhe reparti për bashkësitë kulturore në Maqedoni),

- Inicimi dhe realizimi i projekteve kulturore me interes të përbashkët të qytetarëve të Maqedonisë, Bullgarisë dhe Greqisë,

- nxitja e konferencave të përbashkëta për çështjet lidhur me gjuhën, folklorin, historinë, kulturën etj., nga ana e emrave të njohur të profesionistëve në këto sfera nga Bullgaria dhe Maqedonia,

- organizimi i konferencave shkencore në aspektin kulturor e të cilat nuk kanë pika të përbashkëta me identitetin e Aleksandrit të Madhe nga ana e kulturologëve maqedonas, grekë, bullgarë, serbë, kroatë, boshnjakë dhe shqiptarë,

- organizimi i ngjarjeve të ndryshme të përbashkëta kulturore, si për shembull koncertet muzikore të këngëtarëve dhe muzikantëve të popullarizuar të rajonit,

- organizimi i galerive të përbashkëta artistike të artistëve në relacionin e kryeqyteteve të rajonit, posaçërisht të atyre në Athinë, Sofje, Shkup, Prishtinë dhe Beograd,

- nxitja e beletristikës së përkthyer në gjuhët e rajonit, posaçërisht në mes gjuhës bullgare, greke, maqedonase dhe shqiptare,

- organizimi i llojeve të ndryshme disaditore të ekskursioneve në një aktivitet me temë të caktuar nga sfera e kulturës, si për shembull artistët e artit, poezia, muzika, punë dore, drama etj., nga ana e shkollarëve të mesëm dhe filloristëve të Bullgarisë, Maqedonisë, Kosovës, Serbisë, Greqisë, Kroacisë etj.

Këto janë vetëm një pjesë e aktiviteteve të mundshme për shërimin e agonisë dhjetëvjeçare të zhvillimit kulturor dhe të politikës kulturore e cila ndikoi shumë keq në gjendjet shoqërore ne vend në mënyrë institucionale. Për kulturën nuk ka variant më të keq kur kiçi është "interes nacional" i vendit. Në Maqedoni nga viti 2007 deri 2017 kjo ndodhi në formën më të ashpër më të keqe dhe për këtë, vlerat e vërteta kulturore ishin të padukshme për shkak të shumë projekteve nga kultura të imponuara e me vëllim të madh, përplot me frustracione dhe pa asnjë vlerë kulturore të cilat madje u quajtën si patriotike, ndërsa në realitet ishin pa shije dhe konfliktuoze në planin e brendshëm e të jashtëm.

Me riorganizimin dhe sistematizimin e Ministrisë së Kulturës ku përgjegjësia për zhvillimin e kulturës jepet në tre reparte të kulturës, jo vetëm që do t'i thjeshtëzojë proceset për zhvillim të barabartë të kulturës, por do të bëjë edhe kohezion të multikulturalizmit në Maqedoni i cili do të zhvillohet me hapa të shpejtë deri në nivelin e zhvillimit të vlerave kulturore me vendet fqinje dhe ato evropiane.

Paralelisht me procesin e riorganizimit dhe sistematizimit të Ministrisë së Kulturës, duhet të ndërmerren aktivitete konkrete në **depolitizimin,**

**deetnizimin dhe departizimin e kulturës** në ministri dhe përgjithësisht në tërë bashkësinë kulturore në Maqedoni.

Me këto hapa do të krijohet hapësirë për:

- Vendosja e vlerave kulturore në krijimtarinë dhe kulturën artistike,
- Korniza stabile për qëndrueshmërinë dhe afirmimin e vlerave kulturore,
- Zhvillim institucional të kulturës (e jo zhvillim kulturor të rastësishëm),
- Depolitizimin e Ministrisë së Kulturës dhe i institucioneve nacionale kulturore do të jenë model për depolitizimin dhe departizimin edhe të arsimit, sportit, shëndetësisë, ekonomisë etj.,
- Kornizë mbrojtëse për shpërndarjen proporcionale të parave të qytetarëve nga buxheti i shtetit për nevoja qytetare dhe njerëzore sipas identifikimit të tyre kulturor,
- Përgjegjësia kulturore e institucioneve kulturore shtetërore, për nevojën e krijimit të kapaciteteve për avancimin e vlerave krijuese dhe kulturore (sistemi i vlerave ka ngecur prej kohësh, madje edhe ata që nuk i donim nga epoka komuniste i humbëm dhe nuk krijuam të reja - pikërisht për shkak të politikave të këqija kulturore, me projekte dhe fraza të gjera të cilat përfunduan me projekte të gabuara zhvlerësuese si kiç dhe korrupsion),
- Krijimi i mundësive të barabarta për menaxhim profesional të projekteve kulturore dhe institucioneve me karakter kombëtar dhe lokal. (Kjo do të thotë se tërhiqet një vijë midis veprimtarisë amatore dhe profesionale në kulturë, pa asnjë nënçmim të veprimtarisë amatore në fushën kulturore). Por kur amatorizmi pozicionohet në veprimin profesional të kulturës, atëherë vlerat e vërteta kulturore bien,

•Krijimi i një ambienti me të vërtetë multikulturor, jo multikulturalizëm i bazuar vetëm në paratë e menaxhuara keq në vend dhe jashtë, vetëm për të bërë propagandë të jashtme dhe të brendshme në një periudhë afatshkurtër - për një moment,

•Fitimi i hapësirës për rivalitet në vlerat kulturore, të cilat e afirmojnë dhe e pasurojnë jetën kulturore në vend,

•Njohja dhe përjetimi i vlerave kulturore të tjetrit, dhe natyrisht se me këtë bashkë i afrojmë vlerat kulturore dhe thesaret e Maqedonisë,

•Eliminimi i çfarëdo lloji të abuzimeve financiare dhe të tjera nga pozicioni i pushtetit, siç janë interesat e partisë, konflikti i interesit, politika kulturore e angazhuar për nevojat e klaneve të caktuara etj.

Përfitimet shoqërore dhe kulturore nga riorganizimi dhe sistematizimi i Ministrisë së Kulturës dhe i enteve nacionale kulturore janë të shumëfishta, njëherësh do të jetë shembull më i mirë dhe më mbresëlënës se Maqedonia ka dëshirë dhe nevojë që të përshëndetet me njëmendësinë dhe të vazhdojë me larminë kulturologjike e cila është më e shëndetshme dhe njëherësh arma më e fortë e të ashtuquajturës 'Një shoqëri për të gjithë', që ishte slogani kryesor i pushtetit aktual.

# SHTOJCA

## MARRËVESHJA PËRFUNDIMTARE PËR ZGJIDHJEN E DALLIMEVE TË PËRSHKRUARA NË REZOLUTAT 817 (1993) DHE 845 (1993) TË KËSHILLIT TË SIGURI MIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR SHFUQIZIMIN E MARRËVESHJES SË PËRKOHSHME TË VITIT 1995

## MARRËVESHJE

## MARRËVESHJA PËRFUNDIMTARE PËR ZGJIDHJEN E DALLIMEVE TË PË RSHKRUARA NË REZOLUTAT 817 (1993) DHE 845 (1993) TË KËSHILLIT TË SIGURI MIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA, PËR SHFUQIZIMIN E MARRËVESHJES SË PËRKOHSHME TË VITIT 1995, DHE PËR VENDOSJEN E PARTNERITETIT STRATEGJIK NDËRMJET PALËVE

## PREAMBULA

Pala e parë, Greqia ("Pala e parë") dhe Pala e dytë, e cila ishte pranuar në Kombet e Bashkuara në pajtim me rezolutën 47/225 të 8 prillit 1993 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (“Pala e dytë”), të emëruara së bashku si “Palët",

-Duke u thirrur në parimet dhe qëllimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, Dokumentit përfundimtar të Helsinkit i vitit 1975, akteve relevante të Organizatës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe vlerat dhe parimet e Këshillit të Evropës,

Të udhëhequra nga fryma dhe parimet e demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe dinjitetit,
Duke iu përmbajtur dispozitave të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe veçanërisht atyre të cilat kanë të bëjnë me obligimin e shteteve në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare të përmbahen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës kundër integritetit territorial ose pavarësisë politike të cilitdo shtet,

Duke e theksuar angazhimin e tyre të plotë për parimet për mos-cenimin e kufijve dhe integritetit territorial të shteteve, të përfshirë në Dokumentin Përfundimtar të Helsinkit të vitit 1975,

Duke e vërtetuar kufirin ekzistues ndërmjet tyre si kufi ndërkombëtar i përhershëm,

Të pajtuar plotësisht për nevojën e përforcimit të paqes, stabilitetit, sigurisë dhe avancimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit në Evropën Juglindore,

Me dëshirë që ta përforcojnë atmosferën e besimit dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore në Rajon dhe t'i ndërpresin në mënyrë të përhershme të gjitha qëndrimet armiqësore, të cilat do të mund të qëndrojnë ende dhe duke u pajtuar për nevojën e përmbajtjes nga irredentizmi dhe revizionizmi në cilëndo formë,

Duke u thirrur në obligimin e tyre, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe të drejtën ndërkombëtare, nën çfarëdo preteksti dhe në çfarëdo forme, të mos përzihen në punët e brendshme dhe kompetencat e Palës tjetër,

Duke e nënvizuar, gjithashtu, vlerën e zhvillimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet shteteve dhe nevojën kontestet të zgjidhen në mënyrë të qetë, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara,

Duke i zgjidhur dallimet në pajtim me Rezolutën 817 (1993) të 7 prillit 1993 dhe Rezolutën 845 (1993) të 18 qershorit 1993, të Këshillit të Sigurimit, si dhe nenin 5 të Marrëveshjes së Përkohshme të 13 shtatorit 1995 në mënyrë dinjitoze dhe të qëndrueshme, duke i pasur parasysh vlerën e çështjes dhe ndjeshmërisë së secilës Palë,

Duke e marrë parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme47/225 të 8 prillit 1993,

Duke e pasur parasysh Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin e 13 tetorit 1995 për masat praktike të lidhura me Marrëveshjen e përkohshme, Memorandumin për vendosje të ndërsjellë të zyrave për

lidhje në Shkup dhe Athinë të 20 tetorit 1995, si dhe procesin e Masave për ndërtimin e besimit,

Duke e nënvizuar dëshirën e tyre të fuqishme për miqësi të ndërsjellë, fqinjësi të mirë dhe partneritet për bashkëpunim,

Me angazhim t'i përforcojnë, zgjerojnë dhe thellojnë marrëdhëniet e tyre bilaterale dhe të vendosin themele të forta për përforcimin dhe respektimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe për zhvillimin e bashkëpunimit të tyre bilateral,

Duke kërkuar që ta përforcojnë dhe zgjerojnë bashkëpunimin e vet bilateral dhe ta mbindërtojnë në nivel të partneritetit strategjik, në sferat e bujqësisë, mbrojtjes civile, mbrojtjes, ekonomisë, energjisë, mjedisit jetësor, industrisë, infrastrukturës, investimeve, marrëdhënieve politike, turizmit, tregtisë, bashkëpunimit tejk ufitarë dhe transportit, duke i shfrytëzuar pastaj përfitimet nga Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit,

U dakorduan si vijon:

## PJESA 1

## ZGJIDHJA E DALLIMIT RRETH EMRIT, ÇËSHTJEVE TË PAPËRFUNDUARA LIDHUR ME TË NJËJTIN DHE PËRFORCIMI I MARRËDHËNIEVE TË FQINJËSISË SË MIRË

### Neni 1

1.Kjo Marrëveshje është përfundimtare dhe me hyrjen e saj në fuqi shfuqizohet Marrëveshja e përkohshme mes palëve, e nënshkruar në Nju Jork, më 13 shtator 1995.

2.Palët e pranuan si obligues rezultatin nga negociatat, të cilat u zhvilluan nënpatronazhin e Kombeve të Bashkuara, e të cilat Palët ishin të obliguara t'i udhëheqin në pajtim me Rezolutën 817 (1993) dhe

Rezolutën 945 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe në pajtim me Marrëveshjen e përkohshme të vitit 1995.

3.Në pajtim me këto negociata, në mënyrë të ndërsjellë janë pranuar dhe dakorduar këto, si vijojnë:

a) Emri zyrtar i Palës së dytë do të jetë "Republika e Maqedonisë së Veriut", i cili do të jetë emër Kushtetues i Palës së dytë dhe do të përdoret erga omnes, siç është paraparë me këtë marrëveshje. Emri i shkurtër i Palës së dytë do të jetë "Maqedonia e Veriut".

b)Shtetësia e Palës së dytë do të jetë maqedonase/ qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, siç do të shënohet në të gjitha dokumentet e udhëtimit.

c)Gjuha zyrtare e Palës së dytë do të jetë "gjuha maqedonase", siç është pranuar në Konferencën e tretë të KB-së për standardizimin e emrave gjeografike, e mbajtur në Athinë në vitin 1977 dhe siç është e përshkruar në nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i kësaj marrëveshje.

ç) Termet "Maqedonia" dhe "maqedonase" e kanë domethënien e dhënë në nenin 7 të kësaj marrëveshje.

d)Kodi i vendit në targat e regjistrimit të automjeteve të Palës së dytë do të jetë NM ose NMK. Për të gjitha qëllimet tjera, kodi i vendit mbetet MK dhe MKD, siç është e përcaktuar zyrtarisht nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).

dh) Mbiemri lidhur me shtetin, organet e tij zyrtare dhe institucionet tjera publike do të jenë në pajtim me emrin zyrtar të Palës së dytë ose me emrin e tij të shkurtër, përkatësisht "të Republikës së Maqedonisë së Veriut" ose "të Maqedonisë së Veriut". Përdorime të tjera të mbiemrit, duke përfshirë edhe ato lidhur me entitetet dhe aktorët privatë, të cilët janë të lidhur me shtetin dhe entitetet publike, që nuk janë të themeluara me ligj dhe nuk marrin mbështetje financiare nga shteti për aktivitete jashtë shtetit, mund të jenë në pajtim me nenin 7, paragrafi

(3)dhe paragrafi (4). Përdorimi i mbiemrit për aktivitete mund të jetë në pajtim me nenin 7, paragrafi (3) dhe paragrafi (4). Kjo nuk ndikon në procesin e përcaktuar sipas nenit 1, paragrafi

3 (ë) dhe në emrat e përbërë të qyteteve që ekzistojnë në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

e)Pala e dytë do ta pranojë emrin "Republika e Maqedonisë së Veriut" si emër të saj zyrtar, si dhe termet e cekura në nenin 1, paragrafi (3), duke e zbatuar procedurën e brendshme e cila është e obligueshme dhe parevokueshme, që do të përfshijë miratimin e amendamentit të Kushtetutës, siç është përcaktuar me këtë marrëveshje.

ë) Lidhur me emrin e lartpërmendur dhe terminologjitë në emrat komercialë, markat tregtare dhe emrat e markave, Palët pajtohen që t'i mbështesin dhe inkurajojnë komunitetet e tyre afariste që të vendosin dialog të sinqertë, të strukturuar dhe të mirë, në kuadër të të cilit do të kërkojnë dhe do të arrijnë zgjidhje të përbashkëta për çështje të cilat dalin nga emrat komerciale, marka tregtare dhe emrat e markave dhe për të gjitha çështjet relevante, në nivel bilateral dhe ndërkombëtar. Për zbatimin e dispozitave të lartpërmendura, do të formohet grup ndërkombëtar i ekspertëve, të cilin do ta përbëjnë përfaqësues të dy vendeve, në kontekst të Bashkimit Evropian (BE) me kontributin përkatës të Kombeve të Bashkuara dhe ISO. Ky grup i ekspertëve do të formohet në vitit 2019, dhe do ta përfundojë punën e vet brenda tri vitesh. Asnjë dispozitë e nenit 1, paragrafi 3

(ë)nuk do të ndikojë mbi përdorimin e tanishëm komercial derisa nuk arrihet pajtim i ndërsjellë, siç është paraparë në këtë aline.

4. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Palët do t'i marrin hapat në vijim:

a) Pala e dytë, pa prolongim, do t'ia paraqesë Marrëveshjen Kuvendit për ratifikim.

b) Pas ratifikimit të Marrëveshjes në Kuvendin e Palës së dytë, Pala e dytë do ta njoftojë Palën e parë se Kuvendi i Palës së Dytë e ka ratifikuar Marrëveshjen.

c)Pala e dytë, nëse vendos ashtu, do të mbajë referendum.

ç) Pala e dytë do të nisë procesin për miratimin e amendamenteve kushtetuese, siç është paraparë në këtë marrëveshje,

d) Pala e dytë në tërësi do t'i miratojë amendamentet kushtetuese deri në fund të vitit 2018.

dh) Pas njoftimit të Palës së dytë për përfundimin e procedurës për miratimin e amendamenteve të lartpërmendura të Kushtetutës dhe për përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme juridike për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Pala e parë menjëherë do ta ratifikojë këtë marrëveshje.

5.Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Palët do ta përdorin emrin dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1, paragrafi 3 në të gjitha organizatat relevante ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale, institucionet dhe forumet, përfshirë edhe të gjitha mbledhjet dhe korrespodencën dhe në të gjitha marrëdhëniet bilaterale me të gjitha shtetet - anëtare të Kombeve të Bashkuara.

6.Konkretisht, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Pala e dytë do t'i:

a) Njoftojë të gjitha organizatat ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale, institucionet dhe forumet, anëtare e të cilave është, për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe pastaj do të kërkojë nga të gjitha ato organizata, institucione dhe forume ta pranojnë dhe përdorin emrin dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1, paragrafi 3 të kësaj marrëveshjeje për të gjitha përdorimet dhe qëllimet. Të dyja Palët, gjithashtu, do t'i drejtohen Palës së dytë në pajtim me nenin 1, paragrafi 3 në të gjitha komunikimet ndaj, me dhe në kuadër të organizatave, institucioneve dhe forumeve të tilla.

b) Njoftojë të gjitha shtetet - anëtare të Kombeve të Bashkuara për hyrjen e kësaj marrëveshjeje në fuqi dhe do të kërkojë nga të njëjtat ta pranojnë dhe ta shfrytëzojnë emrin dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1, paragrafi 3 nga kjo marrëveshje për të gjitha përdorimet dhe

qëllimet, duke përfshirë edhe në të gjitha marrëdhëniet e saja bilaterale dhe komunikim.

7.Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje dhe në pajtim me dispozitat e nenit 1, paragrafi (9) dhe paragrafi (10) termet "Maqedoni", "Republika e Maqedonisë", IRJ e Maqedonisë", "IRJ. e Maqedonisë", në formë të përkthyer ose të pa-përkthyer, si dhe emri i përkohshëm "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" dhe akronimi "IRJM" nuk do të përdoren ndaj Palës së dytë në cilindo kontekst zyrtar.

8.Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, e duke marrë parasysh nenin 1, paragrafin (9) dhe paragrafin (10), Palët do ta shfrytëzojnë emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 për të gjitha përdorimet dhe qëllimet erga omnes, përkatësisht për përdorimin e brendshëm, dhe në të gjitha marrëdhëniet e veta bilaterale dhe në të gjitha Organizimet dhe institucionet rajonale dhe ndërkombëtare.

9.Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, Pala e dytë menjëherë dhe në pajtim me praktikat e shëndosha administrative do t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që organet kompetente të vendit që tani e tutje në mënyrë të brendshme ta përdorin emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje në të gjitha dokumentet e reja zyrtare, në korrespodencë dhe në materiale relevante.

10. Në lidhje me rëndësinë e dokumenteve dhe materialeve tashmë ekzistuese të lëshuara nga autoritetet e Palës së dytë, Palët dakordohen të ketë dy periudha kalimtare, një "teknike" dhe një "politike":

a) Periudha kalimtare "teknike" do t'u referohet të gjitha dokumenteve dhe materialeve zyrtare të administratës publike të Palës së dytë për përdorimin ndërkombëtar dhe dokumenteve për përdorimin e brendshëm, por të cilat mund të përdoren edhe jashtë shtetit. Këto dokumente dhe materiale do të përtëriten në pajtim me emrin dhe terminologjitë e theksuara në nenin 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje, më së voni në afat prej pesë vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

b) Periudha kalimtare "politike" do t'u referohet të gjitha dokumenteve dhe materialeve, të cilat janë veçanërisht për përdorim të brendshëm në Palën e dytë. Lëshimi i dokumenteve dhe materialeve të tilla që janë në këtë kategori në pajtim me nenin 1, paragrafi 3 do të fillojë gjatë hapjes së secilit kapitull në fushën relevante në negociatat në Bashkimin Evropian dhe do të përfundojë në afat prej pesë vitesh nga atëherë.

11.Procedurat për miratimin e shpejtë të amendamenteve kushtetuese të Palës së Dytë, e me qëllim të zbatimit të plotë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje, do të fillojnë pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga Kuvendi i saj ose pas referendumit, nëse Pala e dytë vendos të mbajë referendum.

12.Emri dhe terminologjitë e përmendura në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje do të përfshihen në Kushtetutën e Palës së dytë. Ky ndryshim do të bëhet menjëherë me një amendament. Sipas këtij amendamenti, emri dhe terminologjitë do të ndryshohen në të gjitha nenet e Kushtetutës. Më tej, Pala e dytë do ta nisë procedurën për miratimin e amendamenteve përkatëse të Preambulës, neni 3 dhe neni 49 të Kushtetutës, gjatë procedurës për ndryshimin e Kushtetutës.

13.Në rast të gabimeve dhe lëshimeve në përdorimin e drejtë të emrit dhe terminologjive të përmendura në nenin 1 paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje në kontekst të organizatave ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale, institucioneve, korrespodencës, mbledhjeve dhe forumeve, si dhe në marrëdhëniet e përgjithshme bilaterale të Palës së dytë me shtete dhe entitete të treta, cilado nga Palët mund të kërkojë menjëherë të bëhet korrigjimi dhe të mënjanohen gabimet e ngjashme në të ardhmen.

**NENI 2**

1.Pala e parë pajtohet që të mos i kundërshtojë kërkesat për anëtarësim ose anëtarësimin e Palës së dytë, me emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale në të cilat Pala e parë është anëtare.

2.Pala e dytë do të kërkojë pranimin në organizata dhe institucione ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale me emrin dhe terminologjitë nga neni 1, paragrafi 3 i kësaj marrëveshjeje.

3.Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, e në pajtim me nenin 1 të kësaj marrëveshjeje, Pala e parë do të ratifikojë çfarëdo marrëveshje për aderimin e Palës së dytë në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Pala e parë është anëtare.

4.Në veçanti, sa i përket procesit të integrimit të Palës së dytë në Bashkimin Evropian (BE) dhe Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), do të aplikohen:

a. Pala e dytë do të kërkojë anëtarësim në NATO dhe BE me emrin dhe terminologjitë nga neni 1 i kësaj marrëveshjeje. Anëtarësimi në NATO dhe BE do të bëhet me të njëjtin emër dhe terminologji.

b. Pas marrjes së njoftimit se Kuvendi i Palës së dytë e ka ratifikuar këtë marrëveshje, Pala e parë menjëherë:

(i)do ta njoftojë kryetarin e Këshillit të Bashkimit Evropian se e mbështet fillimin e negociatave për anëtarësimin e Palës së dytë në Bashkimin Evropian, me emrin dhe terminologjitë nga nenit 1 i kësaj marrëveshjeje.

(ii)do ta njoftojë sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s se e mbështet ftesën për anëtarësimin e Palës së dytë. Mbështetja e tillë e Palës së parë kushtëzohet, së pari, me rezultatin e referendumit, nëse Pala e dytë vendos të mbajë referendum në pajtim me këtë marrëveshje dhe së dyti, me miratimin e plotë të amendamenteve kushtetuese, siç është e paraparë në këtë marrëveshje. Pas marrjes së njoftimit nga Pala e dytë se i ka përfunduar të gjitha procedurat e saj të brendshme juridike të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë edhe referendum të mundshëm nacional me një rezultat në përputhje me këtë marrëveshje dhe pas përfundimit të procedurës për miratimin e amendamenteve kushtetuese të Palës së dytë, Pala e parë do ta ratifikojë Protokollin për anëtarësimin e Palës së dytë në NATO. Kjo procedurë e ratifikimit do të përfundojë së bashku me procedurën e ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

## NENI 3

1.Palët me këtë e vërtetojnë kufirin e tyre të ndërsjellë ekzistues si kufi ndërkombëtar i pacenueshëm dhe i përhershëm. Asnjëra nga palët nuk do të mbrojë ose mbështesë kurrfarë pretendimesh ndaj cilësdo pjesë të territorit të Palës tjetër, e as pretendime për ndryshim të kufirit të tyre të ndërsjellë ekzistues. Përveç kësaj, asnjëra nga Palët nuk do të mbështesëçfarëdo lloj pretendimesh të tilla të cilat mund t'i shprehin palët e treta.

2.Secila Palë obligohet ta respektojë sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të Palës tjetër. Asnjëra nga Palët nuk do të mbështesë çfarëdo lloj aktiviteti të palëve të treta drejtuar kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të Palës tjetër.

3.Të dyja Palët, në pajtim me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të përmbahen nga kërcënimet ose përdorimi i forcës, duke përfshirë edhe kërcënimet ose përdorimin e forcës me qëllim që të prishet kufiri i ndërsjellë ekzistues.

4.Të dyja Palët obligohen se nuk do të ndërmarrin, nxisin, mbështesin dhe/ose tolerojnë çfarëdo lloj veprimtarish ose aktivitetesh të karakterit armiqësor drejtuar Palës tjetër. Asnjëra nga Palët nuk do të lejojë që territori i vet të shfrytëzohet kundër Palës tjetër nga palët e treta, organizatat, grupet dhe individët të cilat kryejnë ose orvaten të kryejnë veprime subverzive, secesioniste, ose veprime ose aktivitete që paraqesin në çfarëdo lloj mënyre kërcënim të paqes, stabilitetit ose sigurisë së Palës tjetër. Secila Palë pa prolongim do t'i përcjellë Palës tjetër informata të cilat ajo i posedon në lidhje me aktivitetet ose qëllimet e tilla.

## NENI 4

1.Secila nga Palët me këtë obligohet dhe deklaron në mënyrë solemne se asnjë dispozitë nga Kushtetuta e saj, siç është në fuqi ose siç do të ndryshohet në të ardhmen, nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet si mënyrë, e cila paraqet ose kur do qoftë do të paraqesë bazë për çfarëdo pretendimi ndaj të cilësdo sferë e cila nuk është në kuadër të kufijve të saj ndërkombëtare ekzistuese.

2.Secila nga Palët obligohet të mos japë, dhe as të lejojë çfarëdo lloj deklaratash irredentiste dhe se nuk do të miratojë çfarëdolloj deklaratash të tilla të dhëna nga ata të cilët pohojnë se veprojnë në emër ose në interes të njërës prej Palëve.

3.Secila nga Palët me këtë obligohet dhe deklaron solemnisht se asnjë dispozitë nga Kushtetuta e saj, siç është në fuqi ose siç do të ndryshohet në të ardhmen, nuk mund dhe nuk duhet të interpretohet në mënyrë e cila paraqet ose kurdo qoftë do të paraqesë bazë për përzierje në punët e brendshme të Palës tjetër, në cilëndo formë ose për cilëndo qoftë arsye, duke përfshirë dhe për shkak të mbrojtjes së statusit dhe të drejtave të cilave do persona të cilët nuk janë qytetarë të saj.

**NENI 5**

1.Në kryerjen e punëve të saj, Palët do të udhëhiqen nga fryma dhe parimet e demokracisë, lirive themelore, respektimit të të drejtave njerëzore dhe dinjitetit dhe sundimit të së drejtës, në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut1, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 2, Konventën Ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor 3, Konventën për të drejtat e fëmijës 4, Dokumentin përfundimtar të Helsinkit, Dokumentin nga mbledhja në Kopenhagë e Konferencës për dimensionin njerëzor të Konferencës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë dhe Kartën e Parisit për Evropë të Re, dhe marrëveshjeve tjera ndërkombëtare dhe instrumente në të cilën kanë aderuar të dyja Palët.

2.Asnjë dispozitë nga cilido instrument i përmendur në paragrafin 1 nuk do të interpretohet se i jep të drejtë cilësdo qoftë nga Palët të ndërmarrin veprime në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara ose Dokumentit Përfundimtar të Helsinkit, duke përfshirë dhe në kundërshtim me parimin e integritetit territorial të shteteve.

**NENI 6**

1.Me qëllim të forcimit të marrëdhënieve bilaterale shoqërore, secila nga Palët menjëherë do të ndërmarrë masa efektive për t'i penguar cilat

do qoftë aktivitete, veprimtari armiqësore, ose propagandë nga ana e organeve shtetërore ose organet nën kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të shtetit dhe për të parandaluar veprimtari që mund të nxisin shovinizëm, armiqësi, irredentizëm dhe revizionizëm kundër Palës tjetër. Nëse paraqiten aktivitete të tilla, të dyja Palët do t'i marrin të gjitha masat e nevojshme.

2.Secila nga Palët menjëherë do të ndërmarrë masa efektive për të shkurajuar dhe parandaluar çdo veprim nga entitete private, që mund të nxisin dhunë, urrejtje ose armiqësi kundër Palës tjetër. Nëse entiteti privat i territorit të cilësdo qoftë nga Palët kryen veprime të tilla pa dijeninë e asaj Pale, ajo Palë, sapo të mësojë për veprime të tilla, menjëherë do t'i ndërmarrë masat e nevojshme të parapara me ligj.

3.Secila nga Palët do të parandalojë dhe shkurajojë veprime, duke përfshirë edhe veprimtari të propagandës nga ana e entiteteve private, veprime që mund të nxisin shovinizëm, armiqësi, irredentizëm dhe revizionizëm kundër Palës tjetër.
1 Kombet e Bashkuara, Gazeta Zyrtare e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhja e tretë, PjesaI, fq. 71
2 Kombet e Bashkuara, Përmbledhja e Marrëveshjeve, vëllimi 213, fq. 221
3 Ibid, vëllimi 660, fq.195
4 Ibid, vëllimi 1577, nr. I-27531.

**NENI 7**

1.Palët pranojnë se kuptimi i tyre përkatës i termeve "Maqedoni" dhe "maqedonas" i referohet kontekstit të ndryshëm historik dhe trashëgimisë kulturore.

2.Kur i referohemi Palës së parë, këto terme shënojnë jo vetëm sferën e popullit të rajonit të veriut të Palës së parë, por gjithashtu edhe karakteristikat e tyre, si dhe civilizimin helen, historinë, kulturën dhe trashëgiminë në atë rajon që nga antika e deri sot.

3.Kur i referohemi Palës së dytë, këto terme e shënojnë territorin e saj, gjuhën, popullin dhe karakteristikat e tyre me historinë e tyre, kulturën

dhe trashëgiminë të cilat janë të ndryshme nga ato të përmendura në Nenin 7 paragrafi (2).

4.Pala e dytë deklaron se gjuha e saj zyrtare, gjuha maqedonase, bën pjesë në grupin e gjuhëve të sllavëve të jugut. Të dyja Palët deklarojnë se gjuha zyrtare dhe karakteristikat tjera të Palës së dytë nuk janë të lidhura me civilizimin helen, historinë, kulturën dhe trashëgiminë e rajonit të veriut të Palës së parë.

5.Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk ka për qëllim të diskreditojë në çfarëdo lloj mënyre, ndryshojë ose ndikojë në përdorimin nga qytetarët e të dy Palëve.

**NENI 8**

1.Në qoftë se cilado nga të dyja Palët beson se një ose më shumë simbole të cilat përbëjnë pjesë të trashëgimisë së saj historike ose kulturore i përdor Pala tjetër, ajo për gjoja përdorimin e tillë do t'i sugjeroj Palës tjetër ndërsa Pala tjetër do të ndërmarrë veprime korrigjuese përkatëse me qëllim që të merret me çështjen në mënyrë efektive dhe të sigurojë respektim të trashëgimisë së tillë.

2.Në afat prej gjashtë muajsh nga hyrja e kësaj marrëveshjeje në fuqi Pala e dytë do ta shqyrtojë statusin e përmendoreve, ndërtesave publike dhe infrastrukturës së territorit të saj dhe nëse ato në çfarëdo lloj mënyre referojnë në historinë dhe civilizimin helen antik që përbën pjesë përkatëse të trashëgimisë historike ose kulturore të Palës së parë do të ndërmarrë veprime korrigjuese përkatëse me qëllim që në mënyrë efektive ta shqyrtojë çështjen dhe të sigurojë respektimin e trashëgimisë së tillë.

3.Pala e dytë nuk do ta përdorë përsëri në çfarëdo lloj mënyre dhe në çfarëdo lloj forme simbolin e paraqitur në flamurin e saj shtetëror. Në afat prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, Pala e dytë do ta nisë procedurën për heqjen e simbolit të paraqitur në flamurin e saj të mëparshëm shtetëror nga të gjitha vendet publike dhe nga përdorimi publik në territorin e sajë. Artefaktet arkeologjike nuk janë të përfshira në këtë dispozitë.

4.Secila nga Palët do t'u përmbahet rekomandimeve të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për standardizim të emrave gjeografike në lidhje me përdorimin e emrave gjeografike zyrtare dhe toponimeve të territorit të Palës tjetër, duke i dhënë prioritet me këtë rast shfrytëzimit të endonimeve në vend të ekzonimeve.

5.Në afat prej një muaji nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Palët nëpërmjet këmbimit të notave diplomatike, në bazë të paritetit, do të formojnë Komitet të përbashkët interdisiplinar të ekspertëve për çështje historike, arkeologjike dhe arsimore, i cili do ta shqyrtojë interpretimin shkencor objektiv të ngjarjeve historike të bazuara në dëshmi autentike dhe në burime të qëndrueshme historike dhe shkencore dhe gjetjeve arkeologjike. Ministritë e Punëve të Brendshme të të dyja Palëve do ta mbikëqyrin punën e Komitetit në bashkëpunim me autoritetet tjera shtetërore kompetente. Komiteti do të shqyrtojë edhe nëse mendon se është e përshtatshme, do të kryej revizion mbi cilindo libër shkollor dhe material mësimor ndihmës siç janë hartat, atlaset historike, udhëzimet mësimore të cilat shfrytëzohen nga të dyja Palët në pajtim me parimet dhe qëllimet e UNESKO-së dhe Këshillit të Evropës. Për këtë qëllim, Komiteti do të caktojë korniza kohore konkrete për të siguruar se në secilën Palë asnjë libër shkollor ose material mësimor ndihmës që shfrytëzohet në vitin pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje nuk përmban çfarëdo lloj referencash revizioniste/irredentiste. Komiteti gjithashtu, do t'i studiojë edhe botimet e reja të librave shkollorë dhe materialeve mësimore ndihmëse, siç është paraparë në këtë nen. Komiteti do të mbajë mbledhje rregullisht, së paku dy herë në vit dhe do të parashtrojë raport vjetor për aktivitetet e veta si dhe rekomandimet që duhet të miratohen nga Këshilli për bashkëpunim i nivelit të lartë i cili do të formohet në pajtim me nenin 12.

6.Palët pranojnë se zgjidhjet e lartpërmendura të pranuara reciprokisht, që dalin nga negociatat, do të kontribuojnë për vendosje përfundimtare të marrëdhënieve paqësore dhe të fqinjësisë së mirë në Rajon, në pajtim me Rezolutën 817 (1993) dhe Rezolutën 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

## PJESA 2

## INTENSIFIKIMIDHE PASURIMI IBASHKËPUNIMIT NDËRMJET DY PALËVE

### NENI9

1.Palët pajtohen se bashkëpunimi i tyre strategjik do të shtrihet në të gjithë sektorët, siç janë bujqësia, mbrojtja civile, mbrojtja, ekonomia, energjia, mjedisi jetësor, industria, infrastruktura, investimet, marrëdhëniet politike, turizmi, tregtia, bashkëpunimi tejkufitar dhe transporti. Bashkëpunimi i tillë strategjik do të realizohet jo vetëm në sektorët e përfshirë me këtë marrëveshje, por gjithashtu edhe në ato sektorë të cilët në të ardhmen do tëkonsiderohen të dobishëm dhe të domosdoshëm për të dyja vendet. Të gjithë këta sektorë duhet të inkorporohen në plan veprimin gjithëpërfshirës gjatë zhvillimit të marrëdhënieve bilaterale.

2.Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit do të inkorporohen në plan veprimin e lartpërmendur. Plan veprimi ka për qëllim zbatimin e dispozitave të kësaj pjese nga kjo marrëveshje. Plan veprimi do të pasurohet dhe zhvillohet vazhdimisht.

### MARRËDHËNIE T DIPLOMATIKE

### NENI 10

Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje:
1.Pala e parë menjëherë do ta ngrit nivelin:
a) e Zyrës së vet ekzistuese për lidhje në kryeqytetin e Palës së dytë në nivel të ambasadës; dhe
b) të Zyrës së vet ekzistuese për çështje konsullore, ekonomike dhe tregtare në qytetin Manastir, të Palës së dytë, në nivel të Konsullatës së përgjithshme; dhe
2.Pala e dytë menjëherë do ta ngrit nivelin:
a) e Zyrës së vet ekzistuese për lidhje në kryeqytetin e Palës së parë në nivel të ambasadës; dhe

b) të Zyrës së vet ekzistuese për punë konsullore, ekonomike dhe tregtare në qytetin Selanik, të Palës së parë, në nivel të konsullatës së përgjithshme.

## BASHKËPUNIMI NË KONTEKST TË ORGANIZATAVE DHE FORUMEVE NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE

### NENI 11

Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të ngushtë, bilaterale dhe në kuadër të organizatave dhe iniciativave rajonale, me qëllim që të sigurojnë se Evropa Juglindore do të bëhet rajon i paqes, zhvillimit dhe prosperitetit për popujt e vet. Ato do të promovojnë dhe do bashkëpunojnë në definimin e bashkëpunimit në nivel rajonal, si dhe do të bashkëpunojnë edhe në mbështetjen e ndërsjellë të kandidaturave të tyre në kontekst të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale, siç janë Kombet e Bashkuara, OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës.

## BASHKËPUNIMI POLITIK DHE SHOQËROR

### NENI 12

Palët dakordohen që t'i forcojnë dhe zhvillojnë më tej marrëdhëniet e tyre bilaterale politike, përmes vizitave, takimeve dhe konsultimeve të rregullta në nivel të lartë politik dhe diplomatik.

1.Palët do të formojnë Këshill për Bashkëpunim të Nivelit të Lartë (KBNL), që do të përbëhet nga përfaqësues të qeverive të tyre, të kryesuar bashkërisht nga kryeministrat e tyre.

3.KBNL-ja do të caktojë mbledhje të paktën një herë në vit dhe do të jetë trup kompetent për zbatimin e duhur dhe efektiv të kësaj marrëveshjeje dhe plan veprimit që do të dalë nga ajo. KBNL-ja do të marrë vendime dhe do të promovojë aktivitete dhe masa për përmirësimin dhe përsosjen e bashkëpunimit bilateral ndërmjet dy Palëve dhe do të shqyrtojë çdo lloj çështje që mund të dalë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe plan veprimit që do të dalë nga ajo, me qëllim të zgjidhjes së çështjeve të tilla.

4.Palët janë të bindura se zhvillimi dhe forcimi i kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet njerëzve janë me rëndësi esenciale për zhvillimin e miqësisë, bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë ndërmjet Palëve dhe popujve të tyre. Ata do t'i mbështesin dhe inkurajojnë kontaktet dhe takimet e tilla ndërmjet qytetarëve të tyre në të gjitha nivelet e duhura.

5.Palët do të japin mbështetje dhe do t'i nxisin kontaktet ndërmjet shoqërive të tyre civile, si dhe ndërmjet institucioneve të tyre dhe autoriteteve lokale, duke përfshirë dhe aktivitetet për bashkëpunimin ndërmjet të rinjve dhe studentëve, si dhe shkëmbimin e tyre, me qëllim të arritjes së mirëkuptimit dhe bashkëpunimit më të mirë me popujt e tyre.

## BASHKËPUNIMI EKONOMIK

### NENI 13

Duke marrë parasysh faktin që Pala e Dytë është shtet pa dalje në det, Palët do të udhëhiqen nga dispozitat relevante të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën në Det, për aq sa është e zbatueshme në praktikë dhe gjatë lidhjes së marrëveshjeve të përmendura në nenin 18 të kësaj marrëveshjeje.

### NENI 14

1.Palët më tej do ta zhvillojnë bashkëpunimin e tyre ekonomik në të gjitha fushat. Theksi i veçantë do të vendoset në përforcimin dhe thellimin e bashkëpunimit bilateral në fushën e bujqësisë, energjisë, mjedisit jetësor, industrisë, infrastrukturës, investimeve, turizmit, tregtisë dhe transportit. Për arritjen e këtyre qëllimeve, Palët do t'i përdorin dhe shfrytëzojnë Masat ekzistuese për ndërtimin e besimit, të cilat paraqesin platformë reciproke të dobishme për bashkëpunim, e cila do të zhvillohet në plan veprim.

2.Palët do t'i inkurajojnë investimet reciproke dhe do t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e tyre efektive, duke përfshirë dhe masat kundër burokracisë së tepërt dhe për tejkalimin e pengesave

institucionale, administrative dhe tatimore. Palët veçanërisht do të fokusohen në bashkëpunimin ndërmjet kompanive, subjekteve afariste dhe industrive të secilës prej Palëve.

3.Palët do të përmbahen nga vendosja e çdo pengese për lëvizjen e personave dhe mallrave ndërmjet territoreve të tyre dhe nëpërmjet territorit të secilës Palë në territorin e Palës tjetër. Palët do të bashkëpunojnë për ta lehtësuar lëvizjen e tillë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

4.Palët do të zhvillojnë dhe nxisin bashkëpunimin e tyre në sektorin e energjisë, veçanërisht nëpërmjet ndërtimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të gazsjellësve dhe naftësjellësve interkonektivë (ato që janë në ndërtim e sipër dhe të projektuarat), ndërsa do të bashkëpunojnë në lidhje me burimet përtëritëse të energjisë, duke përfshirë kapacitetet diellore, të erës dhe hidrocentraleve. Çështjet e mundshme të pazgjidhura do të shqyrtohen shpejtë dhe do të arrihet zgjidhje e pranueshme reciproke, me ç'rast do të merret parasysh Politika evropiane për energji dhe legjislacioni evropian në këtë fushë. Pala e parë do ta ndihmojë Palën e dytë nëpërmjet transferimit të duhur të njohurive dhe ekspertizës.

5.Palët do të promovojnë, zgjerojnë dhe përmirësojnë sinergjinë bashkëpunuese në fushat e infrastrukturës dhe transportit, si dhe në bazë reciproke edhe në fushat e transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror dhe lidhjet e komunikimeve, duke përdorur teknologjitë dhe praktikat më të mira në dispozicion. Ato, gjithashtu, do të lehtësojnë transitin e mallrave dhe ngarkesave ndërmjet tyre, nëpërmjet infrastrukturës, duke përfshirë portet dhe aeroportet, në territoret e secilës Palë. Palët do t'u përmbahen rregullave dhe rregullativave ndërkombëtare në lidhje me transitin, telekomunikimet, shenjat dhe kodet. Pala e parë do ta bëjë këtë deri në atë masë dhe në mënyrë që do të jetë në përputhje me detyrimet e saj që do të dalin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare. Pala e dytë do ta bëjë atë deri në atë masë dhe në mënyrë që do të jetë në përputhje me detyrimet e tyre që dalin nga anëtarësimi i saj në institucionet ndërkombëtare, multilaterale ose rajonaleinstitucionet ose organizatat ku e njëjta është anëtare në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj

marrëveshjeje, si dhe detyrimet që do të dalin nga anëtarësimi i saj në Bashkimin Evropian, pasi që të propozohet anëtarësimi i saj në të.

6.Palët do të përpiqen t'i përmirësojnë dhe modernizojnë kalimet kufitare ekzistuese, siç kërkohet nga qarkullimi i komunikacionit, ndërsa gjithashtu do të ndërtojnë vendkalime të reja kufitare, me qëllim që të inkurajojnë shkëmbimet turistike dhe tregtare ndërmjet tyre.

7.Palët do të marrin masa për të siguruar mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe ruajtjen e mjedisit natyror në ujërat ndërkufitare dhe mjedisin e tyre dhe do të bashkëpunojnë në përpjekjet për zvogëlimin dhe eliminimin e të gjitha formave të ndotjes. Palët do të përpiqen të zhvillojnë dhe harmonizojnë strategjitë dhe programet për bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në mbrojtjen e mjedisit jetësor.

